

20221512018

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J I PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (*)

KAPITULLI I.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon masat, veprimet dhe procedurat, të cilat subjektet dhe organet kompetente i ndërmarin për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave, veprave penale të lidhura me to dhe financimin e terrorizmit (në tekstin e mëtejme: pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit), si dhe punën dhe kompetencat e Drejtorisë së Inteligjencës Financiare (në tekstin e mëtejme: Drejtoria).

Përkufizime

Neni 2

Termat e përdorur në këtë ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. **“Pastrim parash”** janë veprimet e parashikuara nga Kodi Penal si vepër penale e pastrimit të parave dhe të ardhurave të tjera nga një vepër penale;
2. **“Financim i terrorizmit”** janë veprimet e parashikuara nga Kodi Penal si vepër penale e financimit të terrorizmit;
3. **“Akti terrorist”** është vepër penale e përcaktuar në nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, e ratifikuar në pajtim me Ligjin për Ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Financimit të Terrorizmit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 30/2004), si vepër penale terrorizëm dhe vepra të tjera penale të ndërlidhura me terrorizmin të përcaktuara me Kodin Penal;
4. **“Terrorist”** është personi fizik i cili:
 - a) kryen ose tenton të kryejë një akt terrorist në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije;
 - b) merr pjesë si bashkëpunëtor në një akt terrorist;
 - c) organizon ose urdhëron të tjerët të kryejnë një akt terrorist ose
 - ç) kontribuon në ekzekutimin e një akti terrorist nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, me qëllim të kryerjes së një akti terrorist dhe/ose duke e ditur qëllimin e grupit për të kryer një akt terrorist;
5. **“Organizatë terroriste”** është një grup terroristësh të cilët:
 - a) kryen ose tenton të kryejë një akt terrorist në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije;
 - b) merr pjesë si bashkëpunëtor në një akt terrorist;
 - c) organizon ose urdhëron të tjerët të kryejnë një akt terrorist ose

(*) Ky ligj është në pajtim me Direktivën e BE-së 2018/843 së Parlamentit Europian dhe Këshillit për parandalimin e keqpërdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga viti 2018 (CELEX nr. 32018L0843) me të cilën bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Urdhërësës së BE-së 2015/849 e Parlamentit Europian dhe Këshillit për parandalimin e keqpërdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga viti 2015 (CELEX nr. 32015L0849).

ç) kontribuon në ekzekutimin e një akti terrorist nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët, me qëllim të kryerjes së një akti terrorist dhe/ose duke e ditur qëllimin e grupit për të kryer një akt terrorist;

6. **”Të ardhura nga një vepër penale”** janë të ardhura nga një vepër penale në pajtim me Kodin penal;

7. **”Vepër penale e ndërlidhur”** është një vepër penale që krijon të ardhura që mund të jenë objekt i krimit të pastrimit të parave;

8. **“Pasuri”** nënkupton para ose mjete të tjera pagese, letra me vlerë, depozita, pasuri të çdo forme, materiale ose jomateriale, duke përfshirë asetet virtuale në pajtim me ligjin, të luajtshme ose të paluajtshme, të drejta të tjera mbi objektet, kërkesat, si dhe dokumente publike dhe dokumente ligjore për pronësinë dhe pasurinë në formë të shkruar ose elektronike ose instrumente që janë dëshmi të të drejtave pronësore ose të interesave ligjore.

9. **“Institucione financiare”** janë:

a) bankat dhe kursimoret të themeluara me leje të guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, veprimtaria kryesore e të cilave është grumbullimi i depozitave dhe burimeve të tjera kthyesë të mjeteve nga publiku dhe miratimi i kredive në emër dhe për llogarinë e vet;

b) persona juridik që nuk janë banka ose kursimore që kryejnë një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme:

- kreditimin, duke përfshirë faktoringun dhe financimin e transaksioneve komerciale,
- dhënia dhe administrimi i mjeteve pagesore (kartela me para të gatshme, çeqe, çeqe udhëtimi, kambiale),

- emetimi i parave elektronike,

- lizingu financiar,

- operacionet e këmbimit valutor,

- shërbimet pagesore brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë depozitimin dhe tërheqjen e parave të gatshme në llogari pagesore, aktivitetet që lidhen me hapjen, mbajtjen/mirëmbajtjen dhe mbylljen e llogarisë, kryerjen e transaksioneve pagesore, lëshimin e instrumenteve pagesore dhe/ose pranimit të transaksioneve pagesore, remitancat (transfer i shpejtë i parave) dhe shërbime të inicimit të pagesave,

- dhënie e garancive për pagim, avalëve dhe formave tjera për sigurim,

- tregtimin me instrumentet në tregun e parave,

- tregtimin me mjete devizore, që përfshin edhe tregtimin me metale fisnike,

- tregtimin me letra me vlerë,

- tregtimin me derivate financiare,

- menaxhim me mjete dhe portofol të letrave me vlerë për klientë dhe/ose këshillim investues të klientëve,

- dhënie të shërbimeve të ruajtjes së pronës të fondeve investuese dhe pensionale,

- shitblerjen, garantimin ose plasmanin e emisioneve të letrave me vlerë,

- ruajtjen e letrave me vlerë për klientët,

- këshillim i personave juridikë në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë afariste ose çështje tjera të lidhura ose dhënie të shërbimeve të lidhura me bashkim apo bashkëngjitje të personave juridikë,

- ndërmjetësimin në lidhjen e marrëveshjeve për kredi dhe për hua dhe

- përpunimin dhe analizën e informatave për aftësinë kreditore të personave juridikë,

c) personat juridikë dhe fizikë që kryejnë punë me sigurime, përfaqësim dhe/ose ndërmjetësim në sigurimin e jetës me komponentë kursimesh dhe/ose komponentë investuese dhe sigurime të tjera të lidhura me komponentën e kursimeve dhe/ose komponentën investuese;

ç) shoqëritë për menaxhim me fondet investuese private dhe fondet private;

d) shoqëritë për menaxhim me fondet e hapura investuese dhe fondet e mbyllura investuese;

- dh) shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare;
- e) filialet e institucioneve të huaja financiare nga nënpikat a, b, c, ç, d, dh të kësaj pike në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- ë) SHA “Posta e Maqedonisë së Veriut” në pjesën e veprimtarisë që u referohet fletëpagesave postare me para;
- f) dhe persona tjerë juridikë apo fizikë të cilët në pajtim me ligjin kryejnë një apo më tepër aktivitete në lidhje me miratimin e kredive, lëshimin e parave elektronike, lëshimin dhe administrimin e kartelave kreditore, lizingun financiar, faktoringun, forfetingun, dhënieën e shërbimeve të këshilltarit investues, ndërmjetësim gjatë mikropagesave, ruajnë apo administrojnë / shpërndajnë para në dorë dhe aktivitete tjera financiare të përcaktuara me ligj;
10. **“Marrëdhënie afariste”** është marrëdhënia afariste, profesionale apo komerciale, që lidhet me aktivitetet profesionale dhe afariste të subjektit nga neni 5 të këtij ligji dhe për të cilën pritet në momentin e vendosjes së tij të ketë element të kohëzgjatjes;
11. **“Transaksion i përkohshëm”** është transaksioni që nuk kryhet në kornizat e marrëdhënies së vendosur afariste;
12. **“Klient”** është person fizik, person juridik, trust i huaj dhe aranzhman i ngjashëm juridik që vendos, ka vendosur marrëdhënie afariste me subjektin apo kryen transaksion të përkohshëm;
13. **“Transaksion”** është arkëtimi dhe/apo pagesa e parave të gatshme, arkëtimi (pranimi) dhe pagesa e depozitës, shkëmbimi i valutave, transferimi i fondeve, blerja, shitja, këmbimi, marrja dhe transferimi i mjeteve virtuale, lidhja e kontratave, furnizimi dhe shitblerja e mallrave dhe shërbimeve, shitja apo lëshimi i investimeve themeluese, shitblerja apo lëshimi i aksioneve, regjistrimi i letrave me vlerë ose transferimi i letrave me vlerë ose pasurive të tjera dhe veprimtari të tjera të kryera nga subjektet në pajtim me autorizimet ligjore. Në veprimtarinë e sigurimeve nënkupton pagesën e premisë dhe pagesën e shumës së siguruar ose pagesën në rast të një ngjarje të dëmshme, paradhënie/hua ose shlyerje të policës së sigurimit të jetës;
14. **“Transaksione të lidhura me para të gatshme”** janë dy ose më shumë transaksione me para të gatshme që kryhen brenda një dite pune nga kryerja e transaksionit të parë nga i njëjti klient ose ndërmjet të njëjtëve klientë ose pronarë të vërtetë ose të kryera nga disa persona në dobi të të njëjtit klient;
15. **“Paratë (para të gatshme)”** do të thotë para, kartëmonedha ose para elektronike;
16. **“Para të gatshme”** janë kartëmonedha dhe monedha metalike që me ligj janë në qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtetin e huaj;
17. **“Para elektronike”** janë paratë elektronike në pajtim me ligjin;
18. **“Kartë pagesore me abonim (kartë pagesore me parapagesë)”** është një lloj instrumenti pagese në të cilin ruhen paratë elektronike;
19. **“Asete virtuale”** janë regjistrime digjitale të vlerave ose të drejtave që mund të ruhen, tregtohen ose transmetohen në mënyrë elektronike duke përdorur teknologjinë e ruajtjes së shpërndarë të të dhënave dhe të dhënave të koduara ose çdo teknologji të ngjashme dhe mund të përdoren për qëllime shkëmbimi ose investimi. Asetet virtuale nuk përfshijnë regjistrime digjitale të monedhave fiat ose parave sipas kuptimit të ligjit, të cilat paraqesin mjet pagesor ligjor, letra me vlerë dhe mjete të tjera financiare në pajtim me ligjin;
20. **“Ofrues i shërbimeve në lidhje me asetet virtuale”** është çdo person fizik ose juridik, biznesi dhe veprimtaria profesionale e të cilit konsiston në kryerjen e një ose më shumë aktiviteteve ose në ofrimin e një ose më shumë shërbimeve në lidhje me asetet virtuale për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik;
21. **“Shërbime ose aktivitete që lidhen me asetet virtuale”** janë aktivitetet dhe shërbimet që lidhen me çfarëdo aset virtual dhe përfshijnë:
- (a) ruajtjen dhe administrimin e asetëve virtuale ose instrumenteve që mundësojnë kontrollin mbi asetet virtuale;
- (b) organizimi i një platforme të tregtimit me asetet virtuale;

(c) shkëmbimi i aseteve virtuale për monedhën fiat, para elektronike ose asete të tjera që paraqesin mjete pagesore ligjore;

(ç) shkëmbimi i aseteve virtuale me asete të tjera virtuale;

(d) ekzekutimi i urdhërpagesave për asete virtuale për palë të treta;

(dh) pjesëmarrja dhe sigurimi i shërbimeve në lidhje me ofertën e emetuesit dhe/ose shitjen e aseteve virtuale;

(e) menaxhimi i portofolit me asete virtuale;

(ë) pranimi dhe transferimi i urdhërpagesave të aseteve virtuale dhe

(f) sigurimi i këshillave lidhur me asetet virtuale.

22. “Ruajtja dhe administrimi i aseteve virtuale ose instrumenteve që mundësojnë kontrollin mbi asetet virtuale” nënkupton ruajtjen ose kontrollin e aseteve virtuale për palët e treta ose mjetet nëpërmjet të cilave mundësohet qasje në asetet virtuale, aty ku është e aplikueshme në formën e çelësave privat kriptografikë;

23. “**Organizimi i një platforme për tregtim me asete virtuale**” nënkupton organizimin dhe menaxhimin e një ose më shumë platformave të tregtimit me asete virtuale, në kuadër të të cilave mundësohet dhe lehtësohet pikëtakimi i interesave në blerjen dhe shitjen e aseteve virtuale nga palët e treta dhe të cilët mund të komunikojnë në një mënyrë e cila rezulton në një marrëveshje, pavarësisht nëse është një shkëmbim i një aseti virtual me një tjetër ose një aseti virtual për mjet ligjor pagesor;

24. “**Ekzekutimi i urdhërpagesave për asete virtuale për llogari të palëve të treta**” nënkupton veprimtarinë e blerjes ose shitjes së një ose më shumë aseteve virtuale ose porositjes së një ose më shumë aseteve virtuale për llogari të palëve të treta;

25. “**Pjesëmarrja dhe ofrimi i shërbimeve në lidhje me ofertën e emetuesit dhe/ose shitjen e aseteve virtuale**” nënkupton plasmanin e aseteve virtuale të sapoemtuara ose aseteve virtuale që tashmë janë emtuar, por që nuk pranohen për tregtim në platformën e tregtimit virtual, për një rreth të caktuar blerësish dhe që nuk përfshijnë një ofertë publike ose një ofertë për poseduesit aktual të aseteve virtuale të emetuesit;

26. “**Menaxhimi i portofolit të aseteve virtuale**” nënkupton administrimin me portofole individuale të aseteve virtuale, bazuar në një marrëveshje të lidhur paraprakisht me klientin individual;

27. “**Pranimi dhe transferimi i urdhërpagesave për asetet virtuale**” është shërbim që ka të bëjë me asetet virtuale, që u mundëson personave juridikë ose fizikë, pjesëmarrës në tregtim në pajtim me ligjin, pranimin e një vlere të caktuar në asete virtuale, që përkon me çmimin e mallit ose shërbimit të shitur ndaj konsumatorit të fundit dhe nëpërmjet shkëmbimit të aseteve virtuale në monedhë fiat, përkatësisht para në kuptimin e ligjit, bëhet transferimi i mjeteve në para te personat juridikë dhe fizikë pjesëmarrës në tregtim;

28. “**Emetues i aseteve virtuale**” është personi fizik ose juridik që ofron çfarëdo lloj aseti virtual ose kërkon pranimin e këtyre aseteve virtuale në një platformë të tregtimit të aseteve virtuale;

29. “**Oferta publike e aseteve virtuale**” është një ofertë ndaj palëve të treta për blerjen e aseteve virtuale në këmbim të monedhës fiat ose parave në kuptimin e ligjit ose të aseteve të tjera virtuale;

30. “**Ofrimi i këshillave lidhur me asetet virtuale**” nënkupton ofrimin, dhënien ose ofrimin e rekomandimeve të personalizuar ose specifike për një palë të tretë, ose me kërkesë të një pale të tretë ose me iniciativën e ofruesit të shërbimeve mbi asetet virtuale që jep këshilla, në lidhje me blerjen ose shitjen e një ose më shumë aseteve virtuale, ose përdorimin e shërbimeve lidhur me asetet virtuale;

31. **“Kriptomati”** është një aparaturë automatike ose pajisje elektromekanike nëpërmjet së cilës ofruesi i shërbimeve në lidhje me asetet virtuale tregton, shkëmben ose transferon asetet virtuale si mjet ligjor pagesor ose për asetet tjera virtuale ose ofron dhe shërbime të tjera në varësi të llojit të kriptomatit;

32. **“Portofoli elektronik i hostuar për asetet virtuale”** nënkupton çdo aset të ofruar nga një ofrues shërbimesh në lidhje me asetet virtuale për ruajtjen dhe/ose administrimin e asetëve virtuale në emër dhe për llogari të klientit ose përdoruesit;

33. **“Portofol elektronik i pahostuar për asetet virtuale”** nënkupton çdo mjet tjetër ruajtjeje dhe/ose administrim të asetëve virtuale, përveç një portofoli elektronik të hostuar në të cilin ruhen asetet virtuale;

34. **“Mjete pagesore fizikisht të transferueshme”** nënkupton çeqet e udhëtimit, çeqet, kambialet, fletëpagesat dhe mjete të tjera pagesore fizikisht të transferueshme që i paguhen prurësit ose janë të transferueshme pa kufizim;

35. **“Ofrues të shërbimeve të personave juridikë ose trusteve”** janë personat fizikë ose juridikë që në kuadër të veprimtarisë së tyre ofrojnë për palët e treta shërbimet vijuese:

a) themelojnë subjekte juridike;

b) veprojnë ose angazhojnë një person tjetër për të vepruar si organ drejtues ose anëtar i organit drejtues të personit juridik;

c) sigurojnë selinë, adresën afariste, adresën e korespondencës ose shërbime të tjera të ndërlidhura me një person juridik ose trust të huaj;

ç) veprojnë ose angazhojnë një person tjetër për të vepruar si administrues i një trusti të huaj ose aranzhman të ngjashëm ligjor i themeluar me një deklaratë eksplicite;

d) veprojnë ose angazhojnë një person tjetër për të vepruar si partner ose vepron si aksionar për një person tjetër (përveç një shoqërie tregtare të listuar në bursë);

36. **“Trusti”** është një marrëdhënie juridike e krijuar në pajtim me normat juridike të një shteti tjetër ndërmjet personit themelues, gjatë jetës (inter vivos) ose pas vdekjes, kur prona i është besuar për administrim një të besuari në dobi të një përdoruesi/grupi të përdoruesve ose për një qëllim të caktuar;

37. **“Pronar i vërtetë”** është çdo person fizik (persona) që është pronar përfundimtar i klientit ose kontrollon klientin dhe/ose personin fizik (personat) në emër dhe për llogari të të cilit kryhet transaksioni. Termi përfshin edhe personin fizik (personat) që ushtron kontroll përfundimtar dhe efektiv mbi një person juridik ose aranzhman juridik të huaj;

38. **“Regjistri i pronarëve të vërtetë”** është një sistem informativ që mundëson pranimin, regjistrimin, përpunimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe/ose dokumenteve për pronarët e vërtetë në formë elektronike;

39. **“Bartës të funksioneve publike”** janë:

a) personat fizikë të cilëve u është besuar ose u besohet një funksion publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në një shtet tjetër, si p.sh.:

- kryetarë të shteteve dhe qeverive, ministra dhe zëvendësministra ose ndihmësministra;

- përfaqësues të zgjedhur në pushtetin ligjvënës;

- gjykatës të gjykatave supreme ose kushtetuese ose bartës të tjerë të funksioneve të larta gjyqësore kundër vendimit të të cilëve, përveç rasteve të jashtëzakonshme, nuk mund të shfrytëzohen mjete juridike;

- anëtarë të organeve drejtuese të agjencive mbikëqyrëse dhe atyre rregullatore, institucioni shtetëror i auditimit dhe anëtarë të bordit të bankës qendrore;

- ambasadorë;

- oficerë të rangut të lartë në forcat e armatosura (grada më të larta se koloneli);

- persona të zgjedhur dhe të emëruar në pajtim me ligjin dhe anëtarë të organeve udhëheqëse dhe mbikëqyrëse të personave juridik të themeluar nga shteti;

- persona me funksione në parti politike (anëtarë të organeve ekzekutive të partive politike);

- persona të cilëve u është besuar ose u besohet një pozicion i theksuar në një organizatë ndërkombëtare, si drejtor, zëvendësdrejtor, anëtarë të këshillave udhëheqëse dhe mbikëqyrëse ose funksione të tjera të barazvlefshme dhe

- kryetarë të komunave dhe kryetarë të këshillave komunalë.

b) Si bartës të funksioneve publike nga nënpika a) e kësaj pike konsiderohen personat të paktën dy vjet pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, bazuar në një vlerësim të rrezikut të kryer më parë nga subjektet.

c) Termi “bartës të funksioneve publike” përfshin edhe:

- anëtarë të familjes së bartësit të funksionit publik, si më poshtë: bashkëshorti ose personi me të cilin bartësi i funksionit publik është në bashkësi jashtëmartesore, fëmijët dhe bashkëshortët e tyre ose personat me të cilët fëmijët e bartësit të funksionit publik janë në bashkësi jashtëmartesore ose prindërit e bartësit të funksionit publik;

- një person që konsiderohet bashkëpunëtor i ngushtë i bartësit të funksionit publik është një person fizik për të cilin dihet që ka pronësi të përbashkët juridike ose reale mbi një person juridik, ka lidhur marrëveshje ose ka krijuar marrëdhënie të tjera të ngushta afariste me bartësin e funksionit publik ose i cili është i vetmi pronar i vërtetë i një personi juridik ose aranzhmani juridik e që dihet se janë themeluar në dobi të bartësit të funksionit publik;

40. “**Masat e përkohshme**” janë ndalimi i përkohshëm i shfrytëzimit ose disponimit të parave, letrave me vlerë, fondeve ose pronës tjetër, ruajtjes së përkohshme dhe sigurimit në bazë të një vendimi të lëshuar nga gjykata ose një organi tjetër kompetent në procedurë të përcaktuar me ligj;

41. “**Marrëdhënie korespondente**” nënkupton:

a) kur një bankë si “korrespondente” i ofron shërbime bankare një banke tjetër si „respondent”, duke përfshirë menaxhimin e llogarisë dhe shërbimet që kanë të bëjnë me të njëjtën, si menaxhimi me para të gatshme, transfertat ndërkombëtare të parave, barazimin e çeqeve, pagesa që përdoren drejtpërdrejt nga palët e treta për qëllimin e kryerjes së punës në emër të tyre si dhe shërbimet lidhur me punët devizore dhe/ose

b) marrëdhëniet ndërmjet dhe brenda bankave dhe institucioneve të tjera financiare kur shërbime të ngjashme ofrohen përmes institucionit financiar korespondent nëpërmjet një institucioni financiar respondent, si dhe marrëdhëniet e krijuara lidhur me transaksionet me letra me vlerë ose transferta të parave;

c) marrëdhëniet ndërmjet dhe brenda institucioneve financiare dhe ofruesve të shërbimeve të lidhura me asetet virtuale kur shërbime të ngjashme ofrohen nëpërmjet një ofruesi të shërbimit lidhur me asetet virtuale që është korespondent i institucionit financiar respondent, si dhe marrëdhëniet e krijuara për transaksionet me asetet virtuale ose transferta të aseteve virtuale;

ç) kur një ofrues shërbimi lidhur me asetet virtuale si “korrespondent” ofron shërbime për një ofrues tjetër shërbimi të lidhur me asetet virtuale si “respondent”, duke përfshirë menaxhimin e instrumenteve që mundësojnë kontrollin mbi asetet virtuale dhe shërbimeve që lidhen me menaxhimin e aseteve virtuale që mundësojnë kontrollin mbi asetet virtuale, transfertat ndërkombëtare të aseteve virtuale si dhe marrëdhëniet e tjera të krijuara për transaksione me asetet virtuale ose transfertat e aseteve virtuale;

42. “**Transferta e parave**” do të thotë çdo transaksion, duke përfshirë remitencat, i cili të paktën pjesërisht kryhet në mënyrë elektronike në emër të paguesit nëpërmjet një ofruesi të shërbimit pagesorë me qëllim që fondet t'i vënë në dispozicion pranuesit nëpërmjet një ofruesi të shërbimit pagesorë, pavarësisht nëse paguesi dhe pranuesi është i njëjti person dhe nëse ofruesi i shërbimit pagesorë i paguesit dhe pranuesit është i njëjti;

43. “**Transferta e aseteve virtuale**” do të thotë çdo transaksion me asetet virtuale i kryer në mënyrë elektronike në emër të porositësit nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve lidhur me asetet virtuale me qëllim që asetet virtuale të vëhen në dispozicion të pranuesit, pavarësisht nëse porositësi dhe pranuesi është i njëjti person dhe pavarësisht nëse ofruesi i shërbimeve lidhur me asetet virtuale të porositësit dhe të pranuesit është i njëjti;

44. **“Programa”** është një akt i subjektit që përcakton rregullat, procedurat dhe udhëzimet për zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për reduktimin dhe menaxhimin efektiv të rrezikut të identifikuar lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

45. **“Person i autorizuar”** është personi i punësuar në subjekt dhe i emëruar nga organi drejtues i subjektit, i cili kujdeset për zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për bashkëpunimin me Drejtorinë;

46. **“Udhëheqësia e lartë e subjektit”** është personi që me ligj dhe akte të brendshme është i autorizuar të drejtojë dhe është përgjegjës për funksionimin e subjektit dhe që ka kompetenca dhe funksion përkatës për të marrë vendime që mund të ndikojnë në ekspozimin e subjektit ndaj rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimit të terrorizmit;

47. **“Person përgjegjës në subjektin juridik”** është personi përgjegjës në pajtim me Ligjin për kundërvajtje;

48. **“Shell bankë (“Bankë guackë”)** është një institucion financiar i cili në vendin ku është i regjistruar nuk ka hapësirë afariste, punonjës dhe organe drejtuese dhe nuk është anëtar i një grupi bankar ose grupi tjetër që i nënshtrohet mbikëqyrjes në bazë të konsoliduar;

49. **“Lojërat e fatit”** janë lojërat e fatit në pajtim me Ligjin për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese;

50. **“Grupi”** është një grup i shoqërive tregtare i përbërë nga shoqëria amë, filialet dhe shoqëritë në të cilat merr pjesë shoqëria amë ose filiala, si dhe shoqëritë tregtare që janë të ndërlidhura në një mënyrë të rregulluar nga dispozitata ligjore që rregullojnë shoqëritë tregtare;

51. **“Vlerësimi kombëtar i rrezikut”** është një proces gjithpërfshirës i identifikimit dhe analizimit të rreziqeve lidhur me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armatimit për shkatërrim në masë (financimi i proliferacionit) dhe rreziqeve të tjera relevante në një vend të caktuar, me qëllim të zhvillimit të masave adekuate për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe alokimit efikas të burimeve të disponueshme me qëllim të kontrollit, reduktimit apo eliminimit të rreziqeve të identifikuar dhe përmirësimit të sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

52. **“Njësia për inteligjencë financiare”** është organ qendror kombëtar përgjegjës për pranimin dhe analizimin e raporteve lidhur me transaksione dhe informata tjera të dyshimta që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe dërgimin e rezultateve nga analiza dhe informacionet tjera relevante tek organet kompetente, kur ekziston bazë për dyshim lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

53. **“Person juridik”** është njësi e vetëqeverisjes lokale, parti politike, ndërmarrje publike, shoqëri tregtare, shoqëri avokatësh, institucion, shoqatë, fondacion, lidhje dhe formë organizative e organizatës ndërkombëtare, shoqatë sportive dhe subjekt tjetër juridik në fushën e sportit, organizatë financiare dhe organizatë tjetër e përcaktuar me ligj e që është e regjistruar si person juridik apo formë tjetër organizative së cilës i njihet statusi i personit juridik;

54. **“Aranzhan juridik”** nënkupton trustin apo formë të ngjashme juridike e themeluar në pajtim me rregullativën e një shteti të huaj;

55. **“Vende me rrezik të lartë”** janë vendet që nuk kanë zbatuar ose kanë zbatuar në mënyrë të pamjaftueshme standardet ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe vendet e përcaktuara nga FATF, Bashkimi Europian si dhe vendet për të cilat organet ndërkombëtare kompetente kërkojnë të ndërmarrin kundërmasa përkatëse ose vendet e përcaktuara në pajtim me vlerësimin kombëtar të rrezikut;

56. **“FATF - Task Forca e Veprimit Financiar”** është një organ ndërqeveritar i formuar nga vendet e G7 në vitin 1989 me qëllim të vendosjes së standardeve dhe për të promovuar zbatimin dhe avansimin efektiv të standardeve, si dhe monitorimin e zbatimit efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operative lidhur me parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë (financimi i proliferimit) në nivel ndërkombëtar;

57. **“Rekomandimet e FATF-it”** janë standarde ndërkombëtare lidhur me parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të shkatërrimit në masë (financimi i proliferimit) të përcaktuara nga FATF;

58. **“Organizata jofitimprurëse”** janë persona juridik, aranzhman juridik ose organizatat të cilat prioritet kryesor kanë mbledhjen ose rishpërndarjen e mjeteve për qëllime bamirësie, fetare, kulturore, arsimore ose sociale ose çdo lloj veprimtarie tjetër bamirësie;

59. **“Financimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë”** nënkupton sigurimin e fondeve ose shërbimeve financiare që përdoren, plotësisht ose pjesërisht, për prodhimin, përvetësimin, posedimin, zhvillimin, eksportin, transportin transnacional, ndërmjetësimin, transportin, transferimin, ruajtjen ose përdorimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike dhe mjeteve të tyre të shpërndarjes dhe materialeve të lidhura me to (duke përfshirë dy teknologjitë dhe mallrat me përdorim të dyfishtë që përdoruren për qëllime jolegjitime), në kundërshtim me ligjin ose aktin ligjor të një organizate ndërkombëtare;

60. Termat interoperabilitet, dokument elektronik, mjet identifikimi elektronik, lëshues i mjeteve të identifikimit elektronik dhe skemë elektronike të identifikimit kanë të njëjtin kuptim konform Ligjit për Menaxhimin Elektronik dhe Shërbimet Elektronike dhe Ligjin për Dokumentet Elektronike, Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet Konfidenciale.

KAPITULLI II.

VLERËSIMI KOMBËTAR I RREZIKUT

Vlerësimi kombëtar i rrezikut nga pastrimi i parave, financimit të terrorizmit, armëve të shkatërrimit në masë dhe rreziqeve të tjera të ngjashme

Neni 3

(1) Republika e Maqedonisë së Veriut zbaton vlerësimin kombëtar të rrezikut me qëllim të identifikimit, vlerësimit, kuptimit dhe zvogëlimit të rrezikut lidhur me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, financimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe rreziqeve tjera të ndërlidhura, si dhe bën përditësimin e tij të paktën në çdo katër vjet.

(2) Këshilli për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në kuadër të këtij ligji është kompetent për bashkërendimin e aktiviteteve për zbatimin e vlerësimit kombëtar të rrezikut në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe përgatitjen e raportit lidhur me vlerësimin kombëtar të rrezikut.

(3) Raportin e vlerësimit kombëtar të rrezikut, Këshilli për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në kuadër të këtij ligji e dorëzon për miratim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Raporti i vlerësimit kombëtar të rrezikut si dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e raportit publikohen në faqen e internetit të Drejtorisë. Raporti i publikuar nuk përmban të dhëna me karakter konfidencial në pajtim me ligjin.

Qëllimet e vlerësimit kombëtar të rrezikut

Neni 4

(1) Konstatimet e raportit të vlerësimit kombëtar të rrezikut përdoren për:

- definimin dhe zbatimin e masave dhe veprimeve lidhur me parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe rreziqeve tjera që kanë të bëjnë me rrezikun e identifikuar;

- identifikimin e mangësive të sistemit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe masave për tejkalimin e tyre;

- përmirësimin e rregullativës kombëtare dhe sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- identifikimin e sektorëve ose aktiviteteve me rrezik më të ulët ose më të lartë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit;
- identifikimin e sektorëve apo aktiviteteve në lidhje me të cilët subjektet janë të detyruara të ndërmarrin masa të intensifikuara të analizës dhe sipas nevojës të përcaktojnë masa tjera që subjektet janë të detyruara të ndërmarrin;
- përcaktimi i prioriteteve dhe alokimi i burimeve me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë;
- përgatitja dhe sjellja e dispozitave relevante për sektorë ose aktivitete të caktuara dhe zbatimin e masave në pajtim me rreziqet e identifikuara lidhur me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë;
- informimin dhe ndihmën e subjekteve gjatë zbatimit të vlerësimit të rrezikut nga pastrimi i parave, financimi i terrorizmit, financimi i përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe rreziqeve të tjera gjegjëse;
- informimin për strukturën institucionale dhe veprimet e institucioneve kompetente në sistemin për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe rreziqeve të tjera gjegjëse, si dhe burimet e alokuara deri në shkallë të caktuar ku këto informacione janë të qasshme dhe
- informimin për masat dhe burimet kombëtare të destinuara për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe rreziqeve gjegjëse.

(2) Këshilli për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga ky ligj, në bazë të konstatimeve nga raporti për vlerësimin kombëtar të rrezikut, përgatit propozim-Strategji kombëtare për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me plan aksional të masave dhe aktiviteteve për zvogëlimin dhe menaxhimin e rreziqeve dhe pasojave të identifikuara lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe rreziqeve tjera gjegjëse si dhe ndjek zbatimin e saj dhe realizimin e plotë të planit aksional.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton Strategjinë kombëtare për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit së bashku me planin aksional lidhur me masat dhe aktivitetet nga paragrafi (2) i këtij neni, për një periudhë katërvjeçare.

KAPITULLI III.

MASA DHE VEPRIME TË CILAT I NDËRMARRIN SUBJEKTET PËR ZBULIMIN DHE PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Subjekte

Neni 5

Subjekte janë personat që janë të obliguar të ndërmarrin masa dhe veprime për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të paraparë me këtë ligj (në tekstin e mëtejshëm: subjekte), edhe atë:

- 1) Institucionet financiare dhe degët, filialet dhe njësitë afariste të institucioneve të huaja financiare që në pajtim me ligjin veprojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- 2) Personat juridikë dhe fizikë që si veprimtari afariste ose profesionale kryejnë shërbimet vijuese:

a) ndërmjetësim në qarkullimin me patundshmëri, përfshirë dhe/ose ndërmjetësim gjatë lidhjes së kontratave të qirasë për patundshmëri vetëm kur vlera e qirasë mujore është 10.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

b) shërbime auditimi dhe kontabiliteti;

c) dhënie e këshillave nga sfera tatimore ose çfarëdo lloj forme të ndihmës, mbështetjes ose këshillimit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një personi tjetër në fushën e taksave;

ç) ofrimin e shërbimeve si këshilltar investimesh dhe

d) ofrimin e shërbimeve për organizimin dhe realizimin e ankandeve;

3) Noterët, avokatët dhe shoqëritë e avokatëve që ushtrojnë autorizime publike në pajtim me ligjin;

4) Organizatorët e lojërave të fatit të cilët në pajtim me ligjin organizojnë lojëra të fatit në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

5) Ofruesit e shërbimeve për trustet ose personat juridikë;

6) Depozituesi qendror i letrave me vlerë;

7) Personat juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e marrjes së pengut të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme (dyqane pengjesh);

8) Personat që tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetës në tregtinë me vepra të artit, edhe atëherë kur veprimtaria kryhet nga galeritë e artit ose shtëpitë e ankandeve, ku vlera e transaksionit individual ose e disa transaksioneve të ndërlidhura është 10.000 euro në kundërvlerë në denarë ose më shumë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

9) Personat që magazinojnë, tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetës në tregtimin e veprave të artit, kur veprimtaria zhvillohet në zona të lira dhe ku vlera e transaksionit individual ose disa transaksioneve të ndërlidhura është 10.000 euro në kundërvlerë në denarë ose më shumë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe

10) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asetet virtuale.

Përfshirje në lidhje me personat juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë aktivitete financiare në baza të rastësishme ose të kufizuara

Neni 6

(1) Subjektet nga neni 5 të këtij ligji, të cilët kryejnë veprimtari financiare në baza të përkohshme ose të kufizuar dhe për të cilat vlerësimi kombëtar i rrezikut është përcaktuar me rrezik të ulët nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, nuk janë të obliguar t'i zbatojnë masat dhe veprimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të parashikuara nga ky ligj, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- veprimtaria financiare është dytësore dhe e lidhur drejtpërdrejtë me aktivitetin kryesor afarist,

- qarkullimi vjetor neto nga aktiviteti financiar nuk kalon 100.000 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose 5% nga qarkullimi i përgjithshëm vjetor i subjektit,

- veprimtaria kryesore nuk është ofrimi i shërbimeve auditore, organizimi i lojërave të fatit, shërbime të kontabilitetit, shërbime të këshilltarëve tatimor, aktivitete ndërmjetësimi në qarkullimin me pasuri të patundshme, ofrimi i shërbimeve për trustet ose personat juridik ose shërbime noteriale dhe shërbime të avokatëve,

- vlera më e lartë e transaksionit për klient dhe për transaksion individual, pavarësisht nëse kryhet si një apo disa transaksione që duket se janë të ndërlidhura, nuk duhet të kalojë 500 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe

- aktiviteti financiar kryhet vetëm për persona të cilët janë klientë shikuar nga aspekti i aktivitetit kryesor afarist dhe përgjithësisht nuk është në dispozicion për publikun.

(2) Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni nuk vlejnë për personat juridik, tregtar individual ose persona fizikë të cilët në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari nëse bëjnë remitenca në pajtim me ligjin.

(3) Subjekti i paragrafit (1) të këtij neni parashtron kërkesë për moszbatimin e dispozitave të këtij ligji në Drejtori. Kërkesës i bashkëngjitet dokumentacioni nga i cili mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet e paragrafit (1) të këtij neni, si dhe dokumentacioni për vlerësimin e rrezikut të kryer nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit për secilin aktivitet financiar.

(4) Për kërkesën e paragrafit (3) të këtij neni, Drejtoria sjell vendim në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

(5) Vendimi i paragrafit (4) të këtij neni është i vlefshëm dy vjet nga momenti i sjelljes së tij. Pas skadimit të vlefshmërisë së vendimit, për t'u përjashtuar nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, subjekti paraqet kërkesë të re në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

(6) Nëse rrethanat në bazë të të cilave është lëshuar vendimi ndryshohen para skadimit të vlefshmërisë së vendimit, subjekti nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar që për këto ndryshime ta njoftojë Drejtorinë në afat prej pesëmbëdhjetë ditë nga dita e lëshimit. Në bazë të këtij njoftimi ose në bazë të informatave tjera, Drejtoria sipas detyrës zyrtare merr vendim të ri me të cilin anulon vendimin e mëparshëm dhe vendos për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Neni 7

(1) Noterët, avokatët dhe shoqëritë e avokatëve që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin janë të obliguar t'i zbatojnë masat dhe veprimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në rastet kur u ofrojnë shërbime juridike klientëve të tyre kur kemi të bëjmë me aktivitetet e mëposhtme:

- a) blerjen dhe shitjen e pasurive të patundshme dhe të tundshme;
- b) administrimin e parave, letrave me vlerë ose me pronën dhe mjetet tjera të klientit;
- c) hapjen dhe administrimin e llogarive bankare, llogarive të kursimeve, kasafortave ose llogarive për tregtim me letra me vlerë (ang. Securities accounts);
- d) organizimin e mbledhjes së mjeteve për themelimin, funksionimin ose menaxhimin e personave juridik;
- e) themelimin, funksionimin ose menaxhimin e personave juridik ose aranzhmaneve juridike, blerjen dhe shitjen e personave juridikë ose aranzhmaneve juridike dhe çdo formë ndihme, mbështetjeje ose këshillimi, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një personi tjetër për qëllime të shitjes ose blerjes së personave juridik ose aranzhmaneve juridike.

(2) Obligimet që burojnë nga ky ligj nuk vlejnë për avokatët dhe shoqatat e avokatëve gjatë kryerjes së funksionit të mbrojtjes dhe përfaqësimit të klientit në procedurat gjyqësore. Në këtë rast, avokatët dhe shoqatat e avokatëve, me kërkesë të Drejtorisë, në afat prej shtatë ditësh duhet të paraqesin arsyetim me shkrim për shkaqet për të cilat nuk kanë vepruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Ofruesit e shërbimeve lidhur me asetet virtuale

Neni 8

(1) Drejtoria mirëmban dhe menaxhon regjistër të ofruesve të shërbimeve lidhur me asetet virtuale në formë elektronike i cili publikohet në faqen e internetit të Drejtorisë.

(2) Regjistri i ofruesve të shërbimeve lidhur me asetet virtuale përmban:

1) emrin e personit juridik, selinë, adresën elektronike, numrin e vetëm të identifikimit personal (NUIP) dhe numrine vetëm të tatimit (NUT), datën e themelimit dhe kodin e veprimtarisë;

2) të dhënat për anëtarët e organit drejtues (emri dhe mbiemri, numri unik amë ose numër tjetër identifikues, adresa e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimi, data e lindjes dhe shtetësia dhe në çfarë cilësie është në organin drejtues);

3) përshkrimin e llojit të shërbimeve dhe aktiviteteve që i kryen në kuptim të këtij ligji, duke përfshirë nëse të njëjtat i kryen duke përdorur kriptomat/ët;

4) të dhënat për domenin përmes të cilit ofruesi i shërbimeve lidhur me asetet virtuale kryen veprimtari profesionale dhe afariste nëse të njëjtën e kryen përmes rrjetit të komunikimit elektronik (internetit), dhe

5) të dhëna dhe informacione për vendosjen e marrëdhënieve afariste me persona juridik të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të ofruesit të shërbimeve në lidhje me asetet virtuale.

(3) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asetet virtuale janë të obliguar ta informojnë Drejtorinë nga ky ligj se kryejnë aktivitete të përcaktuara me këtë ligj, në afat prej 30 ditësh nga dita e regjistrimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht 30 ditë nga dita e fillimit të ofrimit të shërbimeve në lidhje me asetet virtuale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për ofruesit e shërbimeve të cilët nuk janë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të dorëzojnë të dhëna, informata dhe dokumente nga burime të besueshme dhe të pavarura në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Nëse dyshohet për saktësinë e të dhënave të dorëzuara nga paragrafi (2) të këtij ligji, Drejtoria në çdo kohë mund të kërkojë dokumente shtesë, të dhëna dhe informacione për aktivitetet dhe shërbimet e ofruesit të shërbimeve lidhur me asetet virtuale.

(5) Ofruesit e shërbimeve janë të detyruar t'i dorëzojnë dokumentet shtesë, të dhënat dhe informacionet për aktivitetet dhe shërbimet në lidhje me asetet virtuale nga paragrafi (4) i këtij neni, brenda dhjetë ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Ministri i financave e përshkruan mënyrën e menaxhimit, formën dhe përmbajtjen e regjistrit nga paragrafi (1) i këtij neni.

2. MASAT DHE VEPRIMET PËR ZBULIMIN DHE PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Neni 9

Masat dhe veprimet për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: masat dhe veprimet), të cilat ndërmerren nga subjektet janë:

- përgatitja e vlerësimit të rrezikut lidhur me pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit dhe përditësimin e tij të rregullt,
- përgatitja dhe zbatimi i programeve për reduktimin dhe menaxhimin efektiv të rrezikut të identifikuar lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit,
 - analizë të klientëve,
 - njoftimin dhe dorëzimin e të dhënave, informacioneve dhe dokumentacionit deri tek Drejtoria, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të dalura nga i njëjti,
 - ruajtja, mbrojtja dhe mbajtja e evidencës së të dhënave,
 - emërimi i një personi të autorizuar dhe zëvendës të tij dhe/ose krijimi i një njësie për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - zbatimin e kontrollit të brendshëm dhe
 - masa të tjera që burojnë nga dispozitat e këtij ligji.

Neni 10

(1) Obligimi për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve të parapara me këtë ligj ekziston edhe në rastet kur subjektet janë në procedurë falimentimi dhe likuidimi.

(2) Obligimin nga paragrafi (1) i këtij neni, e kryen administratori i falimentimit deri në fund ose në finalizimin e procedurës së falimentimit, përkatësisht një likuidator deri në përfundimin e procedurës së likuidimit.

Përgatitja e vlerësimit të rrezikut lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit

Neni 11

(1) Subjektet janë të detyruara të përgatisin vlerësimin e rrezikut lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit për të identifikuar, vlerësuar, kuptuar dhe zvogëluar rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë parasysh faktorët e rrezikut që kanë të bëjnë me:

- a) klientin;
- b) shtetet ose rajonet gjeografike;
- c) produktet, shërbimet ose transaksionet dhe
- ç) kanalet e shpërndarjes.

(2) Vlerësimi i rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jetë i dokumentuar dhe konform me madhësinë e subjektit, llojin, shtrirjen dhe kompleksitetin e aktivitetit të tij afarist.

(3) Subjekti është i obliguar që rregullisht ta përditësojë vlerësimin e rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Subjekti është i obliguar që vlerësimin e rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni ta dorëzojë me kërkesë të organeve kompetente të mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji.

(5) Subjekti është i obliguar që vlerësimin e rrezikut nga paragrafi (1) i këtij neni ta harmonizojë me vlerësimin kombëtar të rrezikut si dhe me aktet, dokumentet dhe informacionet tjera të publikuara nga organet kompetente të mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji.

(6) Subjekti është i detyruar, para se të bëjë ndryshime të rëndësishme në aktivitetet dhe proceset e tij afariste, të cilat mund të ndikojnë në masat e ndërmarra për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe në futjen e një produkti, shërbimi, aktiviteti ose kanali të ri shpërndarjeje, si dhe gjatë futjes së teknologjive të reja, të kryejë vlerësimin e rrezikut për të përcaktuar dhe vlerësuar se si ndryshimet ndikojnë në ekspozimin e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe është i detyruar të ndërmarrë masat përkatëse për zvogëlimin dhe menaxhimin efektiv të rrezikut.

(7) Organet e mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji janë të obliguara të përgatisin udhëzime për kryerjen e vlerësimit të rrezikut për subjektet për të cilat kryejnë mbikëqyrje.

Përgaditja dhe zbatimi i Programeve për zvogëlimin dhe menaxhimin efektiv të rrezikut të identifikuar lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit

Neni 12

(1) Subjektet janë të detyruara të përgatisin dhe zbatojnë Program për zvogëlimin dhe menaxhimin efektiv të rrezikut të identifikuar lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, e cila përmban:

- qëllimet, fushëveprimin dhe mënyrën e funksionimit të sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të subjektit,

- strukturën organizative të subjektit, pozitën e personit të autorizuar dhe zëvendësit të tij në strukturën organizative,

- të dhënat për personin e autorizuar dhe zëvendësin e tij,

- autorizimet dhe përgjegjësitë e personit të autorizuar dhe zëvendësit të tij,

- autorizimet dhe përgjegjësitë e të gjithë punonjësve të subjektit që marrin pjesë në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore që burojnë nga i njëjti,

- konkluzionet nga zbatimimi i vlerësimit të rrezikut dhe mënyrën e menaxhimit të rrezikut lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit,
- masat e analizës së klientit dhe pranueshmërisë së klientëve,
- mënyrën e identifikimit të transaksioneve jo të zakonshme dhe transaksioneve të dyshimta për pastrim parash dhe financim të terrorizmit,
- mënyrën e vendosjes së një mekanizmi të brendshëm për njoftim adekuat dhe në kohë,
- mënyrën e ruajtjes së të dhënave dhe dokumenteve,
- mënyrën e dorëzimit të raporteve në Drejtori,
- planin e trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve të subjektit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili siguron realizimin e të paktën dy trajnimeve gjatë vitit,
- procedurën dhe planin për kryerjen e kontrollit të brendshëm për zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që janë adekuate për madhësinë dhe llojin e subjektit dhe
- procedurat lidhur me skringun (screening) gjatë punësimit dhe për punonjësit për të siguruar standarde të larta për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(2) Për subjektet nga ky ligj që janë të obliguar të themelojnë njësi të veçantë sipas këtij ligji, programi, përveç elementeve të paragrafit (1) të këtij neni, duhet të përmbajë edhe elemente për funksionin e pavarur të auditimit për testimin e tërësishëm të sistemit të brendshëm të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit varësisht nga madhësia dhe natyra e veprimtarisë së subjektit.

(3) Menaxhmenti i lartë i subjektit është i obliguar ta miratojë programën nga paragrafi (1) i këtij neni, të monitorojë dhe vlerësojë rregullisht përshtatshmërinë, përputhshmërinë dhe efikasitetin e saj dhe sipas nevojës, t'i përforcojë masat që i ndërmerri subjekti.

Analiza e klientit

Neni 13

Subjektet janë të detyruara të kryejnë analizë të klientëve si në rastet e mëposhtme:

- a) kur vendoset një marrëdhënie afariste me klientin;
- b) kur realizohet një transaksion i përkohshëm në vlerë prej 15.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse transaksioni kryhet si një operacion apo disa operacione, që janë dukshëm të ndërlidhura;
- c) kur realizohet një transaksion i përkohshëm i cili paraqet transferim të parave të gatshme, duke përfshirë asete virtuale në vlerë mbi 1.000 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- ç) tek lojërat e fatit në rast të deponimit dhe pagesës së fitimeve, si dhe gjatë blerjes ose pagesës së çipave ose kredive në vlerë prej 1000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse transaksioni kryhet si një transaksion apo disa transaksione që dukshëm janë të ndërlidhura dhe të cilat arrijnë vlerën e përgjithshme prej 1000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonia së Veriut;
- d) kur ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra më parë për identitetin e klientit ose të pronarit të vërtetë dhe
- dh) kur ekziston dyshimi për pastrim parash ose financim të terrorizmit, pavarësisht nga ndonjë përjashtim ose shumës së mjeteve.

Rastet kur nuk zbatohet analiza e klientit

Neni 14

(1) Subjektet nuk janë të obliguar t'i zbatojnë masat e nenit 15 të këtij ligji në lidhje me paratë elektronike, nëse me Vlerësimin kombëtar të rrezikut konstatojnë rrezik të ulët nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dhe nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

1) Instrumenti i pagesës nuk plotësohet, ose vlera e përgjithshme e transaksioneve në bazë mujore është e kufizuar në vlerë prej 150 euro në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mund të përdoret vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

2) Vlera maksimale e instrumentit të pagesës nuk kalon 150 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

3) Instrumenti i pagesës përdoret ekskluzivisht për furnizimin e mallrave ose shërbimeve;

4) Instrumenti i pagesës të mos lëshohet në mënyrë anonime, dhe

5) Emetuesi i instrumentit të pagesës ndjek dhe kontrollon transaksionet ose marrëdhëniet afariste, me qëllim që të zbulojë transaksione të ndërlikuara ose jo të zakonshme ose transaksione të dyshimta.

(2) Përjashtimi nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk do të vlej në rastet e blerjes së parave elektronike në para të gatshme ose tërheqjes së parave elektronike në vlerë ekuivalente të parave elektronike më shumë se 50 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur ekzistojnë arsye për dyshime për pastrim të parave ose financim të terrorizmit.

Masat e analizës së klientit

Neni 15

(1) Analiza e klientit sipas nenit 13 të këtij ligji përfshin:

a) identifikimin e klientit dhe konfirmimin e identitetit të tij duke përdorur dokumente, të dhëna dhe informacione nga burime të besueshme dhe të pavarura, duke përfshirë përdorimin e mjeteve elektronike të identifikimit të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikimin elektronik në nivel të lartë sigurie në pajtim me ligjin nëse është e mundur;

b) identifikimin e personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit dhe konfirmimin se i njëjti është i autorizuar si dhe konfirmimin e identitetit të tij duke përdorur dokumente, të dhëna dhe informacione nga burime të besueshme dhe të pavarura, duke përfshirë përdorimin e identifikimit të mjeteve elektronike të lëshuara sipas një skeme të regjistruar për identifikimin elektronik në nivel të lartë sigurie në pajtim me ligjin nëse është e mundur;

c) identifikimin e pronarit të vërtetë të klientit dhe ndërmarrjen e masave përkatëse për verifikimin e identitetit të tij, duke përdorur dokumente, të dhëna dhe informacione nga burime të besueshme dhe të pavarura, me qëllim që subjekti të bindet se e di se cili është pronari i vërtetë;

ç) kuptimin dhe sigurimin e duhur të informacioneve mbi qëllimin dhe synimin e marrëdhënies afariste dhe

d) monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve afariste e që nënkupton:

- monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve që realizohen në kuadër të marrëdhënieve të vendosura afariste për t'u siguruar që këto transaksione janë konzistente me profilin e rrezikut dhe biznesin e klientit, dhe në rast se është e nevojshme të përcaktohet burimi i mjeteve dhe

- të sigurohet që dokumentet dhe të dhënat e mbledhura gjatë analizës së klientit janë të vlefshme, të përditësuara dhe relevante përmes verifikimit të rregullt të tyre, veçanërisht për klientët me rrezik më të lartë.

(2) Kur klienti është person juridik ose aranzhman juridik, subjekti është i detyruar të ndërmarra masa lidhur me përcaktimin e strukturës së pronësisë dhe të kontrollit.

(3) Subjekti është i obliguar të sigurojë informacione të mjaftueshme që të vërtetohet që mund ta konfirmojë identitetin e shfrytëzuesit ose grupit të shfrytëzuesve të trustit ose një aranzhmani tjetër juridik, në momentin e pagesës ose në kohën kur shfrytëzuesi ose grupi i shfrytëzuesve të pasurisë vendos të përdorë të drejtat e dhëna.

(4) Subjektet janë të detyruar të bëjnë vlerësimin e rrezikut për çdo klient dhe të zbatojnë secilën masë nga analiza e klientit, në pajtim me profilin e rrezikut të klientit.

(5) Subjektet janë të detyruara t'u vënë në dispozicion dokumentet për vlerësimin e rrezikut të klientit, organeve kompetente të mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji, për të vërtetuar se rreziku i përcaktuar nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit është i përshtatshëm dhe se masat e ndërmarra janë në pajtim me rrezikun e klientit.

(6) Subjektet janë të detyruara të zbatojnë masat për analizën e klientit dhe të klientëve ekzistues në bazë të rëndësisë, relevancës, rrezikut dhe t'i zbatojnë në një periudhë të përshtatshme kohore dhe duke marrë parasysh aktivitetet e mëparshme që janë ndërmarra në kuadër të analizës së klientit dhe përshtatshmërisë së të dhënave të fituara.

Identifikimi dhe verifikimi i identitetit

Neni 16

(1) Subjektet janë të detyruara të identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e klientit, personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit dhe pronarit të vërtetë, para se të vendosin marrëdhënie afariste ose para kryerjes së një transaksioni të përkohshëm.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, subjektet mund të verifikojnë identitetin e klientit, personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit, autorizuesit ose të pronarit të vërtetë gjatë vendosjes së marrëdhënies afariste, në mënyrë që të mos pengohet ecuria e marrëdhënies afariste dhe kur ka rrezik të ulët të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(3) Për çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin e jetës, lejohet verifikimi i identitetit të klientit, personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit, autorizuesit ose pronarit të vërtetë të policës, të kryhet pas vendosjes së marrëdhënies afariste. Në këtë rast verifikimi i identitetit duhet të bëhet përpara ose gjatë pagesës së policës ose përpara ose kur shfrytëzuesi synon të ushtrojë të drejtat që burojnë nga polica.

Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të klientit

Neni 17

(1) Kur klienti është person fizik, i njëjti identifikohet dhe verifikohet identiteti i tij duke paraqitur një dokument identifikimi origjinal dhe të vlefshëm, të lëshuar nga organi kompetent, duke përfshirë përdorimin e mjeteve të identifikimit elektronik të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikimin elektronik të nivelit të lartë të sigurisë në pajtim me ligjin, nëse është e mundur.

(2) Me dokumentin nga paragrafi (1) i këtij neni, dhe nëse është e mundur edhe nga të dhënat identifikuese të personave që përdorin mjete për identifikim elektronik, përcaktohen emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, vendi dhe adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, numri i vetëm i amzës ose numri i identifikimit dhe numri i dokumentit valid të identifikimit ose numri serik i mjetit për identifikim elektronik, organi që ka lëshuar dokumentin dhe datën e vlefshmërisë, përkatësisht emrin e lëshuesit të mjetit të identifikimit elektronik dhe periudhën e vlefshmërisë së mjeteve të identifikimit elektronik.

(3) Kur klienti është person juridik, identifikohet dhe verifikohet identiteti i tij me dokument regjistrimi në origjinal ose kopje të noterizuar, të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku personi juridik është i regjistruar, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se gjashtë muaj, veçanërisht duke përdorur mjete elektronike të identifikimit të lëshuara sipas një skeme identifikimi elektronik të regjistruar në një nivel të lartë sigurie në pajtim me ligjin nëse është e mundur. Dokumenti i regjistrimit ose themelimit dorëzohet në formë të shkruar dhe/ose në formë elektronike. Dokumentet e regjistrimit të lëshuara nga organi kompetent i shtetit të huaj duhet të përkthehen në gjuhën maqedonase nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor.

(4) Nga dokumenti i paragrafit (3) të këtij neni, dhe nëse është e mundur nga të dhënat identifikuese të personave juridik që përdorin mjete për identifikim elektronik, përcaktohet emri, forma juridike, selia, numri tatimor ose një numër tjetër regjistruar i personit juridik, përfaqësuesit ligjor, organit drejtues ose personave të autorizuar për të vendosur marrëdhënie afariste, përkatësisht për të kryer një transaksion në emër të klientit.

(5) Kur klienti është aranzhman juridik, ai identifikohet dhe identiteti i tij verifikohet me aktin e themelimit të aranzhmanit juridik në origjinal ose kopje e noterizuar që përcakton formën, selinë, numrin tatimor ose numër tjetër të regjistrimit të aranzhmanit juridik, themeluesi/të, i/të besuar/it, shfrytëzuesi ose grupi i shfrytëzuesëve të aranzhmanit juridik, përfaqësuesi ligjor, organi drejtues dhe personat e autorizuar për të vendosur marrëdhënie afariste, përkatësisht për të kryer një transaksion në emër të klientit.

(6) Subjektet detyrimisht mbajnë kopje në formë të shkruar dhe/ose në formë elektronike të dokumenteve nga paragrafët (1), (3) dhe (5) të këtij neni, si dhe mbajnë evidencë elektronike të të dhënave nga paragrafët (1), (3) dhe (5) të këtij neni për identifikimin e personave që kanë përdorur mjete për identifikim elektronik të siguruar përmes përdorimit të mjeteve të identifikimit elektronik të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikim elektronik të nivelit të lartë të sigurisë, gjatë së cilës zbatojnë masa teknike dhe organizative në pajtim me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me ligjin.

(7) Subjektet mund të kërkojnë nga klienti të dhëna, informacione dhe dokumente tjera dhe/ose të kërkojnë burime të besueshme dhe të pavarura për verifikimin e identitetit të klientit.

(8) Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të klientit me anë të mjeteve të identifikimit elektronik të lëshuar në kuadër të skemës së regjistruar për identifikim elektronik të nivelit të lartë të sigurisë sipas këtij ligji nuk lejohet:

1) për produktet, shërbimet, transaksionet ose kanalet e shpërndarjes për të cilat është përcaktuar rrezik i lartë lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

2) nëse klienti është person fizik i mitur;

3) nëse klienti është person fizik ose juridik i cili është shtetas ose ka vendbanim ose vendqëndrim, përkatësisht seli në një shtet me rrezik të lartë në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

4) nëse subjekti konstaton se mjeti i identifikimit elektronik nuk është i vlefshëm dhe lëshuesi i skemës së identifikimit elektronik të regjistruar ende nuk e ka suspenduar atë;

5) nëse mjeti për identifikim elektronik nuk përmban të dhënat e nevojshme në pajtim me këtë nen.

Identifikimi dhe verifikimi i personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit

Neni 18

(1) Subjektet janë të detyruara të verifikojnë nëse personi vepron në emër dhe për llogari të klientit.

(2) Në rastet e paragrafit (1) të këtij neni, subjektet janë të detyruara të identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit, klientin ose bartësin e të drejtave dhe autorizimin edhe atë mbi bazën e dokumenteve, të dhënave dhe

informacioneve nga burime të besueshme dhe të pavarura, nëse është e mundur përdorimin e mjeteve të identifikimit elektronik të lëshuara sipas një skeme të regjistruar elektronike të identifikimit në nivel të lartë sigurie në pajtim me ligjin.

(3) Subjektet janë të detyruara që autorizimin nga paragrafi (2) i këtij neni ta sigurojnë në origjinal ose kopje të noterizuar.

(4) Subjektet detyrimisht mbajnë kopje në formë të shkruar dhe/ose në formë elektronike të dokumenteve nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, si dhe mbajnë evidencën elektronike të të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni për identifikimin e personave të cilët kanë shfrytëzuar mjete për identifikimin elektronik të siguar përmes përdorimit të mjeteve elektronike të identifikimit të lëshuara sipas skemës së regjistruar elektronike të identifikimit në nivel të lartë sigurie, me ç'rast zbatohen masa teknike dhe organizative në pajtim me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

(5) Dokumentet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, të lëshuara ose të vërtetuara nga organi kompetent i shtetit të huaj, duhet të përkthehen në gjuhën maqedonase nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor.

Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të pronarit të vërtetë

Neni 19

(1) Subjektet janë të detyruara të identifikojnë pronarin e vërtetë të klientit të tyre dhe të ndërmarrin masat e duhura për verifikimin e identitetit të pronarit të vërtetë në bazë të të dhënave dhe informacioneve nga burime të besueshme dhe të pavarura, me të cilat sigurohen dhe e dijnë se kush është pronari i vërtetë i klientit konform vlerësimit të kryer të rrezikut.

(2) Të dhënat për pronarin e vërtetë subjektet i sigurojnë nga dokumentacioni origjinal ose dokumentacioni i vërtetuar nga regjistri tregtar, gjyqësor ose nga një regjistër tjetër publik, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se gjashtë muaj.

(3) Subjektet janë të detyruara që të dhënat për pronarin e vërtetë, krahas masave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, t'i kontrollojnë nga regjistri i pronarëve të vërtetë, me çka nuk guxojnë të mbështeten ekskluzivisht vetëm në të dhënat nga regjistri.

(4) Në rast se administruesi i trustit, gjegjësisht personi që kryen funksione të ngjashme në aranzhmanin juridik, vepron në emër dhe për llogari të trustit ose aranzhmanit juridik, me rastin e vendosjes së marrëdhënies afariste ose gjatë kryerjes së një transaksioni, subjekti është i detyruar të sigurojë informacione së bashku me dokumente që do të verifikojnë se personi vepron në atë cilësi si dhe të sigurojë të dhëna për identitetin e personave të përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji.

(5) Subjektet janë të detyruara të mbajnë kopje në formë të shkruar dhe/ose në formë elektronike të dokumenteve dhe informacioneve nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, me ç'rast zbatojnë masa teknike dhe organizative në pajtim me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

(6) Nëse subjektet nuk mund t'i sigurojnë të gjitha të dhënat për pronarin e vërtetë të klientit nga regjistri tregtar, gjyqësor ose regjistër tjetër publik ose nga regjistri i pronarëve të vërtetë, të dhënat e nevojshme duhet t'i sigurojnë, duke kontrolluar dokumentet origjinale ose dokumentet e noterizuara dhe evidencat afariste të parashtruara nga përfaqësuesi ligjor i klientit ose një person i autorizuar prej tij.

(7) Nëse klienti nuk i nënshtrohet regjistrimit në një regjistër përkatës dhe subjektet nuk mund të sigurojnë të dhënat e nevojshme për pronarin e vërtetë në mënyrën e përcaktuar në paragrafët (2), (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni, subjektet janë të detyruara që të dhënat t'i sigurojnë drejtpërdrejtë me deklaratë me shkrim nën përgjegjësinë e plotë morale dhe materiale të vërtetuar nga noteri e dhënë nga përfaqësuesi ligjor ose personi i autorizuar prej tij para se të lidhin marrëdhënie afariste ose para realizimit të transaksionit.

(8) Nëse pas verifikimit të pronarit të vërtetë, subjektet dyshojnë për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura ose për vërtetësinë e dokumenteve ose dokumentacionit tjetër afarist, janë të detyruar të kërkojnë deklaratë me shkrim nga përfaqësuesi ligjor, nën përgjegjësinë e plotë morale dhe materiale të vërtetuar nga noteri, ose nga personi i autorizuar prej tij para se të lidhin një marrëdhënie afariste ose para realizimit të transaksionit.

(9) Në rastet nga paragrafët (6), (7) dhe (8) të këtij neni, subjektet janë të detyruara të zbatojnë një ose më shumë masa për analizë të intensifikuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(10) Drejtori i Drejtorisë me udhëzim përcakton mënyrën e identifikimit të pronarit të vërtetë.

Pronari i vërtetë i personit juridik

Neni 20

(1) Pronari i vërtetë i personit juridik është:

1) Personi (persona) fizikë, i cili përfundimisht e posedon ose kontrollon personin juridik nëpërmjet pronësisë direkte dhe/ose indirekte të një përqindjeje të mjaftueshme të aksioneve, përkatësisht aksioneve ose të drejtave të votës, si dhe nëpërmjet interesave të tjera pronësore në atë person juridik, duke përfshirë edhe aksionet e bartësve, ose një formë tjetër kontrolli.

2) Personi (personat) fizik, i cili ka pozitë të lartë drejtuese në personin juridik, gjegjësisht i cili me ligj dhe akte të brendshme është i autorizuar të drejtojë dhe është përgjegjës për funksionimin e personit juridik.

(2) Treguesi i pronësisë së drejtpërdrejtë nga paragrafi (1) pika 1) e këtij neni është pronësia mbi 25% e aksioneve, e drejta e votës ose të drejta të tjera në personin juridik ose pronësia e 25% plus një aksion.

(3) Treguesi i pronësisë indirekte nga paragrafi (1) pika 1) e këtij neni është pronësia ose kontrolli i personit (personave) fizik mbi një ose më shumë persona juridik që individualisht ose së bashku kanë mbi 25% të aksioneve ose 25% plus një aksion.

(4) Nëse me zbatimin e paragrafit (1) pika 1) e këtij neni nuk është e mundur të përcaktohet personi fizik si pronar i vërtetë ose nëse subjekti nuk është i sigurt se personi/at fizik që janë identifikuar në pajtim me paragrafin (1) pika 1) e këtij neni është/janë pronar/ët e vërtetë, në atë rast pronar/ët i/e vërtetë konsiderohet personi/at i/e identifikuar me zbatimin e paragrafit (1) pika (2) të këtij neni.

(5) Në rastet e cekura nga paragrafi (4) i këtij neni, subjekti është i detyruar t'i ruajë të dhënat, përkatësisht evidencën për të gjitha masat dhe aktivitetet e ndërmarra në procesin e identifikimit të pronarit të vërtetë.

Pronari i vërtetë i subjekteve tjera juridike

Neni 21

Pronari i vërtetë i shoqatave vendase dhe të huaja si dhe lidhjeve, institucioneve, odave, sindikatave, partive politike, kooperativave, bashkësive fetare, bashkësive të pronarëve ose organizatave tjera në të cilat pjesëmarrja në menaxhim në bazë të pjesës pronësore në kapital nuk është e mundur të përcaktohet, konsiderohet çdo person fizik i autorizuar për të përfaqësuar ose personi fizik që ka pozicion kontrollues në menaxhimin me pronën e organizatës.

Pronar i vërtetë i trustit ose aranzhmanit tjetër ligjor

Neni 22

(1) Pronari i vërtetë i trustit është çdo person fizik i cili është:

1. themelues (settlor);
2. i besuar (trustee);

3. i mbrojtur (protector) - (në qoftë se ka);
 4. shfrytëzues ose grup i shfrytëzuesve (beneficiaries) me kusht që shfrytëzuesit e ardhshëm të jenë të verifikuar ose të mund të verifikohen;
 5. person tjetër fizik i cili nëpërmjet pronësisë direkte ose indirekte ose në një mënyrë tjetër ushtron kontroll mbi trustin.
- (2) Pronar i vërtetë i aranzhmanit ligjor është/janë person/a i/të cili/ët kryen/kryejnë funksion/e të njëjtë/a ose të ngjashme si në paragrafin (1) të këtij neni.
- (3) Pronar i vërtetë i fondacionit është/janë personi/at i/të cili/ët kryen/kryejnë funksion/e të njëjtë/a ose të ngjashme si në paragrafin (1) të këtij neni.

Pronar i vërtetë i tregtarit individual ose ushtrues të pavarur të veprimtarisë

Neni 23

Pronari i vërtetë i tregtarit individual ose ushtruesit të pavarur të veprimtarisë është personi fizik i regjistruar për ushtrim të veprimtarisë dhe njëkohësisht është përfaqësuesi i vetëm i autorizuar.

Pronar i vërtetë i shfrytëzuesve buxhetor

Neni 24

Pronari i vërtetë i shfrytëzuesit buxhetor është udhëheqësi i shfrytëzuesit buxhetor.

Pronar i vërtetë i personit juridik në pronësi shtetërore

Neni 25

Pronar i vërtetë i personit juridik në pronësi shtetërore është personi i cili menaxhon ose udhëheq me organin drejtues të personit juridik në pronësi shtetërore.

Pronar i vërtetë i personit juridik i cili është në procedurë të falimentimit ose likuidimit

Neni 26

Pronari i vërtetë i personit juridik që është në procedurë të falimentimit ose likuidimit është administrues i falimentimit, gjegjësisht likuiduesi deri në përfundimin e procedurës për falimentim, gjegjësisht likuidim.

Përgjashtime në lidhje me identifikimin e pronarit të vërtetë

Neni 27

Subjekti nuk është i detyruar ta identifikojë dhe vërtetojë identitetin e pronarit të vërtetë në qoftë se klienti, është person juridik letrat me vlerë të të cilit listohen në bursën vendore ose të huaj të letrave me vlerë nga shtetet që i plotësojnë standardet ndërkombëtare për parandalim të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit ku të dhënat për pronarët e vërtetë janë transparente dhe me qasje publike.

Obligimi për sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave për pronarin e vërtetë

Neni 28

(1) Obligim për sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe dokumenteve për pronarin e vërtetë kanë subjektet e regjistruar në regjistrat e Regjistratit qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe truste dhe aranzhmane tjera juridike të themeluara në pajtim me ligjet e shtetit të huaj (në tekstin e mëtejme: subjekte juridike) edhe atë:

1. Shoqata tregtare, tregtar individual, ushtrues të pavarur të veprimtarisë, degë dhe filiale të shoqatave tregtare të huaja dhe tregtarë individual të huaj;

2. Shoqata, lidhje, fondacione, oda, sindikata, parti politike, kooperativa , bashkësi fetare, bashkësi të pronarëve, përfaqësi të shoqatave të huaja tregtare ose organizata tjera;

3. noterë, avokatë dhe persona tjerë që kryejnë autorizime publike;

4. shfrytëzues buxhetor;

5. persona juridik në pronësi shtetërore;

6. persona juridik në procedurë të falimentimit ose likuidimit dhe

7. Truste dhe aranzhmane juridike në qoftë se:

a) i besuari ose personi që kryen aktivitete, të njëjta ose të ngjashme si ato nga neni 22 të këtij ligji dhe ka seli ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ose

b) i besuari ose personi që kryen aktivitete të njëjta ose të ngjashme si ato nga neni 22 të këtij ligji dhe nuk ka seli ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse në emër të trustit ose aranzhmanit juridik fiton pronë ose vendos marrëdhënie afariste me subjektet e përcaktuara me këtë ligj ose

c) janë pajisur me numër unik tatimor (NUT) në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligjin.

(2) Subjektet ligjore nga paragrafi (1) pikat 1), 2), 3) dhe 7) të këtij neni janë të detyruar të sigurojnë dhe ruajnë të dhëna dhe dokumente adekuate, të sakta dhe të përditësuara lidhur me:

1) pronarin/ët e vërtetë edhe atë:

a). emri dhe mbiemri;

b). adresa e vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimin;

c). dita, muaji dhe viti i lindjes;

ç). numri i vetëm i amzës ose numër tjetër identifikimi dhe të dhëna për llojin, numrin, lëshuesin, shtetin dhe datën e lëshimit të dokumentit të identifikimit;

d). nënshtetësia dhe

dh). të dhëna për llojin dhe vëllimin e pronës së vërtetë.

2) forma ligjore dhe struktura pronësore, kurse për shoqatat tregtare edhe të dhëna për aksionet, depozitat ose formë tjetër e pjesëmarrjes në pronësinë e shoqatës.

(3) Subjektet juridike nga paragrafi (1) pikat 4), 5) dhe 6) të këtij neni janë të detyruar të posedojnë dhe ruajnë të dhëna adekuate, të sakta dhe të përditësuara nga paragrafi (2) pika 1) e këtij neni.

(4) Personat të cilët janë pronarë të vërtetë janë të detyruar t'i dorëzojnë të gjitha të dhënat dhe dokumentet nga paragrafi (2) i këtij neni te personat juridik dhe te i besuari/përfaqësuesi ligjor ose te personi që kryen aktivitete të ngjashme në aranzhmanin juridik.

(5) Subjektet juridike nga paragrafi (1) janë të detyruar të sigurojnë informacione dhe dokumente për pronarin e tyre dhe pronarin e vërtetë të subjekteve nga neni 5 të këtij ligji me qëllim të zbatimit të analizës lidhur me klientin në pajtim me këtë ligj.

6) Subjektet juridike nga paragrafi (1) janë të detyruar të ruajnë të dhënat lidhur me pronarin e vërtetë nga ky nen në afat prej dhjet vitesh nga dita e themelimit të personit juridik gjegjësisht nga dita e ndryshimit të pronarit të vërtetë të personit juridik.

Regjistri i pronarëve të vërtetë

Neni 29

(1) Për shkak të sigurimit të transparencës së strukturës pronësore të subjekteve juridike vendoset regjistër i pronarëve të vërtetë, i cili përmban informacione dhe të dhëna për pronarët e vërtetë në pajtim me këtë ligj (në tekstin e mëtejshëm: regjistër).

(2) Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: administrues i regjistrit) e vë në funksion, drejton, mirëmban dhe menaxhon me regjistrin në formë elektronike.

Parashtrues

Neni 30

(1) Personi i autorizuar për përfaqësim dhe prezantim të subjektit juridik nga neni 28, paragrafi (1) të këtij ligji është i detyruar t'i fusë të dhënat në regjistër.

(2) Subjektet juridike nëpërmjet sistemit të administruesit të regjistrit mund të autorizojnë person tjetër në emrin e tyre të fusë të dhënat për pronarët e tyre të vërtetë, si dhe të dhënat për ndryshimet e pronarëve të vërtetë në regjistër.

(3) Subjektet juridike nga neni 28 paragrafi (1) të këtij ligji janë përgjegjës për saktësinë, përshtatshmërinë dhe përditësimin e të dhënave në regjistër.

(4) Agjenti i regjistrimit ose administratori i regjistrit në procedurën e regjistrimit është i detyruar ta njoftojë subjektin juridik për obligimin për regjistrim të detyrueshëm të të dhënave për pronarin e vërtetë.

Futja e të dhënave në regjistër

Neni 31

(1) Shoqëritë tregtare, degët dhe filialet e shoqërive tregtare të huaja dhe tregtari individual i huaj, lidhjet, institucionet, odat, sindikatat, partitë politike, kooperativat, bashkësitë fetare, bashkësitë e pronarëve, përfaqësitë e shoqatave tregtare të huaja ose organizata tjera i fusin të dhënat për pronarët e tyre të vërtetë në regjistër në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga regjistrimi i subjektit afarist në regjistrin tregtar dhe në regjistrin e personave tjerë juridik në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga ndryshimi i të dhënave për pronarin e vërtetë.

(2) Trustet dhe aranzhmanet juridike i fusin të dhënat për pronarin/pronarët e tij/tyre të vërtetë në regjistër në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita kur i besuari/përfaqësuesi ligjor ose personi që kryen aktivitete të njëjta ose të ngjashme si ato të cekura në nenin 22 të këtij ligji, ka fituar seli ose vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht në emër të trustit ose aranzhmanit juridik ka fituar pronë gjegjësisht ka vendosur marrëdhënie afariste me subjektet sipas këtij ligji ose nga dita kur ka marrë numër e vetëm tatimor (NUT) në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligjin.

(3) Në regjistër shënohen të dhënat vijuese:

1) të dhëna për subjektin juridik me përjashtim të aranzhmaneve juridike: emri, selia, numri unik i identifikimit të subjektit dhe numri tatimor, data e themelimit dhe fshirjes së subjektit afarist të cilat me detyrë zyrtare edhe automatikisht merren dhe evidentohen nga regjistri tregtar dhe regjistri për persona tjerë juridik;

2) të dhëna për aranzhmanin juridik: emri, data dhe vendi i themelimit, numri tatimor ose numër tjetër për identifikim dhe shteti me të drejtën juridike të të cilit është themeluar;

3) të dhëna për pronarin e vërtetë: emri dhe mbiemri (emri personal), numri unik amë ose numër tjetër për identifikim, adresa e vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimin, data e lindjes dhe nënshtetësia, të cilat me detyrë zyrtare dhe me shfrytëzim të mjeteve elektronike merren nga Regjistri qendror i popullsisë, me futjen e numrit unik amë të qytetarit, për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut që jetojnë në vend ose jashtë vendit, si dhe për të huaj me qëndrim të rregulluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më gjatë se një vit ose futen nga parashtruesi për të huaj me shkrim latin, siç është e shkruar në dokumentin e vlefshëm të identifikimit;

4) të dhëna për pronësinë e pronarit të vërtetë dhe

5) të dhëna për ditën prej kur personi/personat ka/kanë fituar cilësinë e pronarit të vërtetë në pajtim me këtë ligj.

(4) Shtetas të huaj me qëndrim të rregulluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më gjatë se një vit, krahas të dhënave nga paragrafi (3) pika 3) e këtij neni, fusin edhe të dhëna për numër të huaj për identifikim, adresë të huaj (adresa e vendqëndrimit të përhershëm - vendbanimi) dhe shteti i vendqëndrimit të përhershëm në pajtim me dokumentin e vlefshëm të identifikimit.

(5) Administruesi i regjistrit e menaxhon dhe drejton regjistrin në mënyrë që:

- krahas statusit të fundit të të dhënave për pronarë të vërtetë, gjithashtu, ruhen të gjitha regjistrimet paraprake, ndryshimet e të dhënave dhe fshirjet sipas kohës dhe llojit të ngjarjes dhe
- të dhënat në regjistër janë të qasshme dhjetë vite pas fshirjes së subjektit juridik nga regjistri kompetent.

(6) Futja e të dhënave bëhet në mënyrë elektronike, përmes internet portalit të administruesit të regjistrit, pa pagesë në afatet e parapara ligjore, me përdorim të masave teknike dhe organizative në pajtim me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

(7) Në rast se parashtruesi i kërkesës për regjistrim në regjistrin e pronarëve të vërtetë ka dorëzuar kërkesë e cila përmban gabime të dukshme teknike, i njëjti mund ta korrigjojë në afat prej tri ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës.

(8) Në rast të pamundësisë për qasje në sistemin e Regjistrit qendror të popullsisë, si dhe në raste kur numri konkret unik amë nuk është i evidentuar në kuadër të të njëjtit, të dhënat për: emrin personal (emër dhe mbiemër), numri unik amë ose numër tjetër identifikimi, adresa e vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimit, data e lindjes, nënshtetësia për shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët jetojnë në vend ose jashtë vendit, si dhe shtetas të huaj me qëndrim të rregulluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më gjatë se një vit, futen me dorë nga parashtruesi i kërkesës;

(9) Ministri i financave e përcakton mënyrën e futjes, parashtrimit, korrigjimit dhe fshirjes së të dhënave nga regjistri, mënyrën e përcaktimit të lartësisë së pjesëmarrjes (tregues për vërtetimin e pronësisë), mënyrën e kërkimit dhe përdorimit, mënyrën e mirëmbajtjes dhe administrimit dhe kërkesat(nevojat) teknike për vënien në funksion të regjistrit.

Neni 32

(1) Në raste kur subjekti përmes kontrollit të drejtpërdrejtë në sistemin elektronik të Regjistrit do të përcaktojë se të dhënat dhe informacionet për pronarin e vërtetë të subjektit juridik nga neni 28 të këtij ligji nuk është/janë futur ose përditësuar në regjistrin e pronarëve të vërtetë në pajtim me këtë ligj, subjekti është i obliguar të shtyjë vendosjen e marrëdhënies afariste, të shtyjë transaksionit në kuadër të marrëdhënies afariste të vendosur ose të shtyjë realizimin e transaksionit deri sa të dhënat dhe informatat të futen në regjistër.

(2) Në rastet e paragrafit (1) të këtij neni dhe në rast se subjekti përcakton mospajtim në mes informacioneve për pronarin/pronarët e vërtetë të regjistruar gjegjësisht të përditësuar në regjistër dhe informacionet për pronarin e vërtetë në të cilat kanë qasje në bazë të analizës së zbatuar lidhur me klientin në pajtim me këtë ligj, subjekti është i detyruar që menjëherë të lajmërojë Drejtorinë në mënyrë elektronike. Në qoftë se mënyra e këtillë e dorëzimit është e pamundësuar për shkaqe teknike, subjektet e lajmërojnë Drejtorinë në formë të shkruar.

(3) Drejtori i Drejtorisë me udhëzim e përcakton mënyrën e dorëzimit të informacioneve nga paragrafi (2) i këtij neni.

Qasje në të dhënat për pronarët e vërtetë

Neni 33

(1) Qasje në të dhënat që regjistrohen në regjistër drejtpërdrejt dhe përmes qasjes elektronike kanë:

- 1) Drejtoria;
- 2) Gjykatat;
- 3) Organet në pajtim me nenin 130, paragrafin (1) dhe nenin 151, paragrafin (1) të këtij ligji;
- 4) Subjektet nga neni 5 të këtij ligji;
- 5) personat tjerë juridikë ose fizikë.

(2) Organet kompetente në paragrafin (1) pikat 1), 2) dhe 3) nga ky nen mund t'i sigurojnë në kohë të gjitha të dhënat e regjistrimit dhe pa kompensim, në pajtim me ligjin për Regjistër qendror si dhe t'i përcjellin deri te organet kompetente dhe njësitë për inteligjencë financiare të shteteve tjera në pajtim me kompetencat e përcaktuara me ligj.

(3) Subjektet nga paragrafi (1) pika 4) e këtij neni kanë qasje në çdo kohë në të gjitha të dhënat e regjistrimit në pajtim me ligjin për Regjistrin qendror dhe t'i shfrytëzojnë për zbatimin e kompetencave në pajtim me këtë ligj.

(4) Të dhënat nga regjistri për emrin dhe mbiemrin, muajin dhe vitin e lindjes, nënshtetësinë, vendin e qëndrimit, përqindja e pronësisë ose formë dhe lloj tjetër i pronësisë ose kontrollit, në formë të informacionit, dhe në pajtim me Tarifën e administruesit të regjistrimit janë publike dhe në to kanë qasje personat juridik dhe fizik nga paragrafi (1) pika 5) e këtij neni.

Lëshimi i të dhënave lidhur me pronarët e vërtetë

Neni 34

(1) Informacionet për pronarin e vërtetë për subjektet të cilët i nënshtrohen regjistrimit në regjistër në pajtim me këtë ligj jepen në pajtim me të dhënat e fundit të regjistruara në Regjistrin qendror të popullsisë dhe regjistrin për pronarë të vërtetë në ditën e lëshimit të së njëjtës. Në rast të mosfunksionimit të sistemit të Regjistrimit qendror të popullsisë në momentin e dhënies të informacionit, të dhënat për pronarin e vërtetë për subjektet të cilët i nënshtrohen regjistrimit në regjistër në pajtim me këtë ligj, jepen në pajtim me të dhënat e fundit të regjistruara në regjistrin e pronarëve të vërtetë.

(2) Informacioni lidhur me pronarin e vërtetë të tregtarit individual, ushtruesit e pavarur të veprimtarisë dhe personat që ushtrojnë autorizime publike, si dhe shfrytëzuesit buxhetor, personat juridik në pronësi të plotë shtetërore edhe personat juridik në procedurë të falimentimit dhe likuidimit jepet në pajtim me të dhënat e fundit të regjistruara në regjistrin tregtar dhe regjistrin e personave tjerë juridik dhe regjistrin e shfrytëzuesve buxhetor në kompetencë të Ministrisë së financave.

Kontrollimi i të dhënave në regjistër

Neni 35

(1) Administruesi i regjistrimit bën kontrollimin e të dhënave në regjistër dhe vërteton nëse subjektet juridike nga neni 28 paragrafi (1) të këtij ligji i kanë regjistruar të dhënat nga neni 31 të këtij ligji, ndryshimin e të dhënave në afatin dhe mënyrën e përcaktuar me dispozitën e nenit 31 të këtij ligji.

(2) Administruesi i regjistrimit, menjëherë e informon Drejtorinë në mënyrë elektronike për subjektet juridike nga neni 28 paragrafi (1) të këtij ligji të cilët nuk i kanë regjistruar të dhënat nga neni 31 të këtij ligji dhe nuk e kanë regjistruar ndryshimin e atyre të dhënave në mënyrën dhe afatin e përcaktuar në dispozitën e nenit 31 të këtij ligji.

Përpunimi i të dhënave në regjistër

Neni 36

(1) Drejtoria në vazhdimësi bën përpunimin e të dhënave të regjistruara nga neni 31 në regjistër nga ana e subjekteve juridike nga neni 28 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Për qëllimet e përpunimit të të dhënave nga paragrafi(1) i këtij neni, Drejtoria përdor edhe zgjidhje softuerike, të cilat duhet t'i plotësojnë dispozitat ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

(3) Informacionet nga përpunimi i të dhënave për strukturën pronësore, nëpërmjet regjistrimit për pronarët e vërtetë janë të qasshme për subjektet e këtij ligji për t'i shfrytëzuar për qëllimet e zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit.

Përcjellja e vazhdueshme e marrëdhënies afariste

Neni 37

(1) Subjekti është i detyruar t'i përcjellë aktivitetet afariste me vëmendje dhe transaksionet që kryhen në kuadër të marrëdhënies afariste me klientin, me qëllim që të vërtetohet se të njëjtat janë në pajtim me qëllimin dhe synimin e marrëdhënies afariste, profilin e rrezikut të klientit, gjendjen e tij financiare dhe burimet e tij të financimit.

(2) Subjekti është i detyruar të bëjë kontroll dhe përditësim të rregullt të dokumenteve dhe të të dhënave për klientët, pronarët e vërtetë dhe profilin e rrezikut të klientëve me të cilët ka vendosur marrëdhënie afariste.

(3) Subjekti është i detyruar të sigurojë se vëllimi dhe shpeshtësia e zbatimit të masave nga paragrafi (2) i këtij neni janë në pajtim me analizën dhe vlerësimin e rrezikut nga neni 11 të këtij ligji dhe se të njëjtat janë të harmonizuara me rrezikun nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit ndaj të cilëve subjekti është i ekspozuar gjatë realizimit të aktivitetit ose transaksionit të caktuar afarist, gjegjësisht në kuadër të marrëdhënies afariste me klientin.

Analizë e thjeshtësuar e klientit

Neni 38

(1) Subjektet mund të zbatojnë masa të thjeshtësuara për analizë të klientit, kur në pajtim me dispozitat e nenit 11 të këtij ligji kanë përcaktuar se ekziston rrezik i ulët për pastrim të parave dhe/ose financim të terrorizmit.

(2) Gjatë vendimit për zbatim të masave të thjeshtësuara për analizë të klientit, subjektet janë të detyruar të kenë parasysh edhe rezultatet nga vlerësimi kombëtar i rrezikut.

(3) Masat për analizë të thjeshtësuar të klientit mund të jenë:

- vërtetimi i identitetit të klientit ose pronarit të vërtetë pas vendosjes së marrëdhënies afariste,
- zvogëlimi i shpeshtësisë së përditësimit të dokumenteve dhe të dhënave për klientët dhe/ose
- zvogëlimi i shkallës së ndjekjes së marrëdhënies afariste dhe transaksioneve të klientit.

(4) Subjektet janë të obliguar të sigurojnë dokumentacion përkatës në bazë të të cilit do të mund të vërtetohet se është e lejueshme zbatimi i analizës së thjeshtësuar të klientit dhe se masat e analizës së thjeshtësuar të klientit janë përkatëse me rrezikun e përcaktuar, si dhe ta bëjnë të disponueshëm atë dokumentacion për organet e mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji.

(5) Analiza e thjeshtësuar e klientit nuk është e lejuar atëherë kur në rastet që kanë të bëjnë me klientin, transaksionin, marrëdhënien afariste ose pronën ekziston dyshim për pastrim të parave ose financim të terrorizmit, kur zbatohen skenarë specifikë të rrezikut të lartë nga pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit ose në rastet e transaksioneve të ndërlikuara dhe jo të zakonshme.

Analizë e përforcuar e klientit

Neni 39

(1) Në rastet kur ekziston rrezik i lartë dhe mesatarisht i lartë nga pastrimi i parave ose financimi i terrorizmit, i përcaktuar sipas nenit 11 të këtij ligji ose në bazë të vlerësimit kombëtar të rrezikut nga ky ligj ose në rast dyshimi për pastrim të parave dhe/ose financim të terrorizmit, përveç rasteve të përcaktuara me nenet 40, 41, 42, 43, 44 dhe 45 të këtij ligji, subjekti është i detyruar ti ndërmerrë të gjitha masat e përforcuara ndaj klientit për menaxhim përkatës me rrezikun, edhe atë:

- sigurimi i të dhënave shtesë për klientin dhe pronarin/pronarët e vërtetë;
- përditësim i shpeshtuar i dokumenteve dhe të dhënave lidhur me klientin;
- sigurim i të dhënave shtesë për natyrën e marrëdhënieve afariste dhe transaksionet e klientit;
- sigurimi i të dhënave shtesë për burimin e mjeteve dhe burimin e pasurisë së klientit;
- sigurim i informacioneve për arsyen e transaksioneve të planifikuara ose të realizuara;
- sigurim i miratimit nga udhëheqësia e lartë për vendosjen e marrëdhënieve të reja afariste ose vazhdimin e tyre dhe
- ndjekje të përforcuar të marrëdhënieve afariste.

(2) Zbatimin e masave të analizës së përforcuar nga paragrafi (1) i këtij neni subjekti është i detyruar t'a dokumentojë dhe t'a bëjë të disponueshëm atë dokumentacion për organet e mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji.

Marrëdhënie korresponduese

Neni 40

(1) Kur krijohen marrëdhënie korresponduese tej kufitare, institucioni financiar është i obliguar t'i ndërmarrë masat vijuese të analizës së përforcuar:

a) të grumbulloj të dhëna të mjaftueshme për institucionin financiar korrespondues që plotësisht të përcaktojë veprimtarinë e tij dhe nga informacionet publikisht të disponueshme të vlerësojë reputacionin, si dhe cilësinë e mbikëqyrjes, përfshi këtu nëse ka qenë lëndë e hetimit për pastrim të parave ose financim të terrorizmit ose masë tjetër të mbikëqyrjes;

b) të vlerësojë procedurat dhe mekanizmat kontrollues për parandalim të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit të institucionit financiar korrespondues;

c) të sigurojë miratim nga udhëheqësia e lartë para vendosjes së marrëdhënies së re korresponduese;

ç) të përcaktojnë dhe në mënyrë të përpiktë të përshkruajnë përgjegjësitë e ndërsjella që dalin nga marrëdhënia korresponduese dhe

d) të përcaktoj nëse institucioni financiar korrespondues bën analizë të klientit nga ky ligj për persona të cilët kanë qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë e saja korresponduese te institucionet financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, së paku në vëllim dhe mënyrë të përcaktuar me këtë ligj, si dhe të konstatojnë nëse institucioni financiar korrespondues është i gatshëm t'i sigurojë të dhënat për identifikim dhe vërtetim të identitetit të klientit të bankës së huaj ose institucionit tjetër financiar dhe pronarin e saj të vërtetë dhe t'i dorëzojë në bankë ose institucion tjetër financiar me kërkesë të tij.

2) Masat nga paragrafi (1) i këtij neni kanë të bëjnë edhe me situatat kur institucionet financiare vendosin marrëdhënie korresponduese me ofrues të shërbimeve me asete virtuale si dhe në situatat kur ofruesit e shërbimeve me asete virtuale vendosin marrëdhënie të ndërsjella korresponduese.

Klienti i cili nuk është fizikisht i pranishëm

Neni 41

Kur klienti si dhe personi i cili vepron në emër dhe për llogari të klientit nuk është fizikisht i pranishëm për qëllime të identifikimit dhe në rast se identiteti i tyre nuk mund të përcaktohet me përdorim të mjeteve për identifikim elektronik të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikim elektronik të nivelit të lartë të sigurisë në pajtim me ligjin, subjekti duhet të ndërmarrë njërën ose më shumë nga masat vijuese për analizë të përforcuar:

- a) identitetin e klientit ta përcaktojë me dokumente, të dhëna ose informacione shtesë;
- b) të ndërmarrë masa shtesë me të cilat i vërteton dokumentet e siguruar ose të kërkojë që dokumentet t'i vërtetojë institucioni financiar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, nga ndonjë shtet anëtar i Bashkimit Europian ose nga një shtet në të cilin dispozitat parashikojnë kritere dhe standarde përafërsisht të njëjta për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si kërkesat e parapara me këtë ligj dhe
- c) pagesa e parë të kryhet nëpërmjet llogarisë në emër të klientit e hapur në institucion financiar në shtetin i cili i përmbush standardet ndërkombëtare për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe i cili zbaton së paku masa të njëjta të analizës së klientit të përcaktuara si në këtë ligj.

Klient – bartës i funksionit publik

Neni 42

(1) Kur subjekti realizon transaksione ose vendos marrëdhënie afariste me klient – bartës të funksionit publik, subjekti është i detyruar krahas masave të përcaktuara me nenin 15 të këtij ligji të ndërmarrë masat vijuese të analizës së përforcuar:

- (a) të aplikojë sisteme për menaxhim me rrezikun për të përcaktuar nëse klienti ose pronari i vërtetë është bartës i funksionit publik, përfshirë edhe sigurimin e deklaratës së tij/saj;
- (b) të sigurojë miratim nga udhëheqësia e lartë para se të vendos marrëdhënie afariste me klientin – bartës i funksionit publik dhe/ose pronarin e vërtetë, si dhe të sigurojë pëlqim për vazhdimin e marrëdhënies afariste me klient ekzistues – bartës i funksionit publik dhe/ose pronarin e vërtetë i cili në ndërkohë është bërë bartës i funksionit publik;
- (c) të ndërmarrë masa përkatëse për verifikimin e burimit të pasurisë dhe burimin e mjeteve të klientit dhe pronarit/pronarëve të vërtetë të identifikuar si bartës të funksionit publik dhe
- (ç) të kryejë ndjekje të vazhdueshme të përforcuar të marrëdhënies afariste.

(2) Subjekti është i detyruar të ndërmarrë masa me të cilat do të përcaktojë nëse shfrytëzuesi dhe/ose pronari i vërtetë i shfrytëzuesit të sigurimit të jetës dhe sigurimeve tjera të ndërlidhura me investim është bartës i funksionit publik.

(3) Në rastet e paragrafit (2) të këtij neni, subjekti është i obliguar ta njoftojë udhëheqësinë e lartë para se të kryhet pagesa e premisë së policës së sigurimit dhe hollësisht ta shqyrtojë dhe ta përcaktojë marrëdhënien e plotë afariste me klientin.

(4) Organizatat ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Maqedonisë së Veriut në faqet e tyre zyrtare të internetit publikojnë të dhëna për drejtorë, zëvendës drejtorë, anëtarë të bordeve dhe funksione tjera të barasvlershme në organizatën ndërkombëtare.

(5) Drejtoria menaxhon listë të përditësuar të funksioneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilat konsiderohen funksione publike në pajtim me këtë ligj dhe të njëjtën e publikon në faqen e saj të internetit.

Vende me rrezik të lartë

Neni 43

(1) Kur marrëdhënia afariste ose transaksioni përfshin ndonjë shtet me rrezik të lartë, subjekti është i detyruar të ndërmarë masat vijuese gjatë vendosjes së marrëdhënies afariste ose realizimit të transaksionit:

- 1) sigurimi i të dhënave shtesë lidhur me klientin dhe pronarin/pronarët e vërtetë;
- 2) sigurimi i të dhënave shtesë për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies afariste;
- 3) sigurimi i të dhënave shtesë për burimin e mjeteve dhe burimin e pasurisë së klientit dhe pronarit/pronarëve të vërtetë;
- 4) sigurimi i të dhënave për arsyen e transaksionit të planifikuar ose të realizuar;
- 5) sigurimin e miratimit nga udhëheqësia e lartë për vendosjen e marrëdhënies të reja afariste ose vazhdim të marrëdhënies ekzistuese afariste dhe
- 6) ndjekje intensive të marrëdhënies afariste me kontrolle të shtuara dhe të shpeshta, si dhe me analizë të mëtejme të transaksioneve të caktuara.

(2) Kur marrëdhënia afariste ose transaksioni përfshijnë vend me rrezik të lartë, subjekti është i detyruar aty ku është e zbatueshme, të kërkojë që pagesa e parë të kryhet përmes llogarisë në emër të klientit e hapur në institucionin financiar në ndonjë shtet i cili i plotëson standardet ndërkombëtare për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe që zbaton së paku masa të njëjta të analizës së klientit të përcaktuara si në këtë ligj.

(3) Krahas masave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, subjekti është i detyruar të ndërmerrë njërën ose më shumë masa për ulje të rrezikut edhe atë:

- 1) të ndërmerrë masa shtesë të analizës së përfortuar;
- 2) të krijojë mekanizma shtesë për njoftim për transaksionet e klientit ose
- 3) të kufizojë vendosjen e marrëdhënies afariste ose realizimin e transaksioneve me persona fizik ose juridik nga vendet me rrezik të lartë.

(4) Drejtoria rregullisht, e të paktën dy herë në vit, publikon listë të vendeve me rrezik të lartë për shkak të zbatimit të masave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni në faqen e saj zyrtare të internetit në bazë të njoftimeve publike për vende të identifikuar me rrezik të lartë të shpallura nga FATF, vendimet e sjellura në nivel të Unionit Europian për vendet e identifikuar me rrezik të lartë me mangësi strategjike dhe vende me rrezik të lartë të identifikuar në bazë të vlerësimit kombëtar të rrezikut.

(5) Me propozim të Këshillit për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Qeveria sjell vendim për vendosjen e masave ndaj vendeve me rrezik të lartë edhe atë:

- ndalim për themelim të degës, filialit ose përfaqësisë së subjekteve nga vendet me rrezik të lartë;
- ndalim për themelim të degës, filialit ose përfaqësisë së subjekteve në vendet me rrezik të lartë;
- rritje të kontrolleve mbikëqyrëse ose rritje të kërkesave për auditime të pavarura të degës, filialit ose përfaqësisë së subjekteve nga vendet me rrezik të lartë;
- rritje të kërkesave për auditime të pavarura të grupeve financiare të degëve ose filialeve në vendet me rrezik të lartë;
- kërkesë nga institucionet financiare të kontrollojnë dhe plotësojnë ose, në rast se është e nevojshme, të ndërpresin marrëdhënien korresponduese me institucionin financiar korrespondues në vendet me rrezik të lartë;

6) Propozimin nga paragrafi (5) të këtij neni Këshilli e përgatit me kërkesë të FATF ose në bazë të raporteve të vlerësimeve ose raporteve tjera nga organizatat ndërkombëtare që janë të përfshirë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Organizatat jofitimprurëse

Neni 44

Subjektet janë të detyruara të ndërmarrin masa të analizës së përforcuar në lidhje me marrëdhëniet afariste dhe transaksionet me organizatat jo fitimprurëse të cilat paraqesin rrezik më të lartë të identifikuar sipas vlerësimit kombëtar të rrezikut si dhe organizatat jofitimprurëse të cilat paraqesin rrezik më të lartë në pajtim me vlerësimin e rrezikut nga ana e subjektit dhe të cilat përfshijnë:

- 1) sigurimin e të dhënave shtesë për klientin dhe pronarët e vërtetë;
- 2) përditësimin e shpeshtë të dokumenteve dhe të dhënave për klientin;
- 3) sigurimin e të dhënave shtesë për natyrën e marrëdhënieve afariste dhe transaksioneve të klientit dhe qëllimet specifike të organizatave jofitimprurëse;
- 4) sigurimin e të dhënave shtesë për burimin e mjeteve dhe burimin e pronës së klientit dhe të dhëna shtesë për shfrytëzuesit të cilët i pranojnë mjetet e organizatës jofitimprurëse;
- 5) sigurimin e informacioneve për shkakun e transaksioneve të planifikuara ose të realizuara dhe
- 6) ndjekje e përforcuar e marrëdhënieve afariste.

Transaksione të ndërlikuara dhe jo të zakonshme

Neni 45

(1) Subjekti është i detyruar të shqyrtojë, aq sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, prapaskenën dhe qëllimin e të gjitha transaksioneve që përmbushin së paku një nga kriteret vijuese:

- 1) transaksioni është i ndërlikuar;
- 2) transaksioni është jashtëzakonisht i madh;
- 3) transaksioni realizohet në mënyrë jo të zakonshme;
- 4) transaksioni nuk ka arsyetim të qartë ekonomik ose qëllim ligjor dhe/ose
- 5) devijon nga puna afariste e zakonshme ose e pritshme e klientit.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, subjektet janë të detyruar të rrisin shkallën dhe natyrën e ndjekjes së marrëdhënies afariste me klientin, me qëllim që të vërtetojnë nëse ato transaksione ose aktivitete kanë elemente të dyshimta.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, subjekti është i detyruar të përgatisë analizë në formë të shkruar ose elektronike dhe të përcaktojë nevojën për dorëzimin e raportit deri te Drejtoria në pajtim me nenin 65 të këtij ligji.

(4) Në lidhje me transaksionet nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti është i detyruar analizën nga paragrafi (3) i këtij neni, ta ruajë dhe ta vë në dispozicion në kërkesë të organeve të mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji.

Refuzim i marrëdhënies afariste dhe transaksionit

Neni 46

(1) Kur nuk mund t'i zbatojë masat për analizë të klientit nga ky ligj, subjekti është i detyruar:

- 1) të refuzojë vendosjen e marrëdhënies afariste me klientin;
- 2) të ndërpresë marrëdhënien afariste me klientin;
- 3) të mos realizojë transaksion të rastit dhe/ose
- 4) të mos realizojë transaksion në kuadër të marrëdhënies së krijuar afariste, përderisa nuk zbatohen masat për analizë të klientit.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) nga ky nen, subjekti është i detyruar të njoftojë Drejtorinë në formë elektronike. Në rast se kjo mënyrë e dorëzimit është e pamundësuar për shkaqe teknike, subjektet njoftimin e dorëzojnë në formë të shkruar.

(3) Në rastet e paragrafit (1) të këtij neni, subjekti është i detyruar të përgatisë analizë në formë të shkruar dhe të përcaktojë nevojën për dorëzim të raportit deri te Drejtoria në pajtim me nenin 65 të këtij ligji.

(4) Subjekti është i detyruar analizën nga paragrafi (3) i këtij neni ta ruajë në afat prej dhjetë vitesh nga përgatitja e saj dhe ta vë në dispozicion në kërkesë të organeve të mbikëqyrjes nga neni 151 i këtij ligji.

Përfundim nga zbatimi i masave për analizë të klientit

Neni 47

(1) Në rastet kur subjekti ka dyshime për pastrim të parave ose financim të terrorizmit dhe është thellë i bindur se zbatimi i masave për analizë të klientit do të çojë në njoftimin e klientit për ndërmarrjen e të njëjtave, subjekti mund të mos e zbatojë procesin e plotë të analizës së klientit, por menjëherë të dorëzojë raport deri te Drejtoria në pajtim me nenin 65 të këtij ligji dhe të shpjegojë arsyet për të cilat ka vepruar në pajtim me këtë nen.

(2) Subjektet janë të detyruar t'i shpjegojnë në formë të shkruar, arsyet për të cilat kanë vepruar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni dhe të dhënat t'i vënë në dispozicion në kërkesë të organeve të mbikëqyrjes nga neni 151 i këtij ligji.

Zbatimi i masave dhe veprimeve për parandalim të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit nga ana e degëve dhe filialeve të subjektit

Neni 48

(1) Subjekti i cili ka degët ose filialet e tij në shtet tjetër duhet të sigurojë zbatim të masave për parandalim të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit në degët ose filialet.

(2) Në rast kur dispozitat juridike të shtetit në të cilin dega ose filiali nga paragrafi (1) i këtij neni ka seli, nuk lejojnë zbatim të masave nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti duhet menjëherë ta njoftojë organin përkatës të mbikëqyrjes nga neni 151 i këtij ligji.

Besimi i obligimeve për analizë të klientit palës së tretë

Neni 49

(1) Në rastet kur subjektet i zbatojnë masat e nenit 15 të këtij ligji, të njëjtat mundet, nën kushte të përcaktuara me këtë ligj, t'ia besojnë zbatimin e masave dhe veprimeve nga neni 15 paragrafi (1) pika a), b), c) dhe ç) të këtij ligji palëve të treta.

(2) Përgjegjësia për zbatimin e masave për analizë të klientit në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, mbetet mbi subjektin i cili i ka besuar detyrimet për zbatimin e masave dhe veprimeve nga neni 15 paragrafi (1) pikat a), b), c) dhe ç) nga ky ligj palëve të treta.

(3) Palë të treta nga paragrafi (1) i këtij neni janë subjektet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji, organizata-anëtare dhe federata të atyre subjekteve ose institucione tjera të themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, vend-anëtar i Unionit European ose vend tjetër në të cilin detyrimisht:

- zbatohen masat për analizë të klientit dhe ruajtja e të dhënave në pajtim dhe në mënyrë së paku identike me mënyrën e përcaktuar me këtë ligj dhe të cilat janë në pajtim me standardet ndërkombëtare;

- zbatimi i masave dhe veprimeve për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është objekt i mbikëqyrjes nga organi kompetent në pajtim me këtë ligj ose është në pajtim me standardet ndërkombëtare.

(4) Subjekti është i detyruar paraprakisht të kontrollojë nëse pala e tretë i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj, e në rast kur pala e tretë është subjekt nga një vend tjetër, i njëjti është i detyruar të marrë parasysh shkallën e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimit të terrorizmit të atij vendi.

(5) Subjekti nuk guxon t'ia besojë zbatimin e masave dhe veprimeve nga neni 15 paragrafi 1) pikat a), b), c) dhe ç) palës së tretë e cila e ka origjinën ose është e themeluar në ndonjë vend me rrezik të lartë në pajtim me këtë ligj ose bankës guackë.

(6) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti duhet menjëherë t'i pranojë nga pala e tretë:

a) informacionet e nevojshme për kryerjen e analizës së klientëve në pajtim me këtë ligj;

b) me kërkesë të tij, pa shtyrje, të pranojë të dhëna dhe informacione për analizën e kryer të klientit gjegjësisht kopje të dokumenteve për identifikim dhe vërtetim të identitetit, nëse është e mundur përfshirë informacione dhe të dhëna të siguruara me përdorim të mjeteve për identifikim elektronik të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikim elektronik në nivel të lartë të sigurisë në pajtim me ligjin ose mënyra tjera të besueshme elektronike për identifikim nga distanca të rregulluara, të miratuara dhe të pranuar nga organet kompetente të shteteve të huaja.

(7) Subjektet mund tu besojnë zbatimin e masave dhe veprimeve nga neni 15 paragrafi (1) pikat a), b), c) dhe ç) të këtij ligji palëve të treta, pjesë të grupit të njëjtë financiar, nëse grupi:

- i zbaton kërkesat për analizë të klientëve, ruajtjen e të dhënave dhe procedurave për parandalim të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit në pajtim me standardet ndërkombëtare;

- zbaton kërkesa për analizë të klientit dhe ruajtjen e të dhënave të cilat janë lëndë e mbikëqyrjes në nivel të grupit nga organi kompetent dhe

- në mënyrë përkatëse i menaxhon rreziqet që kanë të bëjnë me vende me rrezik të lartë.

(8) Dispozitat e këtij neni nuk përfshijnë palën e tretë në rastin kur e njëjta vepron si agjent për subjektin ose kur subjekti ka lidhur marrëveshje për shërbime me palën e tretë për qëllime të kryerjes së punëve të përcaktuara me këtë ligj për llogari të subjektit.

Sigurimi dhe përcjellja e informacioneve lidhur me transfertat e mjeteve monetare

Neni 50

(1) Institucionet financiare janë të detyruara gjatë depozitimit të shumës prej 1.000 euro ose valutë tjetër në kundërvlerë me 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e depozitimit, për shkak të transferimit të mjeteve monetare nëpërmjet qarkullimit pagesor ndërkombëtar, të sigurojnë të dhëna për:

a) paguesin – ku mund të përcaktohet dhe verifikohet identiteti i tij edhe atë:

- emri dhe mbiemri, gjegjësisht emërtimi i paguesit,

- numri i llogarisë, me çka nëse mungon ose nuk mund të përcaktohet, atëherë nevojitet të përcaktohet shenja e vetme identifikuese e transaksionit, e cila mundëson ndjekjen e tij dhe

- adresa ose numri i dokumentit kombëtar të identifikimit ose numër identifikues të klientit ose data dhe vendi i lindjes.

b) pranuesi – ku mund të përcaktohet identiteti i tij edhe atë:

- emri dhe mbiemri, gjegjësisht emërtimi i pranuesit dhe

- numri i llogarisë, ku në rast se mungon ose nuk mund të përcaktohet, atëherë nevojitet të përcaktohet shenja e vetme identifikuese e transaksionit, që mundëson ndjekjen e tij.

(2) Institucionet financiare janë të detyruara gjatë depozitimit të shumës prej 1.000 euro ose valutë tjetër në kundërvlerë me 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e depozitimit, për shkak të transferimit të mjeteve monetare nëpërmjet qarkullimit pagesor vendor, t'i sigurojnë të dhënat për paguesin

nga të cilat mund të përcaktohet dhe verifikohet identiteti i tij. Në qoftë se për shkaqe teknike, të dhënat e siguruara nuk mund të përcillen, atëherë përcillet vetëm e dhëna lidhur me numrin e llogarisë ose shenja unike identifikuese e transaksionit.

(3) Institucionet financiare nga paragrafi (2) i këtij neni, me kërkesë të institucionit financiar i cili duhet ta kryejë pagesën, ose të organeve kompetente, janë të detyruar që të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni t'i vënë në dispozicion në afat prej tri ditë pune nga dorëzimi i kërkesës.

(4) Institucionet financiare të cilët paraqiten si ndërmjetësues në transferimin e mjeteve monetare për shuma prej 1.000 euro ose valutë tjetër në kundërvlerë 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e transferimit, në qarkullimin ndërkombëtar, janë të detyruara t'i përcjellin të dhënat e pagesit nga paragrafi (1) i këtij neni deri te institucioni financiar i cili do ta kryej pagesën e mjeteve.

(5) Kur realizohen pagesa gjatë transferimit të mjeteve monetare në qarkullimin pagesor ndërkombëtar në shumë prej 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës, institucionet financiare janë të detyruara të sigurojnë të dhëna nga institucioni financiar i pagesit për identitetin e pagesit dhe në kuadër të akteve të veta të brendshme të përcaktojnë nëse mungojnë pjesë nga të dhënat nga paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni dhe mënyrën e veprimit me transferime të tilla. Subjektet duhet t'i kërkojnë të dhënat që mungojnë ose të refuzojnë realizimin e transferimit.

(6) Institucionet financiare mund të kufizojnë ose ndërpresin marrëdhënien afariste me institucionet financiare të cilat nuk i sigurojnë, gjegjësisht përcjellin të dhënat e parapara me paragrafët (1), (2), (4) dhe (5) të këtij neni.

(7) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për llojet e mëposhtme të transferimeve:

- shfrytëzimi i kartelave për tërheqjen e mjeteve nga llogaria në bankë, bankomatet ose nëpërmjet terminaleve në pikat e shitjes dhe për pagesa në tregtinë me pakicë,
- transferime dhe barazime të cilat edhe pagesi edhe pranuesi janë banka të cilat transferimin e kryejnë në emrin e vet dhe për llogari të vetë dhe
- pagesa e tatimit, gjobave dhe taksave tjera publike.

Sigurimi dhe përcjellja e informacioneve lidhur me transferimet me asete virtuale

Neni 51

(1) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asete virtuale janë të detyruar gjatë transaksionit të ndërlidhur me asete virtuale në kundërvlerë prej 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e realizimit të transaksionit, për shkak të transferimit të aseteve virtuale në të cilin merr pjesë edhe ofrues tjetër i shërbimeve në lidhje me asete virtuale janë të detyruar të sigurojnë të dhëna për:

a) porositësin e transaksionit në lidhje me asete virtuale - nga të cilat mund të përcaktohet dhe verifikohet identiteti i tij edhe atë:

- emri dhe mbiemri, gjegjësisht emërtimi i porositësit të transaksionit në lidhje me asete virtuale,

- adresa e portofolit të hostuar ose të pahostuar elektronik për asete virtuale, ku në rast se mungon ose nuk mund të përcaktohet, atëherë është e nevojshme të përcaktohet shenja unike e identifikimit të transaksionit me asete virtuale, e cila mundëson ndjekjen e tij dhe

- adresa ose numri i dokumentit të vlefshëm kombëtar për identifikim ose numër identifikues të klientit ose data dhe vendi i lindjes.

b) pranuesi – nga ku mund të përcaktohet identiteti i tij edhe atë:

- emri dhe mbiemri, gjegjësisht emërtimi i pranuesit dhe

- adresa e portofolit të hostuar ose të pahostuar elektronik për asete virtuale, ku në rast se mungon ose nuk mund të përcaktohet, atëherë është e nevojshme të përcaktohet shenja unike e identifikimit të transaksionit, e cila mundëson ndjekjen e tij.

(2) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asete virtuale të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar t'i vënë në dispozicion për ofruesit tjerë të shërbimeve në lidhje me asete virtuale në momentin e realizimit të transferimit të aseteve virtuale dhe në mënyrën me të cilën sigurohet integritet i atyre të dhënave si dhe mbrojtje nga qasja e paautorizuar.

(3) Ofruesi i shërbimeve në lidhje me asete virtuale është i detyruar të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni t'i vë në dispozicion në kërkesë të organit kompetent nga ky ligj.

(4) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asete virtuale të cilët shfaqen si ndërmjetësues në transferimin e mjeteve virtuale për shuma në kundërvlerë prej 1.000 euro ose më shumë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e realizimit të transaksionit në lidhje me asetet virtuale, dhe për shkak të transferimit të aseteve virtuale janë të detyruar t'i përcjellin të dhënat për porositësin të transaksionit në lidhje me asete virtuale nga paragrafi (1) i këtij neni deri te ofruesi i shërbimeve për asete virtuale të pranuesit.

(5) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asete virtuale janë të detyruar në kuadër të procedurave të brendshme në pajtim me këtë ligj, të përcaktojnë mekanizma për kontroll të të dhënave të nevojshme për realizim të transaksionit në lidhje me transferimin e aseteve virtuale në kuptim të këtij neni me të cilat do të përcaktojnë nëse mungojnë të dhënat nga ky nen.

(6) Me procedurat e brendshme nga paragrafi (5) i këtij neni, ofruesit e shërbimeve në lidhje me asete virtuale janë të detyruar ta përcaktojnë edhe mënyrën e veprimit me transaksione të tilla në lidhje me asetet virtuale.

(7) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asete virtuale janë të detyruar t'i kërkojnë të dhënat që mungojnë ose të refuzojnë realizimin e transaksionit në lidhje me asete virtuale.

(8) Ofruesit e shërbimeve në lidhje me asete virtuale mund të kufizojnë ose ndërpresin marrëdhënien afariste me ofruesit e shërbimeve në lidhje me asetet virtuale të cilët nuk i sigurojnë, gjegjësisht përcjellin të dhënat e parapara nga nen.

Ofruesit e shërbimeve të lidhura me asete virtuale

Neni 52

(1) Ofruesit e shërbimeve të lidhura me asete virtuale gjatë realizimit të transaksionit në lidhje me asetet virtuale në kuptimin e këtij ligji, përveç masave të përcaktuara me nenin 15 të këtij ligji, janë të detyruar para çdo transaksioni të rastësishëm me asete virtuale të vërtetojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji.

(2) Ofruesi i shërbimeve që kanë të bëjnë me asete virtuale në kuadër të zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga ky ligj, përveç masave nga neni 15 të këtij ligji, është i detyruar të siguroj dhe ruaj të dhënat në portofolin elektronik të hostuar ose jo të hostuar, respektivisht adresën për asete virtuale të cilën e shfrytëzon ose e ka shfrytëzuar klienti për realizimin e një transaksioni që ka të bëjë me asete virtuale, si dhe të ndërmerrë masa me të cilat do të përcaktojë nëse klienti përdor më shumë portofolio, gjegjësisht adresa për asete virtuale.

(3) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që të dhënat për klientin t'i shënojnë me renditje kronologjike në një regjistër të numeruar të nënshkruar nga personi i autorizuar ose nga një person tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin e dhënë nga personi udhëheqës në pajtim me aktet e brendshme të subjekteve.

Punët lidhur me këmbimet

Neni 53

(1) Subjektet që kanë leje për punë këmbese, përveç masave të parashikuara në nenin 15 të këtij ligji, janë të detyruar të vërtetojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji para çdo transaksioni që përfshin një shumë më të madhe se 500 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që të dhënat për klientin t'i shënojnë me një renditje kronologjike në një regjistr të numeruar të nënshkruar nga personi i autorizuar ose një person tjetër me autorizim për nënshkrimin e regjistrit të dhënë nga personi udhëheqës në pajtim me aktet e brendshme të subjekteve.

(3) Regjistri i numeruar nga paragrafi (2) i këtij neni përmban këto të dhëna:

- “Numri rendor”, shënohen transaksionet sipas rendit kronologjik duke filluar nga njësia numerike “një” e më tej, deri në përmbyllje të regjistrit me faqen e fundit për muajin rrjedhës;

- „Data”, shënohet data kur është realizuar transaksio”i;

- “Emri dhe mbiemri i personit fizik” shënohet në origjinal si në dokumentin e vlefshëm të identifikimit, emri dhe mbiemri i klientit i cili ka realizuar transaksionin mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “Data dhe vendi i lindjes”, shënohet në origjinal nga dokumenti i vlefshëm i identifikimit, data dhe vendi i lindjes të klientit i cili ka realizuar transaksion mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “Adresa dhe vendi i banimit ose vendqëndrimit”, shënohet në origjinal si në dokumentin e vlefshëm të identifikimit, adresa dhe vendi i banimit ose vendqëndrimi i klientit i cili ka realizuar transaksion mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “NVAQ ose numri për identifikim”, shënohet në origjinal si në dokumentin e vlefshëm të identifikimit, numri unik amë i qytetarit – rezident ose numri për identifikim i personit fizik - jo rezident, për klientin i cili ka realizuar transaksion mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “Numri i dokumentit për identifikim”, shënohet numri i dokumentit për identifikim (numri i letërnjoftimit ose i pasaportës) i klientit i cili ka realizuar transaksion mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “Organi që ka lëshuar dokumentin e identifikimit”, shënohet organi i cili e ka lëshuar dokumentin për identifikim (numri i letërnjoftimit ose pasaportës) të klientit i cili ka realizuar transaksion mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “Blerja/shitja”, shënohet nëse përmes transaksionit blihen ose shiten para efektive të huaja mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “Lloji i valutës”, shënohet shenja (kodi) i valutës lidhur me transaksionin mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë, në pajtim me Udhëzimin për mënyrën e funksionimit të qarkullimit pagesor me vendet e huaja të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- “Shuma e transaksionit”, shënohet shuma e transaksionit mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë;

- “Emri dhe mbiemri”, shënohet emri dhe mbiemri i personit të autorizuar ose personit me autorizim për të nënshkruar regjistrin dhe

- Nënshkrimi i personit të autorizuar ose personit tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin.

Organizatorët e lojërave të fatit

Neni 54

(1) Organizatorët e lojërave të fatit në lojtore (kazino), përveç masave të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji, janë të detyruar të vërtetojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji, menjëherë pas hyrjes në kazino ose gjatë blerjes apo pagesës së çipave ose kredive në vlerë mbi 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e blerjes, gjegjësisht pagesës, pavarësisht nëse realizohet një transaksion i vetëm ose nëpërmjet disa transaksioneve që dukshëm janë të ndërlidhura.

(2) Organizatorët e lojërave të fatit, me përjashtim të organizatorëve të lojërave të fatit në lojtore (kazino), përveç masave të përcaktuara me nenin 15 të këtij ligji janë të detyruar të vërtetojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji para pagesës së fitimit, pagesës

së depozitës ose në të dy rastet kur transaksioni është në vlerë prej 1.000 euro ose më shumë, në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse realizohet një transaksion i vetëm ose nëpërmjet disa transaksioneve që dukshëm janë të ndërlidhura.

Shtëpi brokere dhe banka me leje për punë me letra me vlerë

Neni 55

(1) Shtëpitë brokere dhe bankat me leje për punë me letra me vlerë janë të detyruar të mbajnë regjistër të numeruar për tregtimin e letrave me vlerë shuma e të cilave është më e madhe se 15.000 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të nënshkruar nga personi i autorizuar ose një person tjetër me autorizim për nënshkrimin e regjistrit të lëshuar nga personi udhëheqës në pajtim me aktet e shtëpive brokere dhe bankave me leje për punë me letra me vlerë.

(2) Regjistri i numeruar nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban të dhënat në vijim:

- “Numri rendor”, shënohen transaksionet sipas renditjes kronologjike, duke filluar nga njësia numerike “një” e më tej, deri sa të përmbillet faqja e fundit e regjistrit për muajin rrjedhës;

- “Data”, shënohet data kur është realizuar transaksioni;

- “Emri dhe mbiemri i klientit – personit fizik/ Emërtimi i klientit – person juridik”, shënohet në origjinal nga dokumenti i vlefshëm për identifikim, emri dhe mbiemri kur klienti është person fizik, ose shënohet emërtimi i personit juridik kur klienti është person juridik;

- “Data dhe vendi i lindjes së klientit – person fizik”, shënohet në origjinal nga dokumenti i vlefshëm i identifikimit, data dhe vendi i lindjes i klientit në raste kur ai është person fizik;

- “Adresa dhe vendi i banimit apo vendqëndrimi i klientit – person fizik /selia e klientit – personit juridik”, shënohet në origjinal nga dokumenti i vlefshëm për identifikim, adresa dhe vendi i banimit ose vendqëndrimit në raste kur klienti është person fizik ose shënohet selia në raste kur klienti është person juridik;

- “NVAQ ose numri për identifikim i klientit – person fizik /NVT ose numri për identifikimin e klientit – person juridik”, shënohet në origjinal nga dokumenti i vlefshëm i identifikimit NVAQ (numri i vetëm i amzës i qytetarit) kur klienti është person fizik – rezident, ose numri për identifikim kur klienti është person fizik – jo rezident, ose shënohet NVT (numri i vetëm i tatimit) kur klienti është person juridik – rezident, ose numri për identifikim kur klienti është person juridik - jo rezident;

- “Numri i dokumentit për identifikim i klientit – person fizik /përfaqësuesit ligjor të klientit – person juridik”, shënohet numri i dokumentit të vlefshëm për identifikim (numri i letërnjoftimit ose numri i pasaportës);

- “Organi i cili e ka lëshuar dokumentin për identifikim të klientit – person fizik/përfaqësuesit ligjor të klientit - person juridik”, shënohet organi i cili e ka lëshuar dokumentin e vlefshëm për identifikim;

- “Emri dhe mbiemri dhe NVAQ ose numri për identifikim i personit të autorizuar”, në origjinal nga dokumenti për identifikim, shënohet emri, mbiemri dhe NVAQ kur personi fizik i autorizuar është rezident ose numri për identifikim kur në raste kur personi fizik i autorizuar është jo rezident;

- “Emri, mbiemri dhe NVAQ ose numri për identifikim i pronarit të vërtetë”, në origjinal nga dokumenti për identifikim shënohet emri, mbiemri dhe NVAQ në raste kur pronari i vërtetë është rezident ose emri, mbiemri dhe numri për identifikim në raste kur pronari i vërtetë është jo rezident;

- “Blerja ose shitja”, shënohet fjala „blerje” ose fjala „shitje” varësisht nga rasti konkret;

- “Llogaria e klientit - personi fizik ose juridik ose e autorizuesit”, shënohet me numra, numri i llogarisë së transaksionit të klientit ose të autorizuesit kur është person fizik ose juridik, nëpërmjet të cilit është realizuar transaksioni;
- “Numri i aksioneve”, shënohet me numra sa aksione janë blerë ose shitur;
- “Shuma e përgjithshme e transaksionit në denarë”, shënohet me numra shuma e përgjithshme e transaksionit të realizuar;
- “Emetues i aksioneve”, shënohet emërtimi i personit juridik i cili është emetues i aksioneve të cilët janë objekt i transaksionit;
- “Emri dhe mbiemri”, shënohet emri dhe mbiemri i personit të autorizuar ose personit tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin dhe
- nënshkrimi i personit të autorizuar ose personit tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin.

Personat që tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetësues në tregtimin me vepra të artit

Neni 56

(1) Subjektet që janë persona të cilët tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetësues në tregtimin me vepra të artit në pajtim me nenin 5 paragrafi (1) pika 8) nga ky ligj, përveç masave të përcaktuara me nenin 15 të këtij ligji, janë të detyruar të përcaktojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji para çdo transaksioni që përfshin shumë mbi 10.000 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse realizohet si një transaksion i vetëm ose përmes disa transaksioneve që janë dukshëm të ndërlidhura.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që të dhënat për klientin t'i regjistrojnë në mënyrë kronologjike në një regjistër të numeruar të nënshkruar nga personi i autorizuar ose personi tjetër me autorizim për nënshkrimin e regjistrit të lëshuar nga personi udhëheqës në pajtim me aktet e subjekteve.

(3) Regjistri i numeruar nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban të dhënat në vijim:

- “Numri rendor”, shënohen transaksionet me renditje kronologjike, duke filluar nga njësia numerike “një” e më tej, deri në përmbylljen e regjistrit me faqen e fundit për muajin rrjedhës;
- “Data” shënohet data kur është realizuar transaksioni;
- “Emri dhe mbiemri i klientit - person fizik / Emërtimi i klientit - person juridik”, në origjinal nga dokumenti për identifikim, shënohet emri dhe mbiemri në raste kur klienti është person fizik ose shkruhet emërtimi i personit juridik në raste kur klienti është person juridik;
- “Data dhe vendi i lindjes së klientit – person fizik”, shënohet në origjinal nga dokumenti i vlefshëm për identifikim, data dhe vendi i lindjes së klientit në raste kur është person fizik;
- “Adresa dhe vendi i banimit ose vendqëndrimi i klientit - person fizik/selia e klientit - person juridik”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim, adresa dhe vendi i banimit ose vendqëndrimi në raste kur klienti është person fizik ose shënohet selia në rastet kur klienti është person juridik;
- “NVAQ ose numri për identifikim i klientit – person fizik/NUT ose numri për identifikim i klientit – person juridik”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim NVAQ (numri i vetëm i amzës i qytetarit) në rastet kur klienti është person fizik – rezident ose numri për identifikim në rastet kur klienti është person fizik – jo rezident, ose shënohet NVT (numri i vetëm i tatimit) në rastet kur klienti është person juridik – rezident ose numri për identifikim në rastet kur klienti është person juridik – jo rezident;
- “Numri i dokumentit për identifikimin e klientit - person fizik/ përfaqësuesit ligjor të klientit - person juridik”, shënohet numri i dokumentit për identifikim (numri i letërnjoftimit ose numri i pasaportës);

- “Organi i cili e ka lëshuar dokumentin për identifikim të klientit – person fizik/përfaqësuesit ligjor të klientit – person juridik”, shënohet organi i cili e ka lëshuar dokumentin për identifikim;
- “Emri, mbiemri dhe NVAQ ose numri për identifikim i personit të autorizuar”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim emri, mbiemri dhe NVAQ në rastet kur personi fizik i autorizuar është rezident ose numri për identifikim në rastet kur personi fizik i autorizuar është jo rezident;
- “Emri, mbiemri dhe NVAQ ose numri për identifikim i pronarit të vërtetë”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim, emri, mbiemri dhe NVAQ në rastet kur pronari i vërtetë është rezident ose emri, mbiemri dhe numri për identifikim në rastet kur pronari i vërtetë është jo rezident;
- “Blerja ose shitja”, shënohet fjala “blerje” ose fjala “shitje” varësisht nga rasti konkret;
- “Shuma e përgjithshme e transaksionit në denarë”, shënohet me numra shuma e përgjithshme e transaksionit të realizuar;
- “Emri dhe mbiemri”, shënohet emri dhe mbiemri i personit të autorizuar ose personit tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin dhe
- nënshkrimi i personit të autorizuar ose personit tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin.

Persona që magazinojnë, tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetësues në tregtimin me vepra të artit kur aktiviteti zhvillohet në zona të lira

Neni 57

(1) Subjektet që janë persona të cilët tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetësues në tregtimin me vepra të artit në pajtim me nenin 5 paragrafi (1) pika 9) nga ky ligji, përveç masave të përcaktuara me nenin 15 të këtij ligji, janë të detyruar që të përcaktojnë identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji para çdo transaksioni që përfshin shumë mbi 10.000 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse është realizuar si një transaksion i vetëm ose nëpërmjet disa transaksioneve që janë dukshëm të ndërlidhura.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që të dhënat për klientin t'i regjistrojnë me renditje kronologjike në regjistër të numeruar të nënshkruar nga personi i autorizuar ose personi tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin të lëshuar nga personi udhëheqës në pajtim me aktet e brendshme të subjekteve.

(3) Regjistri i numeruar nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban të dhënat në vijim:

- “Numri rendor”, shënohen transaksionet me renditje kronologjike, duke filluar nga njësia numerike “një” e më tej, deri në përmbylljen e regjistrit me faqen e fundit për muajin rrjedhës;
- “Data” shënohet data kur është realizuar transaksioni;
- “Emri dhe mbiemri i klientit - person fizik / Emërtimi i klientit - person juridik”, në origjinal nga dokumenti i vlefshëm për identifikim, shënohet emri dhe mbiemri në rastet kur klienti është person fizik ose shkruhet emërtimi i personit juridik në rastet kur klienti është person juridik;
- “Emri dhe vendi i lindjes së klientit - person fizik”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim, data dhe vendi i lindjes së klientit në rastet kur klienti është person fizik;
- “Adresa dhe vendi i banimit ose vendqëndrimit të klientit - person fizik/selia e klientit - person juridik”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim, adresa dhe vendi i banimit ose vendqëndrimit në rastet kur klienti është person fizik ose shënohet selia në rastet kur klienti është person juridik;
- “NVAQ ose numri për identifikim të klientit - person fizik/ NUT ose numri për identifikim të klientit - person juridik”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim NVAQ (numri i vetëm i amzës i qytetarit) në rastet kur klienti është person fizik - rezident ose numri për identifikim në rastet kur klienti është person fizik - jo rezident, ose shënohet NVT (numri i vetëm i tatimit) në rastet kur klienti është person juridik - rezident ose numri për identifikim në rastet kur klienti është person juridik - jo rezident;

- “Numri i dokumentit për identifikimin e klientit - person fizik/ përfaqësuesit ligjor të klientit - person juridik”, shënohet numri i dokumentit për identifikim (numri i letërnjoftimit ose numri i pasaportës);

- “Organi i cili ka lëshuar dokumentin për identifikim të klientit - person fizik/ përfaqësuesit ligjor të klientit - person juridik”, shënohet organi i cili e ka lëshuar dokumentin për identifikim;

- “Emri, mbiemri dhe NVAQ ose numri për identifikim i personit të autorizuar”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim emri, mbiemri dhe NVAQ në rastet kur personi fizik i autorizuar është rezident ose numri për identifikim në rastet kur personi fizik i autorizuar është jo rezident;

- “Emri, mbiemri dhe NVAQ ose numri për identifikim i pronarit të vërtetë”, shënohet në origjinal nga dokumenti për identifikim emri, mbiemri dhe NVAQ në rastet kur pronari i vërtetë është rezident ose emri, mbiemri dhe numri për identifikim në rastet kur pronari i vërtetë është jo rezident;

- “Blerja ose shitja”, shënohet fjala “blerje” ose fjala “shitje” varësisht nga rasti konkret;

- “Shuma e përgjithshme e transaksionit në denarë”, shënohet me numra shuma e përgjithshme e transaksionit të realizuar;

- “Emri dhe mbiemri”, shënohet emri dhe mbiemri i personit të autorizuar ose personit tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin dhe

- nënshkrimi i personit të autorizuar ose personit tjetër me autorizim për të nënshkruar regjistrin.

(4) Ministri i financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë e përshkruan formën e regjistrin të numeruar nga nenet 52, 53, 55, 56 dhe 57 të këtij ligji.

Ndalesat

Neni 58

(1) Ndalohen pagesat me para të gatshme e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 3.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë në formë të një ose më shumë transaksioneve dukshëm të ndërlidhura, të cilat nuk realizohen përmes bankës, kursimores ose përmes llogarisë në ndonjë institucion tjetër që jep shërbime pagesore, nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ndonjë ligj tjetër.

(2) Subjektet e autorizuara me ligj për regjistrimin e letrave me vlerë, pronës tjetër ose për punë juridike, ose për paraqitjen ose transferimin e parave, letrave me vlerë ose pronës tjetër, mund të realizojnë regjistrim ose transferim të tillë vetëm nëse klienti paraqet dëshmi se transferimi i parave mbi shumën e cekur më lartë në paragrafin (1) të këtij neni është realizuar përmes bankës, kursimores ose përmes llogarisë në një institucion tjetër që ofron shërbime pagesore.

(3) Ndalesa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk vlen për organizatorët e lojërave të fatit.

(4) Ndalohet realizimi i transaksioneve që kanë të bëjnë me shkëmbimin e aseteve virtuale për para në aspektin ligjor, të cilat realizohen me para të gatshme në vlerë mbi 500 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e realizimit të transaksionit, në formë të një ose më shumë transaksioneve dukshëm të ndërlidhura, të cilat nuk janë realizuar përmes bankës, kursimores ose përmes një llogarie në një institucion tjetër që ofron shërbime pagesore.

Neni 59

(1) U ndalohet institucioneve financiare dhe ofruesve të shërbimeve lidhur me asetet virtuale të vendosin ose të vazhdojnë një marrëdhënie afariste me bankën Shell (bankat guackë) dhe të fillojnë ose të vazhdojnë një marrëdhënie afariste korrespondente me një bankë për të cilën e dinë se lejon hapjen dhe punën me llogari në Shell bankat (bankat guackë).

(2) Ndalohet në çfarëdo mënyre që bankat guackë të realizojnë aktivitete financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 60

(1) Ndalohet që institucionet financiare të hapin dhe të mbajnë llogari, libreza kursimi dhe kasaforta në formë anonime, në formë të koduar ose nën emra fiktiv, gjegjësisht të realizojnë edhe shërbime tjera që drejtpërdrejt ose tërthorazi mundësojnë fshehjen e identitetit të klientit, respektivisht anonimitet.

(2) Ndalohet ofrimi i shërbimeve që kanë të bëjnë me asete virtuale që mundësojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë fshehjen e identitetit të klientit si dhe realizimin e transaksioneve me mjetet të tilla virtuale.

(3) Emetuesi i aseteve virtuale si dhe ofruesi i shërbimeve që lidhen me asete virtuale nuk duhet të përdor burime ose mjete përmes sistemit informatik që mundëson ose lehtëson fshehjen e identitetit të klientit ose që pamundëson ose vështirëson ndjekjen e transaksioneve të lidhura me asete virtuale.

Neni 61

Ndalohet pranimi i pagesave të cilat kryhen me kartelë pagesore anonime me abonim (kartelë pagesore me parapagesë) në rastet kur:

1. Instrumenti pagesor plotësohet, ose shuma e përgjithshme e transaksioneve në bazë mujore nuk është e kufizuar në shumën prej 150 euro në kundërvlerë në denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mund të përdoret vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

2. Shuma maksimale e instrumentit pagesor tejkalon shumën prej 150 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

3. Instrumenti pagesor nuk përdoret ekskluzivisht për prokurimin e mallrave ose shërbimeve;

4. Instrumenti pagesor të lëshohet në mënyrë anonime dhe

5. Emetuesi i instrumentit pagesor nuk i ndjek ose nuk i kontrollon transaksionet ose marrëdhëniet afariste, me qëllim të zbulimit të transaksioneve të ndërlikuara ose jo të zakonshme ose transaksioneve të dyshimta.

Ruajtja e të dhënave

Neni 62

(1) Subjektet janë të detyruara të ruajnë dokumente ose të dhëna elektronike të siguruara me masat për analizë të klientit, dosjen e klientit dhe korespondencën afariste, rezultatet nga cilado qoftë analize të zbatuar mbi klientin ose pronarin e vërtetë, në formë elektronike ose në formë të shkruar, dhjetë vjet nga përfundimi i marrëdhënies afariste me klientin ose nga data e realizimit të transaksionit të përkohshëm.

(2) Subjektet janë të detyruar të ruajnë dokumente ose të dhëna elektronike për të gjitha transaksionet për dhjetë vjet pas realizimit të tyre, përfshirë edhe dëshmitë e bashkangjitura dhe regjistrimet lidhur me transaksionet që përbëhen nga dokumente origjinale ose kopje, që mund të shërbejnë si prova në procedurë gjyqësore të nevojshme për të identifikuar dhe të mundësoj rekonstruimin e transaksioneve individuale.

(3) Subjektet janë të detyruar t'i ruajnë të dhënat, në mënyrën se si i kanë dorëzuar tek Drejtoria, për dhjetë vjet nga dita e dorëzimit. Pas skadimit të këtij afati, subjektet janë të detyruar t'i fshijnë të dhënat personale të klientit.

(4) Institucionet financiare dhe ofruesit e shërbimeve lidhur me asetet virtuale janë të detyruar që t'i ruajnë të dhënat për pagesin ose porositësin dhe pranuesin e transferimit pa para të gatshme ose transferimit të aseteve virtuale nga neni 50 dhe 51 të këtij ligji, për dhjetë vjet nga realizimi i transferimit.

(5) Regjistri nga nenet 52, 53, 54, 55, 56 dhe 57 të këtij ligji detyrimisht ruhet dhjetë vjet nga e dhëna e fundit e regjistruar.

(6) Subjektet janë të detyruar të ruajnë kopje të dokumentacionit nga neni 69 të këtij ligji, dhjetë vjet nga dita e zbatimit të kontrollit të brendshëm.

(7) Në rast të shuarjes së subjektit, detyrimi për ruajtjen e të dhënave në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, u kalon trashëgimtarëve juridik të subjektit.

(8) Nëse personi juridik nuk ka trashëgimtarë juridik, detyrimi për ruajtjen e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni u bartet themeluesëve të tij.

(9) Subjektet janë të detyruar që dokumentet nga paragrafi (1) i këtij neni, t'i vënë në dispozicion me kërkesë të organeve mbikëqyrëse nga neni 151 të këtij ligji.

(10) Me kërkesë të Drejtorisë, subjektet janë të detyruar t'i ruajnë të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, më shumë se dhjetë vite.

Dorëzimi i të dhënave te Drejtoria

Neni 63

(1) Subjektet janë të detyruar që të dhënat, informatat dhe dokumentet e grumbulluara t'i dorëzojnë te Drejtoria në rast të transaksionit me para të gatshme në shumë prej 15.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse bëhet fjalë për një apo më shumë transaksione dukshëm të lidhura.

(2) Subjektet janë të detyruar që të dhënat, informatat dhe dokumentet e grumbulluara për transaksionet e realizuara nga paragrafi (1) i këtij neni t'i dorëzojnë te Drejtoria në formë raporti jo më vonë se tre ditë pune nga dita e transaksionit të realizuar.

(3) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë, e përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit nga paragrafi (2) i këtij neni.

Neni 64

(1) Të dhënat e grumbulluara për dokumentet e hartuara të noterizuara dhe noterizimin e nënshkrimeve të kontratave me të cilat përfitohet e drejta e pronësisë në vlerë prej 15.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ditën e përpilimit ose noterizimit, të cekura në kontratë, si dhe dokumentet noteriale të përpiluara dhe noterizimin e nënshkrimeve të kontratave nga ky paragraf, noterët i dorëzojnë te Drejtoria në formë elektronike jo më vonë se tre ditë pune nga dita e përpilimit ose noterizimit.

(2) Të dhënat e mbledhura për kreditë e aprovuara për klientët e tyre në shumë prej 15.000 euro ose më shumë, në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën kur është kredia është paguar, bankat i dorëzojnë te Drejtoria deri në ditën e dhjetë të muajit rrjedhës për muajin paraprak në formë të raporteve përmes formës elektronike.

(3) Të dhënat e mbledhura për huatë e dhëna dhe/ose të pranuar ndërmjet klientëve në vlerë prej 5.000 euro ose më shumë, në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bankat i dorëzojnë te Drejtoria deri në ditën e dhjetë të muajit rrjedhës për muajin paraprak në formë të raporteve përmes formës elektronike.

(4) Ofruesit e shërbimeve të remitencave (transfer i shpejtë i parave) të dhënat lidhur me transaksionet në vlerë prej 1.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e realizimit të tyre, i dorëzojnë te Drejtoria në formë të raporteve përmes formës elektronike, më së voni në afat prej tre ditë pune nga dita e realizimit të transaksionit.

(5) Shoqëritë e sigurimit që merren me veprimtari të sigurimit të jetës, të dhënat e mbledhura për policat e lidhura si dhe policën e lidhur të sigurimit, lidhur për sigurimin e jetës i dorëzojnë deri te Drejtoria në formë të raporteve përmes formës elektronike jo më vonë se tre ditë pune nga dita e lidhjes në rastet e mëposhtme:

- për policat e lidhura të sigurimit të jetës me pagesë të premisë për policat e sigurimit të jetës në vlerë prej 15.000 euro ose më shumë dhe pagesë në raste të riblerjes së policës ose kredisë në shumë prej 15.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e lidhjes së policës së sigurimit, gjegjësisht në ditën e realizimit të pagesës, përveç kontratave të sigurimit të jetës pa komponentë të kursimit, gjegjësisht pa komponentë investuese, dhe

-për policat e lidhura të sigurimit të jetës kur kemi të bëjmë me bartës të funksionit publik, pavarësisht nga vlera e shumës së siguruar, me përjashtim të kontratave të sigurimit të jetës pa komponentë kursimi, respektivisht pa komponentë investuese.

(6) Personat juridik veprimtaria e të cilëve është shitblerja e automjeteve, të dhënat e mbledhura për kontratat e lidhura për shitblerje të automjeteve të reja në vlerë prej 15.000 euro ose më shumë, në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e lidhjes së kontratës, i dorëzojnë në formë të raportit përmes formës elektronike jo më vonë se tre ditë pune nga dita e lidhjes së kontratës.

(7) Organizatorët e lojërave të fatit në lojtore (kazino), të dhënat e mbledhura për blerjen ose pagesën e çipave ose kredive në vlerë prej 1.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e blerjes, përkatësisht pagesës, pavarësisht nëse kemi të bëjmë me transaksion të vetëm ose transaksione që dukshëm janë të lidhura, i dorëzojnë te Drejtoria në formë të raportit përmes formës elektronike jo më vonë se tre ditë pune nga dita e blerjes apo pagesës.

(8) Organizatorët tjerë të lojërave të fatit, përveç organizatorëve të lojërave të fatit në lojtore (kazino), të dhënat e mbledhura për pagesën e fitimeve, pagesën e depozitës ose në të dyja rastet kur transaksioni është në vlerë prej 1.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pavarësisht nëse kemi të bëjmë me transaksion të vetëm ose transaksione që dukshëm janë të lidhura, i dorëzojnë te Drejtoria në formë të raportit përmes formës elektronike jo më vonë se tre ditë pune nga dita e pagesës, depozitimit ose në të dyja rastet.

(9) Ofruesit e shërbimeve që lidhen me asete virtuale, gjatë realizimit të aktiviteteve gjegjësisht ofrimit të shërbimeve për këmbim të aseteve virtuale dhe valutave fiat ose parave në kuptimin e ligjit, të dhënat për transaksionet e realizuara në vlerë prej 1.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ditën e realizimit të transaksionit edhe atë pavarësisht nëse kemi të bëjmë me transaksion të vetëm ose transaksione që dukshëm janë të lidhura, i dorëzojnë te Drejtoria në formë të raportit përmes formës elektronike jo më vonë se tre ditë pune nga dita e realizimit të transaksionit.

(10) Përmbaruesit, të dhënat e mbledhura për shitjet përmes ankandit publik verbal dhe kontratat për shitje me marrëveshje të drejtpërdrejta me të cilat fitohet e drejta për pronësi mbi pronën në vlerë prej 15.000 euro ose më shumë, në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ditën e përpilimit të tyre, i dorëzojnë te Drejtoria pavarësisht nëse kemi të bëjmë me transaksion të vetëm ose transaksione që dukshëm janë të lidhura, i dorëzojnë te Drejtoria në formë të raportit përmes formës elektronike në afat prej tre ditë pune nga dita e përpilimit të kontratës së shitjes me marrëveshje të drejtpërdrejta.

(11) Raportet nga paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9) dhe (10) nga ky nen, përmbajnë të dhëna për numrin e amzës ose numër tjetër për identifikim të personit, emri dhe mbiemri, data dhe vendi i lindjes, gjinia dhe nënshtetësia.

(12) Ministri i financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë, e përcakton formën e raporteve, llojin dhe kategoritë e të dhënave nga paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10) dhe (11) të këtij neni dhe mënyrën e dorëzimit elektronik te Drejtoria.

Neni 65

(1) Subjektet janë të detyruar që të dhënat, informatat dhe dokumentet e grumbulluara t'i dorëzojnë te Drejtoria:

1) kur e dijnë, dyshojnë ose kanë bazë të dyshojnë se me këto transaksione është bërë ose bëhet pastrim i parave dhe/ose financim i terrorizmit ose është bërë apo bëhet tentim për pastrim të parave dhe/ose financim të terrorizmit, pavarësisht nga shuma e transaksionit;

2) kur e dijnë, dyshojnë ose kanë bazë për dyshim se prona paraqet të ardhur nga një vepër penale ose

3) kur e dijnë, dyshojnë ose kanë bazë për dyshim se prona ka lidhje me financimin e një akti terrorist, organizatë terroriste ose terrorist apo një person që financon terrorizmin ose ka lidhje me financimin e armëve për shkatërrim në masë.

(2) Nëse subjekti dyshimet nga paragrafi (1) i këtij neni i ka mësuar para realizimit të transaksionit, është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Drejtorinë dhe ta mbajë transaksionin më së shumti deri në 2 orë nga njoftimi i Drejtorisë.

(3) Nëse subjekti, i ka mësuar bazat për dyshim nga paragrafi (1) i këtij neni gjatë realizimit të transaksionit, është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Drejtorinë dhe ta mbajë transaksionin më së shumti deri në 4 orë nga njoftimi i Drejtorisë.

(4) Për dyshimet nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti është i detyruar të dorëzojë të dhëna, informata dhe dokumente të sakta te Drejtoria në formë të raportit jo më vonë se 24 orë prej kur i ka mësuar bazat për dyshim.

(5) Nëse të dhënat e dorëzuara nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni janë të pamjaftueshme, Drejtoria mund të kërkojë informata, të dhëna dhe dokumentacion shtesë nga subjekti.

(6) Nëse Drejtoria nuk e njofton subjektin për aktivitetet e mëtutjeshme brenda afateve të përcaktuara në paragrafin (2) dhe (3) të këtij neni, subjekti mund të realizoj ose refuzoj transaksionin.

(7) Subjektet, me përjashtim të noterëve, avokatëve dhe shoqërive të avokatëve, janë të detyruar që të njoftojnë me shkrim organin kompetent për mbikëqyrje nga neni 151 të këtij ligji se te Drejtoria kanë dorëzuar raport nga paragrafi (4) i këtij neni, në afat prej tre ditë pune nga dita e dorëzimit të raportit.

(8) Drejtoria është e detyruar ta informojë subjektin për pranimin dhe kontrollet e kryera lidhur me raportin nga paragrafi (4) i këtij neni.

(9) Raporti nga paragrafi (4) i këtij neni përmban të dhëna për numrin unik amë ose numër tjetër për identifikim të personit, emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë dhe nënshtetësinë.

(10) Ministri i financave, me propozim të drejtorit të Drejtorisë, përcakton formën, llojin dhe kategoritë e të dhënave nga raporti i paraparë me paragrafin (4) të këtij neni.

Neni 66

Bazat për dyshim nga neni 65 paragrafi (1) të këtij ligji, subjekti i përcakton në bazë të:

- njohurive të drejtpërdrejta për klientin,
- listës së treguesve për njohjen e transaksioneve të dyshimta të përcaktuara nga Drejtoria, subjektet dhe organet mbikëqyrëse,
- listës së konsoliduar e cila mbahet në pajtim me dispozitat për masat restriktive,
- tipologjive dhe trendeve të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit të përcaktuara nga Drejtoria,

- rrezikut të vlerësuar nga pastrimi i parave dhe financimit të terrorizmit dhe nga profili i përcaktuar i rrezikut të klientit dhe
- informatave tjera relevante.

Neni 67

(1) Subjektet janë të detyruar që raportet t'i dorëzojnë te Drejtoria përmes kanalit të mbrojtur elektronik. Nëse kjo mënyrë e dorëzimit është e pamundësuar për arsye teknike, subjektet i dorëzojnë raportet në formë të shkruar.

(2) Njoftimet që i jepen Drejtorisë përmes telefonit duhet të konfirmohen në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, më së voni në afat prej 24 orëve.

(3) Drejtoria nuk guxon të zbulojë identitetin e të punësuarit në subjektin i cili e dorëzon raportin, përveç në rastet kur ekziston dyshimi se i punësuarit ose subjekti ka kryer veprë të dënueshme lidhur me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, me kërkesë të gjykatës kompetente në formë të shkruar kur është e nevojshme të vërtetohen faktet gjatë procedurës penale.

Emërimi i personit të autorizuar dhe formimi i njësisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Neni 68

(1) Subjektet janë të detyruar të emërojnë person të autorizuar dhe zëvendës të tij.

(2) Subjekti tek i cili është i punësuar vetëm një person, nuk është i detyruar të emërojë zëvendës të personit të autorizuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Nëse në subjekt ka më shumë se 50 persona të punësuar të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt me veprimtaritë për të cilat janë të detyruar t'i zbatojnë masat dhe veprimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përveç obligimit nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti në kuadër të fushëveprimit të tij është i detyruar të themelojë njësi të veçantë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(4) Në njësinë nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të jenë të punësuar më së paku katër persona, nëqoftëse subjekti ka nga 50 deri 300 persona të punësuar, atëherë numri i të punësuarve në njësi duhet të rritet për një person në çdo 100 të punësuar.

(5) Subjekti, në bazë të rezultateve nga vlerësimi i rrezikut, në njësinë nga paragrafi (3) i këtij neni mund të punësojë më shumë persona sesa numri i personave të parashikuar në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

(6) Me njësinë nga paragrafi (3) i këtij neni, udhëheq personi i autorizuar nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Personi i autorizuar, zëvendësi i tij, si dhe të punësuarit në njësi duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk janë të dënuar për vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, vepra penale kundër detyrës zyrtare, vepra penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare dhe të tjera;

b) të kenë së paku arsim të mesëm, njohuri dhe përvojë profesionale përkatëse për zbatimin e detyrave në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe

c) të kenë njohuri të mira për veprimtarinë afariste dhe për proceset e punës së subjektit.

(8) Udhëheqësit e njësisë nga paragrafi (6) i këtij neni dhe personat e autorizuar të ofruesve të shërbimeve të remitencave (transfer i shpejtë i parave) duhet t'i plotësojnë këto kushte:

a) nuk janë të dënuar për vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, vepra penale kundër detyrës zyrtare, vepra penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare dhe të tjera;

b) të kenë arsim të lartë, njohuri dhe përvojë profesionale përkatëse për zbatimin e detyrave në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe

c) të kenë njohuri të mira të veprimtarisë afariste dhe për proceset e punës së subjektit.

(9) Te subjektet nga paragrafi (3) i këtij neni, personi i autorizuar, zëvendësi i tij, si dhe të gjithë personat e punësuar në njësitë nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë në pajtim me dispozitat për siguri të informacioneve të klasifikuara dhe është e nevojshme të kenë çertifikatë sigurie.

(10) Që të mund të realizojnë punën në mënyrë efikase personi i autorizuar, zëvendësi i tij dhe punonjësit në njësi, subjekti është i detyruar të sigurojë dhe të përmbushë së paku këto kushte të mëposhtme:

- veçim të aktiviteteve të personit të autorizuar, gjegjësisht njësisë, nga aktivitetet tjera afariste të subjektit, të cilat nuk kanë të bëjnë me aktivitetet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe kontrollin e harmonizimit të punës me dispozitat ligjore,

- pavarësi të personit të autorizuar dhe njësisë gjatë zbatimit të masave dhe veprimeve për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me këtë ligj,

- të drejtë për qasje të drejtpërdrejtë në bazat elektronike të të dhënave dhe qasje në kohë deri të të gjitha informacionet e nevojshme për zbatimin e papenguar të programit dhe dispozitave të këtij ligji dhe

- vendosja e komunikimit të drejtpërdrejtë me organet drejtuese të subjektit, etj.

(11) Bankat dhe ofruesit e shërbimeve të remitencave (transfer i shpejtë i parave) janë të detyruara të emërojnë një person të autorizuar kujdestar dhe zëvendësin e tij, i cili në situata urgjente (akt terrorist, kërcënime për akt terrorist) menjëherë, e më së voni brenda tre orëve do të jetë në dispozicion të Drejtorisë. Personi i autorizuar kujdestar dhe zëvendësi i tij duhet të plotësojnë kushtet nga paragrafi (8) dhe (9) të këtij neni.

(12) Bankat dhe ofruesit e shërbimeve të remitencave (transfer i shpejtë i parave) janë të detyruara që për zbatimin e obligimeve të personit të autorizuar kujdestar dhe zëvendësit të tij nga paragrafi (11) i këtij neni, t'i sigurojnë kushtet e nevojshme për punë në pajtim me paragrafin (10) të këtij neni.

(13) Subjekti është i detyruar të sjell masa me të cilat do të sigurojë që të punësuarit të cilët kryejnë detyra nga fusha e parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me këtë ligj, janë të njoftuar me dispozitat e këtij ligji, përfshirë edhe masat adekuate në lidhje me mbrojtjen e të dhënave. Masat duhet të jenë proporcionale me llojin dhe madhësinë e subjektit dhe rrezikun e vlerësuar nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.

(14) Subjekti është i detyruar që të sigurojë trajnim të rregullt profesional nga fusha e parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për të gjithë të punësuarit, në pajtim me këtë ligj.

(15) Subjektet janë të detyruar që deri te Drejtoria në mënyrë elektronike të dorëzojnë të dhëna për personat (emri, mbiemri dhe kontakti) nga paragrafët (1) dhe (11) të këtij neni, si dhe ta informojnë Drejtorinë për çdo ndryshim. Nëse mënyra e këtillë e dorëzimit është e pamundësuar për shkaqe teknike, subjektet njoftimin e dorëzojnë në formë të shkruar deri në momentin e mënjanim të pengesave, respektivisht arsyeve të tilla.

Obligimi për kontroll të brendshëm

Neni 69

Subjektet janë të detyruar që të kryejnë kontroll të brendshëm për zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të paktën një herë në vit në vitin aktual për vitin paraprak dhe të përgatisin dokumentacion për gjendjen e konstatuar nga kontrolli i brendshëm i zbatuar.

Zbatimi i softuerit për përpunimin e automatizuar të të dhënave

Neni 70

(1) Bankat janë të detyruara të implementojnë softuerin dhe mbindërtimin e rregullt të tij për përpunimin e automatizuar të të dhënave në pajtim me karakteristikat e softuerit për përpunimin e automatizuar të të dhënave i cili duhet të plotësojë dispozitat e mbrojtjes së të dhënave personale.

(2) Ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë i përcakton karakteristikat e softuerit për përpunimin e automatizuar të të dhënave.

Përdorimi i të dhënave të siguruara nga ky ligj nga ana e subjekteve

Neni 71

(1) Të dhënat e siguruara në bazë të këtij ligji, përfshirë edhe të dhënat personale, përdoren vetëm për të zbuluar dhe parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në pajtim me ligjin.

(2) Dorëzimi i të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni në Drejtori dhe tek organi mbikëqyrës përkatës të këtij ligji, nuk do të konsiderohet si zbulim i sekretit afarist apo si zbulim i të dhënave dhe informacioneve të klasifikuara, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në pajtim me këtë ligj.

(3) Punonjësit e subjekteve dhe personat që udhëheqin me subjektet që janë të detyruar të ndërmarrin masa dhe veprime për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në pajtim me këtë ligj, nuk guxojnë t'i përdorin të dhënat personale nga dosjet e klientëve për qëllime të tjera përveç për zbatimin e masave dhe veprimeve për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me objektivat e parapara me këtë ligj.

Ndalimi i zbulimit të të dhënave dhe informatave

Neni 72

(1) Subjekti dhe punonjësit e tij, përfshirë edhe anëtarët e bordit drejtues dhe mbikëqyrës ose persona të tjerë, të cilëve u janë të disponueshme të dhënat e siguruara në pajtim me këtë ligj ose aktet nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj, nuk guxojnë të njoftojnë klientin ose palën e tretë, lidhur me:

1. analizën që është duke u zbatuar ose do të zbatohet për përcaktimin e bazave për dyshim lidhur me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit nga Drejtoria;

2. të dhënat, informacionet ose dokumentacionin lidhur me klientin ose palën e tretë ose transaksionin, janë dorëzuar ose do t'i dorëzohen Drejtorisë;

3. lëshimin e urdhërit nga Drejtoria për ndjekjen e marrëdhënieve afariste ose lëshimin e urdhërit me shkrim për ndalim të përkohshëm të transaksionit;

4. veprimet para hetimore, hetimet ose procedurat penale për pastrim parash ose financim të terrorizmit që janë inicuar ose mund të inicohen ndaj klientit ose palës së tretë.

(2) Të dhënat, informacionet dhe dokumentacioni nga paragrafi (1) i këtij neni janë të dhëna të klasifikuara për të cilat është përcaktuar shkalla përkatëse e klasifikimit në pajtim me dispozitat ligjore për mbrojtjen e informatave të klasifikuara.

(3) Subjekti është i detyruar të ndërmerrë masa teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave të siguruara në pajtim me dispozitat e këtij ligji, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e tyre nga humbja aksidentale, shkatërrimi ose qasja e paautorizuar, përdorimi i paautorizuar dhe çdo keqpërdorim tjetër si dhe të përcaktojnë obligimin e punonjësve të cilët i përpunojnë të dhënat, të nënshkruajnë deklaratë të besueshmërisë.

(4) Ndalimi për zbulimin e të dhënave dhe informatave nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet, përveç nëse Drejtoria vendos ndryshe, në rastet kur:

a) shkëmbehen të dhëna dhe informacione ndërmjet institucioneve financiare që bëjnë pjesë në grup të njëjtë, me kusht që ato ti zbatojnë dispozitat që rrjedhin nga normat dhe standardet ndërkombëtare të vlefshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) shkëmbehen të dhëna dhe informacione ndërmjet subjekteve të nenit 5, pika 2) të këtij ligji nga shtetet në të cilat janë parashikuar dispozita të ngjashme për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dispozitat e këtij ligji, e të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre profesionale në kuadër të të njëjtit person juridik ose si pjesë e një strukture më të madhe pronësie ose drejtuese të cilës i përket subjekti juridik.

(5) Ndalimi për zbulimin e të dhënave dhe informacioneve nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet për të dhënat dhe informacionet që kanë të bëjnë me të njëjtin klient ose të njëjtin transaksion ku marrin pjesë dy ose më shumë subjekte, me kusht që të zbatojnë masat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kryejnë të njëjtin lloj të veprimtarisë dhe i nënshtrohen detyrimeve të mbrojtjes së sekretit afarist dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Përgjyeshmëri nga përgjegjësi për raportim dhe mbajtje

Neni 73

(1) Nuk do të inicohet procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë së zbulimit të sekretit afarist ndaj personave apo organit udhëheqës dhe punonjësve në subjektet, si dhe organeve mbikëqyrëse nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji, të cilët kanë dorëzuar informacione apo raporte lidhur me transaksione të dyshimta te Drejtoria.

(2) Nuk mund të inicohet procedurë për përgjegjësi civile ose penale kundër personave zyrtarë ose personave përgjegjës, organit udhëheqës ose punonjësve në subjektet, si dhe organeve të mbikëqyrjes nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji, të cilët kanë dorëzuar të dhëna, informata, dokumente ose raporte në pajtim me dispozitat e këtij ligji, madje as në rastin kur edhe pas informacioneve dhe raporteve të dhëna, procedura nuk ka përfunduar me përcaktim të përgjegjësisë, përkatësisht aktgjykim fuqiplotë.

(3) Nuk mund të ngritet procedurë për përgjegjësi civile ose penale kundër personave zyrtarë ose personave përgjegjës, organit udhëheqës dhe punonjësve në subjektet, si dhe organeve të mbikëqyrjes nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji, për shkak të dëmit të shkaktuar material ose jomaterial, si pasojë e mbajtjes së transaksioneve në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përveç nëse mbajtja e tillë i plotëson tiparet e ndonjë vepre penale.

Sekreti afarist

Neni 74

Thirrja për zbulimin e sekretit afarist nuk mund të pranohet si bazë për refuzim për të siguruar, dhënë dhe dorëzuar të dhëna, informacione dhe dokumente sipas këtij ligji.

KAPITULLI IV.

DREJTORIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

Neni 75

(1) Drejtoria është njësi e inteligjencës financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e themeluar me qëllim të mbledhjes dhe analizës së raporteve që kanë të bëjnë me transaksione të dyshimta dhe informacioneve të tjera të rëndësishme për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit

të parave dhe financimit të terrorizmit dhe dorëzimin e rezultateve të analizës dhe informacioneve të tjera relevante tek organet kompetente atëherë kur ekzistojnë baza për dyshime për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

(2) Drejtoria është organ i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Financave, në cilësinë e personit juridik.

(3) Drejtoria ka kompetencat vijuese:

- mbledh, përpunon, analizon, ruan dhe dorëzon të dhëna të siguruara në bazë të këtij ligji,
- mbledh të dhëna, informacione dhe dokumente të nevojshme për zbatimin e kompetencave të saj,

- përgatit dhe dërgon raporte deri te organet kompetente shtetërore, çdoherë kur ekzistojnë baza për dyshime për kryerjen e veprës penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit,

- përgatit dhe dërgon njoftime deri te organet kompetente shtetërore kur ekzistojnë baza për dyshime për kryerjen e një vepre tjetër penale,

- lëshon urdhër me shkrim deri te subjekti me të cilin përkohësisht e mban transaksionin,

- parashton kërkesë te prokurori publik kompetent për inicimin e propozimit për caktimin e masave të përkohshme,

- parashton urdhër deri te subjekti për ndjekjen e marrëdhënieve afariste,

- lëshon urdhërpagesë për kundërvajtje,

- parashton kërkesë në gjykatën kompetente për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes,

- përgatit analiza strategjike për përcaktimin e trendeve dhe tipologjive të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,

- bashkëpunon me subjektet nga neni 5 të këtij ligji, me Ministrinë e punëve të brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencinë e Zbulimit, Agjencinë e Sigurisë Kombëtare, Drejtorinë e Policisë Financiare, Drejtorinë e Doganës, Drejtorinë e të Ardhurave Publike, Inspektoratin Shtetëror Devizor, Komisionin e Letrave Me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjencinë e Mbikëqyrjes Së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Komisionin Shtetëror të Parandalimit e Korrupsionit, Entin Shtetëror të Revizionit, Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me organet e institucionet e tjera shtetërore, si dhe me organizata, institucione dhe organe të tjera ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit,

- lidh kontrata bashkëpunimi dhe shkëmben të dhëna dhe informacione me njësitë e inteligjencës financiare të vendeve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare, të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,

- në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me organet mbikëqyrëse nga neni 151 të këtij ligji, zbaton mbikëqyrje të subjekteve për zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj,

- merr pjesë në zbatimin e vlerësimit kombëtar të rrezikut lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe zbaton vlerësim të rrezikut ndaj kategorive të caktuara të subjekteve,

- inicion ose jep mendime për aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,

- mund të ndihmojë në trajnimin profesional të personave të autorizuar dhe punonjësve në njësinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në subjektet nga neni 5 të këtij ligji;

- përcakton listat e treguesëve për njohjen e transaksioneve të dyshimta në bashkëpunim me subjektet dhe organet që mbikëqyrin funksionimin e tyre dhe i përditëson rregullisht;

- planifikon dhe zbaton trajnime për përgatitjen dhe përmirësimin profesional të punonjësve në Drejtori,

- zbaton aktivitete lidhur me ngritjen e ndërgjegjësimit të sektorit joqeveritar për rreziqet nga përdorimi i mundshëm i tyre për qëllime të financimit të terrorizmit,
- jep qartësime lidhur me zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- mban evidenca, si dhe statistika gjithëpërfshirëse me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të sistemit për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit e Masave Restriktive dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.

(4) Për zbatimin e kompetencave të veta, Drejtoria në çdo kohë ka qasje elektronike të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në të dhënat, informatat dhe dokumentacionin që disponojnë subjektet, organet dhe institucionet shtetërore dhe personat tjerë juridikë ose fizikë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(5) Drejtoria i kryen punët që janë në kompetencë të saj në pajtim me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me të cilat rregullohet parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(6) Të dhënat personale të mbledhura për qëllimet e këtij ligji do të shfrytëzohen në pajtim me këtë ligj dhe me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(7) Drejtoria një herë në vit përgatit raport për çështjet që janë në kompetencë të saj si dhe programin e punës për vitin e ardhshëm dhe ia dorëzon ministrit të Financave dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Drejtoria mund të dorëzojë edhe raport tjetër me kërkesë të ministrit të Financave ose të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 76

(1) Drejtoria i ushtron kompetencat e veta në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Selia e Drejtorisë është në Shkup.

Parimet themelore të Drejtorisë

Neni 77

(1) Parimet themelore të funksionimit të Drejtorisë janë:

1) ligjshmëria - të gjitha veprimet dhe aktivitetet që ndërmerren në Drejtori janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin,

2) proporcionaliteti – gjatë zbatimit të autorizimeve të përcaktuara me ligj, autorizimet duhet të jenë proporcionale me nevojat për të cilat ndërmerren, duke marrë parasysh seriozitetin e rreziqeve që dalin nga zbatimi i tyre, si dhe arritjen e qëllimit me sa më pak pasoja të dëmshme,

3) efikasiteti - në zbatimin e veprimeve dhe aktiviteteve, kohëzgjatja e tyre, si dhe shpenzimet racionale të fondeve publike për realizimin efektiv të tyre dhe

4) paanshmëria - zbatimi i veprimeve dhe aktiviteteve pa asnjë ndikim në interesat politike dhe interesat personale financiare ose ekzistimi i çfarëdo rasti të konfliktit të interesave në pajtim me ligjin.

Mëvetësia dhe pavarësia operative e Drejtorisë

Neni 78

Drejtorja është e mëvetësishme dhe operativisht e pavarur në zbatimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj dhe ka autoritet që kompetencat e saj t'i ushtrojë plotësisht lirshëm, duke përfshirë marrjen e vendimit për analizën, kërkesën, përcjelljen dhe dorëzimin e rezultateve të

analizave dhe informacioneve, të dhënave dhe dokumentacionit tek organet kompetente dhe njësitë e inteligjencës financiare të një shteti tjetër.

Financimi i Drejtorisë

Neni 79

Mjetet e nevojshme për financimin e Drejtorisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 80

(1) Drejtorja dhe punonjësit e saj nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar ndaj subjekteve, klientëve të subjekteve ose personave të tretë në rastet kur veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij.

(2) Republika e Maqedonisë së Veriut nuk përgjigjet për dëmet që mund të shkaktohen nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji ose akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij.

(3) Me përjashtim, dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk zbatohen nëse dëmi është shkaktuar me qëllim.

Neni 81

(1) Drejtorin e Drejtorisë e emëron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrit të Financave pas shpalljes publike në tri gazeta ditore në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra nga gazetat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20 % e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja.

(2) Drejtori i Drejtorisë ka mandat pesë vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

(3) Drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:

1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

2) të ketë 240 kredite sipas EKTS ose shkallës VII/1 të arsimimit;

3) të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

4) nuk është dënuar për vepra penale kundër pasurisë, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesorë dhe ekonomisë, vepra penale kundër detyrës zyrtare, vepra penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare dhe vepra të tjera penale dhe

5) të posedojë një nga çertifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetim për njohjen aktive të gjuhës angleze:

- TOEFL IBT – së paku 74 pikë,

- IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,

- ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2,

- FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i kaluar,

- BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose

- APTIS (APTIS) – së paku niveli B2.

6) të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase;

7) të posedojë certifikatë të njohjes së programeve kompjuterike për punën në zyrë;

(4) Mandati i drejtorit përfundon:

- pas kalimit të pesë viteve nga dita e emërimit,

- në rast vdekjeje,

- në rast të dorëheqjes së tij,

- në rast shkarkimi,

- në rast se është dënuar me aktgjykim fuqiplotë për vepër penale të dënueshme me burg së paku gjashtë muaj,

- kur gjykata ka vendosur masën e ndalimit për të kryer veprimtarinë e drejtuesit në institucion dhe

- nëse ka humbur aftësinë për të vepruar.

(5) Drejtori mund të shkarkohet për shkak të:

- punës së paligjshme,

- kryerjes joprofesionale të detyrës së drejtorit,

- në rast të një sëmundjeje të rëndë afatgjate që e pengon në kryerjen e detyrave të tij dhe

- me kërkesën e tij.

(6) Drejtori e udhëheq dhe e përfaqëson Drejtorinë, organizon dhe siguron punën ligjore, efikase dhe profesionale të Drejtorisë, sjell aktvendime, urdhëresa dhe urdhëra të brendshëm, udhëzime, plane dhe programe, paralajmërime me rekomandime dhe akte të tjera në pajtim me ligjin.

(7) Drejtori mund të autorizojë zyrtarin e inteligjencës financiare të kategorisë A nga neni 87, paragrafi (1) të këtij ligji, në rast të mungesës ose pengimit të tij, të nënshkruajë aktet nga paragrafi (6) i këtij neni.

Neni 82

Drejtori i Drejtorisë dhe punonjësit e saj i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë në pajtim me dispozitat lidhur me sigurinë e informatave të klasifikuara.

Neni 83

(1) Në Drejtori, vendet e punës janë të ndara në grupe dhe nëngrupe në pajtim me Ligjin e të punësuarve në sektorin publik:

1) vendet e punës për nëpunësit administrativ;

2) vendet e punës për nëpunësit e autorizuar zyrtarë dhe

3) vendet e punës për personat ndihmës-teknik.

Neni 84

(1) Punonjësit e Drejtorisë nga neni 83 të këtij ligji, kanë kartë zyrtare të identifikimit.

(2) Formën, përmbajtjen, mënyrën e lëshimit, heqjes dhe përdorimit të kartës zyrtare të identifikimit e përcakton ministri i Financave, me propozim të drejtorit.

Neni 85

(1) Punonjësit e Drejtorisë, të cilët kryejnë punë të natyrës administrative, kanë statusin e nëpunësve administrativ.

(2) Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, punësimin, sistemin e pagave, avancimin, ngritjen profesionale dhe aftësimin, matjen e efektit dhe çështjet tjera lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve administrativë, zbatohen dispozitat e Ligjit të Nëpunësve Administrativë.

Neni 86

(1) Punonjësit e Drejtorisë, të cilët kryejnë punë ndihmëse-teknike, kanë statusin e personave ndihmës-teknik.

(2) Për çështjet që kanë të bëjnë me klasifikimin, evidentimin, punësimin dhe lëvizshmërinë e punëtorëve nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohet Ligji i Nëpunësve të Sektorin Publik, ndërsa për çështjet e tjera në lidhje me marrëdhënien e punës, zbatohen dispozitat e përgjithshme të marrëdhënieve të punës dhe kontratave kolektive.

KAPITULLI V.

TË DREJTAT, DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË E PUNONJËSVE TË AUTORIZUAR ZYRTAR NË DREJTORINË

Klasifikimi i vendeve të punës për nëpunësit e autorizuar zyrtar në Drejtori

Neni 87

(1) Për nëpunësit e autorizuar zyrtar në Drejtori, përcaktohen kategoritë vijuese të vendeve të punës:

- kategoria A – personat udhëheqës – zbulues financiar, dhe
- kategoria B – zbulues financiar.

(2) Në kuadër të kategorisë A, përcaktohen nivelet vijuese të vendeve të punës:

- niveli A1 – udhëheqës i sektorit – zbulues financiar,
- niveli A2 – ndihmësudhëheqës i sektorit – zbulues financiar, dhe
- niveli A3 – udhëheqës i seksionit – zbulues financiar.

(3) Në kuadër të kategorisë B, përcaktohen nivelet vijuese të vendeve të punës:

- niveli B1- zbulues financiar i pavarur,
- niveli B2 – zbulues financiar i lartë,
- niveli B3 – zbulues financiar dhe
- niveli B4 – zbuluesi financiar i ri.

Neni 88

(1) Për personat e autorizuar zyrtarë në Drejtori zbatohet ky ligj, Ligji mbi marrëdhëniet e punës, Ligji për punonjësit në sektorin publik dhe dispozitat në fushën e sigurimit shëndetësor, pensional dhe invalidor dhe marrëveshjet kolektive, përveç nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Punësimi i personave të autorizuar zyrtarë në Drejtori bëhet në pajtim me Ligjin për punonjësit në sektorin publik.

(3) Lëvizshmëria e personave të autorizuar zyrtarë në Drejtori bëhet në pajtim me Ligjin për punonjësit në sektorin publik.

Punësimi i zbuluesit financiar

Neni 89

(1) Në Drejtori si zbulues financiar mund të punësohet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme të parapara me këtë ligj dhe kushtet e veçanta të parapara me këtë ligj dhe aktin e sistematizimit të vendeve të punës në Drejtori.

(2) Për zbulues financiar mund të punësohet personi i cili plotëson kushtet e përgjithshme:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) është psikofizikisht i shëndetshëm (i aftë) për të kryer punët e parapara me aktin e sistematizimit;
- 3) të përdor në mënyrë aktive gjuhën maqedonase;
- 4) të jetë i moshës madhore;
- 5) me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos jetë shqiptuar dënim ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 6) me kontroll të sigurisë nga organi kompetent të jetë konstatuar se nuk ekziston rrezik për sigurinë e punësimit të personit.

(3) Përveç kushteve të përgjithshme nga paragrafi (2) i këtij neni, zbulues financiar mund të punësohet edhe personi që i plotëson kushtet e mëposhtme të veçanta:

1) kualifikimet profesionale për të gjitha nivelet e kategorisë A dhe B - niveli i kualifikimit VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të ketë së paku 180 kredi sipas EKTS ose 240 kredi sipas EKTS ose të ketë të përfunduar shkallën e arsimit VII/1.

2) të ketë përvojë pune në këtë profesion, si në vijim:

- për nivelin A1 - të paktën shtatë vjet përvojë pune në profesion, nga të cilat të paktën 3 vjet në pozicion udhëheqës në sektorin publik,

- për nivelin A2 - të paktën gjashtë vjet përvojë pune në profesion nga të cilat të paktën 1 vit në pozicion udhëheqës në sektorin publik,

- për nivelin A3 - të paktën pesë vjet përvojë pune në profesion, nga të cilat të paktën 1 vit punë në sektorin publik,

- për nivelin B1 – të paktën tre vjet përvojë pune në profesion;

- për nivelin B2 – të paktën dy vjet përvojë pune në profesion;

- për nivelin B3 – të paktën 1 vit përvojë pune në profesion dhe

- për nivelin B4 – me ose pa përvojë pune.

3) të ketë të kryer arsimim përkatës, të përcaktuar me aktin e sistematizimit të vendeve të punës në Drejtori;

4) të ketë njohje aktive të një prej tre gjuhëve më të përdorura (anglisht, frengjisht ose gjermanisht) dhe

5) njohja aktive e programeve kompjuterike të punës në zyrë.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës të zbuluesit financiar

Neni 90

(1) Zbuluesit financiar, marrëdhënia e punës i ndërpritet nëse:

a) e ka kërkuar vetë;

b) humbet përgjithmonë aftësinë shëndetësore për të kryer detyrat në drejtori si pasojë e sëmundjes ose zvogëlimit të aftësive fizike ose mendore;

c) konstatohet se gjatë punësimit ka heshtur ose ka dhënë të dhëna të rrejshme për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit në ditën e vendimit të formës së prerë ose me skadimin e afatit për shqyrtimin e ankesës kundër vendimit;

ç) i është shqiptuar masë disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës në ditën e dhënies së vendimit përfundimtar;

d) për shkak të vuajtjes së dënimit me burg duhet të mungojë nga puna më shumë se gjashtë muaj – nga dita e fillimit të vuajtjes së dënimit;

dh) i plotëson kushtet për daljen në pension në pajtim me ligjin, dhe

e) të vlerësohet me notën „ të pakënaqshme” tre herë radhazi ose të paktën tre herë në pesë vitet e fundit.

(2) Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës vendos ministri i financave.

Të drejtat dhe obligimet e zbuluesit financiar

Neni 91

(1) Zbuluesit financiar kanë për obligim që të:

a) të kryejnë detyrat e punës me ndërgjegje, në mënyrë profesionale, efikase, me rregull dhe në kohë, në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe dispozitat e tjera;

b) të zbatojnë urdhërat e udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe të veprojnë sipas tyre në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe dispozitat tjera;

c) të respektojnë orarin e caktuar të punës dhe

ç) të përdorin pajisjet që u janë dhënë për përdorim në kryerjen e detyrave të tyre me kujdesin e duhur dhe si një ekonom i mirë në pajtim me dedikimin e tyre dhe të mos i përdorin për qëllime private.

(2) Zbuluesi financiar, përveç obligimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, ka edhe obligimet vijuese:

a) të kryejë punën e tij në mënyrë të paanshme dhe pa ndikim nga partitë politike, të mos udhëhiqet nga bindjet e veta politike, interesat personale financiare, të mos shpërdorojë autorizimet dhe statusin e tij dhe të mbrojë reputacionin e Drejtorisë;

b) të përmirësojë profesionalisht njohuritë e tij për të përmirësuar kërkesat profesionale duke respektuar dhe zbatuar vazhdimisht dispozitat për kryerjen e detyrave të tij zyrtare;

c) të sillet konform Kodeksit të sjelljes së punonjësve në Drejtori;

ç) të respektojë të gjitha masat e sigurisë për të mos rrezikuar jetën dhe shëndetin e tij, si dhe jetën dhe shëndetin e punonjësve të tjerë të Drejtorisë, dhe

d) të mos përdorë privilegje dhe lirime, duke kërkuar ose marrë përfitime materiale ose përfitime tjera gjatë përbushjes së obligimeve të tij zyrtare.

(3) Zbuluesit financiar janë të detyruar që të menaxhojnë dhe ruajnë informatat e klasifikuara në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me informatat e klasifikuara.

(4) Zbuluesit financiar janë të detyruar të mbledhin, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat personale në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(5) Zbuluesit financiar për mospërbushje të obligimeve nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, kundërvajtëse dhe penale në pajtim me ligjin.

Neni 92

(1) Drejtoria planifikon, organizon dhe zbaton trajnime për punonjësit e saj.

(2) Me punëtorin i cili dërgohet në trajnim vlera e të cilit tejkalon dhjetë paga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë së Veriut në muajin e fundit para dërgimit, Drejtoria lidh marrëveshje me shkrim me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

(3) Punonjësi i cili nuk do t'i përbushë obligimet nga marrëveshja e lidhur nga paragrafi (2) i këtij neni, është i detyruar t'i kompensojë shpenzimet e bëra për trajnimin e tij të rritura për trefish.

Paga, sigurimi dhe kompensimet lidhur me zbuluesin financiar

Neni 93

(1) Zbuluesit financiar kanë të drejtë në pagë, shtesave në pagë dhe shtesave të tjera të paguara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Zbuluesi financiar, për shkak të specifikave të punëve që kryen, ka të drejtë në pagë të rritur për 30% nga baza e përcaktuar me aktin për pagesën e pagës dhe shtesave.

(3) Zbuluesi financiar në rast të paaftësisë së përkohshme për punë, të ndodhur gjatë kryerjes ose me rastin e kryerjes së punëve dhe detyrave, ka të drejtë në shtesë në shumën e pagës aktuale për periudhën e mungesës nga puna.

(4) Zbuluesi financiar, në pajtim me dispozitat për sigurimin pensional dhe invalidor, stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të shtuar, ashtu që kufiri i moshës për fitimin e të drejtës për pension pleqërie zvogëlohet varësisht nga shkalla e rritjes së stazhit edhe atë një vit për çdo katër vite të kaluara në punë gjegjësisht për punën efektive prej 12 muaj si stazh i sigurimit llogariten 15 muaj.

(5) Drejtoria i siguron zbuluesit financiar në rast të vdekjes, lëndimit trupor ose humbje të aftësisë gjatë realizimit të detyrave në kompetencën e tyre.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës së zbuluesit financiar për shkak të moshës së punonjësit

Neni 94

Drejtoria e ndërpret marrëdhënien e punës së zbuluesit financiar kur punonjësi mbush moshën 64 vjeç dhe 15 vjet stazh.

E drejta e kompensimit të njëfishtë në formë të pagës përcjellëse

Neni 95

Zbuluesi financiar i cili ka fituar të drejtën e pensionit ka të drejtë në kompensim të njëfishtë në formë të pagës përcjellëse, sipas marrëveshjes kolektive.

Neni 96

Në realizimin e autorizimeve të tyre, zbuluesit financiar kanë të drejta të veçanta të hyjnë dhe të kenë qasje të lirë në stacione, aeroporte, porte dhe parkingje publike vetëm duke paraqitur kartën e identifikimit zyrtar.

Neni 97

(1) Zbuluesi financiar, varësisht nga rezultatet e arritura të jashtëzakonshme dhe mbi mesatare gjatë punës, njohuritë dhe aftësitë profesionale, përkushtimi, kreativiteti dhe ndërgjegjja në kryerjen e detyrave zyrtare, me vendim të drejtorit mund të avancohet në pozitë më të lartë, me pëlqimin paraprak të ministrit të financave.

(2) Zbuluesi financiar mund të avancohet nëse i plotëson kushtet e mëposhtme:

- vendi i punës për të cilin avancohet është i lirë (i paplotësuar ose i zbrazur),
- në tërësi i përmbush kushtet e përcaktuara me aktin për sistematizimin e vendeve të punës për vendin e punës për të cilën bëhet avancimi,
- ka kryer trajnimet e përcaktuara për vendin e punës në të cilën avancohet,
- është vlerësuar me notat „dallohet” ose „kënaq” në mënyrë dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj,
- ka kaluar të paktën një vit nga avancimi i tij i fundit dhe
- në 12 muajt e fundit nuk është dënuar për shkelje të rendit dhe disiplinës së punës ose mospërmbushje të obligimeve të punës të përcaktuara me ligj.

Neni 98

(1) Zbuluesit financiar gjatë punës së tyre do të vlerësohen një herë në vit nga zbuluesi i drejtëpërdrejtë financiar udhëheqës. Në rast të mungesës së zbuluesit të drejtëpërdrejtë financiar udhëheqës, vlerësimi kryhet nga zbuluesi financiar udhëheqës më i lartë, në pajtim me aktin e sistematizimit. Në rast të mungesës së zbuluesit financiar udhëheqës më të lartë në pajtim me aktin e sistematizimit, vlerësimin e bën drejtori i Drejtorisë.

(2) Zbuluesit financiar të cilët kanë munguar me arsye nga puna për më shumë se gjashtë muaj gjatë vitit (pushim mjekësor, pushim pa pagesë etj.) nuk do të vlerësohen.

(3) Vlerësimi i zbuluesve financiar kryhet në bazë të të dhënave që lidhen me kriteret vijuese:

- njohuritë dhe aftësitë profesionale në punë,
- angazhimi,
- rezultatet e arritura,
- kreativiteti dhe
- ndërgjegjshmëria.

(4) Kriteret nga paragrafi (3) i këtij neni vlerësohen individualisht, të numeruara me notë nga një deri në katër dhe në mënyrë përshkruese me notat: “dallohët”, “kënaq”, “pjesërisht kënaq” dhe “nuk kënaq”.

(5) Zbuluesi financiar i cili nuk është i kënaqur me vlerësimin, në afat prej tetë ditësh nga dita e vlerësimit mund të parashtrij kërkesë për rishqyrtimin e vlerësimit deri te Komisioni për rishqyrtimin e vlerësimit të formuar nga drejtori.

(6) Zbuluesi financiar i cili nuk pajtohet me vendimin e Komisionit për rishqyrtimin e vlerësimit, në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit ka të drejtë të parashtrij ankesë përmes Drejtorisë deri te Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune.

(7) Mënyrën e vlerësimit të punës së zbuluesve financiar, llojet e raporteve, formën dhe përmbajtjen e formularit të vlerësimit dhe formularëve të tjerë, me propozim të drejtorit i përcakton ministri i financave.

Neni 99

(1) Kodeksi i sjelljes përshkruan standardet e sjelljes që duhen respektuar nga të gjithë punonjësit dhe parasheh instruksione dhe udhëzime për zgjidhjen e çështjeve etike për ata që punojnë në Drejtori dhe ata që bashkëpunojnë dhe punojnë me punonjësit e Drejtorisë.

(2) Kodeksin e sjelljes e përshkruan ministri i financave me propozim të drejtorit.

Neni 100

(1) Për shkelje të rendit dhe disiplinës së punës ose mospërmbushje të detyrimeve të punës, zbuluesi financiar përgjigjet në mënyrë disiplinore.

(2) Përgjegjësia për vepër penale të kryer nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të zbuluesit financiar.

Neni 101

(1) Zbuluesi financiar përgjigjet në mënyrë disiplinore për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore.

(2) Parregullsia disiplinore, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, është shkelje më e lehtë e disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe të punonjësve.

(3) Shkelja disiplinore, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, është shkelje më e rëndë e disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe të punonjësve.

Neni 102

(1) Zbuluesi financiar bën parregullsi disiplinore, përkatësisht shkelje më të lehtë të disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe të punonjësve, kur:

1) nuk respekton rendin dhe disiplinën e punës;

2) nuk i kryen ose i neglizhon dhe nuk i zbaton në kohë obligimet e punës;

3) nuk u përmbahet dispozitave që vlejné për kryerjen e punëve në vendin e punës;

4) nuk i përmbahet orarit të caktuar të punës si dhe shfrytëzimit të orarit të punës;

5) nuk ka bërë kërkesë për pushim ose nuk e ka njoftuar me kohë drejtorin në formë të shkruar, përkatësisht udhëheqësin e drejtpërdrejtë ose punonjësin tjetër përgjegjës për mungesën nga puna;

6) mungon në punë për shkak të sëmundjes ose shkaqeve tjera të arsyeshme dhe nuk e njofton drejtorin, përkatësisht udhëheqësin e drejtpërdrejtë ose punonjësin tjetër përgjegjës, menjëherë ose më së voni brenda 24 orëve;

7) nuk vepron me ndërgjegje me mjetet e punës ose në pajtim me udhëzimet teknike për punë;

8) nëse është shkaktuar dëm, gabim gjatë punës ose humbje, e për këtë nuk njoftohet menjëherë drejtori, përkatësisht udhëheqësi i njësisë organizative ose punonjësi tjetër përgjegjës;

9) nuk i mirëmban mjetet dhe pajisjet për mbrojtje në punë në pajtim me dispozitat për mbrojtje në punë;

10) shkakton rrëmujë dhe sillet dhunshëm gjatë orarit të punës;

11) shfrytëzon në mënyrë të paligjshme ose të paautorizuar mjetet e Drejtorisë, dhe

12) shmang trajnimin.

Neni 103

Zbuluesi financiar kryen shkelje disiplinore, përkatësisht shkelje më të rëndë të disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe të punonjësve, nëse:

1) mungon pa arsye nga puna për tri ditë pune radhazi ose pesë ditë pune gjatë vitit;

2) keqpërdor pushimin mjekësor;

3) nuk i respekton dispozitat për mbrojtjen e shëndetit, mbrojtjen në punë, mbrotje ndaj zjarrit, shpërthimit, veprimi i dëmshëm i shkaktuar nga helmet dhe substancave tjera të rrezikshme dhe i shkel dispozitat për mbrojtjen e mjedisit jetësor;

4) fut, përdor ose është nën ndikimin e alkoolit dhe mjeteve narkotike;

5) kryen vjedhje ose në lidhje me punën me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme i shkakton dëme Drejtorisë;

6) nuk u përmbahet dispozitave të Ligjit i Informatave të Klasifikuara;

7) keqpërdor të dhënat personale;

8) keqpërdor ose tejkalon obligimet dhe autorizimet ligjore;

9) shmang kontrollin mjekësor për përcaktimin e aftësisë për punë;

10) në mënyrë joligjore përfiton dobi personale në lidhje me kryerjen e punëve dhe detyrave;

11) kryen një shërbim ose i mundëson një shërbim personit tjetër me para ose sende tjera me vlerë që i janë besuar zbuluesit financiar në kryerjen e punëve dhe detyrave dhe

12) themelon, udhëheq, përfaqëson një parti politike, është anëtar i organeve partiake të përcaktuara me statutin e saj, shpreh dhe përfaqëson pikëpamjet dhe bindjet partiake në kryerjen e punëve dhe detyrave, mban ose ekspozon simbolet partiake në hapësirat ose automjetet zyrtare të Drejtorisë, si dhe organizohet dhe vepron në mënyrë partiake në Drejtori.

Neni 104

(1) Në rast të parregullsisë disiplinore, zbuluesi financiar mundet me aktvendim të shqiptohet njëra nga masat disiplinore vijuese:

1) paralajmërim me shkrim ose

2) gjobë në lartësi prej 15% të pagës neto që i është paguar në muajin e fundit zbuluesit financiar, për një periudhë prej një deri në tre muaj.

(2) Në rast të shkeljes disiplinore, zbuluesit financiar me aktvendim mund t'i shqiptohet një nga masat disiplinore të mëposhtme:

1) gjobë në lartësi prej 15% të pagës neto që i është paguar në muajin e fundit zbuluesit financiar, për një periudhë prej tre deri në gjashtë muaj;

2) caktimi në vendin e punës i cili në pajtim me hierarkinë e vendeve të punës të përcaktuara në aktin e sistematizimit të vendeve të punës në drejtori është një shkallë më i ulët se vendi i punës nga i cili ka qenë i caktuar zbuluesi financiar, ose

3) ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

(3) Me rastin e shqiptimit të masave disiplinore nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, merren parasysh shkalla e përgjegjësisë, kushtet nën të cilat është bërë shkelje e disiplinës e punës, detyrave të punës, reputacioni i Drejtorisë dhe i punonjësve, puna e mëparshme dhe sjellja e punonjësit, shkalla e dëmtimit dhe pasojat e tij, rrethanat nën të cilat është kryer shkelja dhe rrethanat e tjera lehtësuese dhe vështirësuese.

Neni 105

Shuma e gjobave të shqiptuara të zbuluesit financiar në një muaj për shkelje të disiplinës së punës, detyrave të punës, reputacionit të Drejtorisë dhe punonjësve nuk mund të tejkaloj 20% të shumës së pagës totale neto për atë muaj.

Neni 106

(1) Masat disiplinore ndaj zbuluesit financiar për parregullsi disiplinore shqiptohen me propozimin e zbuluesit financiar udhëheqës të drejtpërdrejtë, zbuluesit financiar udhëheqës më të lartë ose zbuluesit financiar udhëheqës i të njëjtit nivel, të cilat njëkohësisht i dorëzohen drejtorit dhe zbuluesit financiar ndaj të cilit është ngritur propozimi.

(2) Zbuluesi financiar ndaj të cilit është ngritur propozimi, ka të drejtë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimi të propozimit nga paragrafi (1) i këtij neni të deklarohet lidhur me propozimin, përkatësisht të jep përgjigje në formë të shkruar.

(3) Masat disiplinore ndaj zbuluesit financiar për parregullsi disiplinore i shqipton drejtori në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së përgjigjes me shkrim nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Kundër vendimit nga paragrafi (3) i këtij neni, zbuluesi financiar i pakënaqur ka të drejtë të parashtoj ankesë deri te Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune në afat prej tetë ditësh nga pranimi i vendimit.

Neni 107

Propozim për fillimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të zbuluesit financiar për shkelje disiplinore mund të parashtoj zbuluesi financiar udhëheqës i drejtpërdrejtë, zbuluesi financiar udhëheqës më i lartë ose zbuluesi financiar udhëheqës në të njëjtin nivel. Propozimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i mbështetur me fakte dhe dëshmi.

Neni 108

(1) Drejtori në afat prej tetë ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit për ngritje të procedurës disiplinore formon komision i cili do të përcaktojë përgjegjësinë disiplinore të zbuluesit financiar për shkelje disiplinore në rastet e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhet nga zbuluesit financiar, duke përfshirë një kryetar nga radhët e zbuluesve financiarë udhëheqës dhe dy anëtarë, njëri prej të cilëve, nëse është e mundur, të jetë zbulues financiar me të njëjtin nivel si zbuluesi financiar ndaj të cilit udhëhiqet procedurë disiplinore. Kryetari dhe anëtarët kanë zëvendësit e tyre.

(3) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore e udhëheq në pajtim me këtë ligj.

(4) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, pas zbatimit të procedurës disiplinore, nëse konstaton se zbuluesi financiar është përgjegjës, i propozon drejtorit që të shqiptojë masën e duhur disiplinore.

(5) Nëse komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni konstaton se zbuluesi financiar nuk është përgjegjës, do t'i propozojë drejtorit që ta hudhë poshtë propozimin ose ta ndërpresë procedurën.

(6) Drejtori, në bazë të propozimit të komisionit, merr vendim për shqiptimin e masës disiplinore, hedhjen poshtë të propozimit ose ndërprerjen e procedurës në afat prej tri ditësh nga pranimi i propozimit nga paragrafi (5) i këtij neni. Aktvendimi për shqiptimin e masës disiplinore përmban edhe arsyetimin kryesor dhe shkaqet për shqiptimin e masës disiplinore.

(7) Aktvendimi për shqiptimin e masës disiplinore i dorëzohet personalisht zbuluesit financiar, fillimisht në hapësirat e punës së Drejtorisë gjegjësisht në adresën e vendbanimit, përkatësisht adresën e vendqëndrimit.

(8) Nëse zbuluesi financiar refuzon të pranoj aktvendimin, i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve në Drejtori. Pas kalimit të tre ditëve të punës nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve, dorëzimi konsiderohet i kryer.

(9) Kundër aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore ose hudhjen poshtë të propozimit, përkatësisht për ndërprerjen e procedurës, zbuluesi financiar ka të drejtë ankese përmes Drejtorisë të Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune, brenda tetë ditëve nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(10) Ankesa e pezullon ekzekutimin e aktvendimit deri në marrjen e vendimit të formës së prerë ose deri në afatin në të cilin duhet të vendosë Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune. Drejtoria është e obliguar që ankesën, me dokumentet shoqëruese, t'ia dorëzojë Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i ankesës.

(11) Procedura disiplinore përfundon në afat prej 60 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit për formimin e komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 109

(1) Deri në marrjen e aktvendimit në procedurë disiplinore që udhëhiqet ndaj zbuluesit financiar, zbuluesi financiar largohet nga puna me vendim me shkrim - aktvendim nga Drejtoria në rastet e përcaktuara me dispozitat e marrëdhënieve të punës, nëse ndodh një nga situatat në vijim:

-rrezikohet drejtpërdrejt jeta ose shëndeti i punonjësve ose personave të tjerë ose dëmtohen mjete me vlerë më të madhe,

-prania në vendin e punës dhe puna e mëtutjeshme do të ketë efekt të dëmshëm në punën e Drejtorisë, dhe

-kur ndaj zbuluesit financiar është ngritur procedurë penale për vepër penale të kryer në punë ose në lidhje me punën.

(2) Me rastin e largimit nga puna dhe nga Drejtoria, zbuluesit financiarë i caktohet dhe i paguhet kompensim në shumë prej 60% të shumës së pagës neto që zbuluesi financiar e ka realizuar në muajin para datës së largimit nga puna.

(3) Aktvendimin nga paragrafi (1) të këtij neni, e sjell drejtori.

(4) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzohet personalisht zbuluesit financiar, fillimisht, në hapësirat e punës së Drejtorisë, gjegjësisht në adresën e vendbanimit, përkatësisht të vendqëndrimit.

(5) Nëse zbuluesi financiar refuzon të pranoj aktvendimin, i njëjti publikohet në tabelën e shpalljeve në Drejtori. Pas kalimit të tre ditëve të punës nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve, dorëzimi konsiderohet i kryer.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, zbuluesi financiar ka të drejtë ankese deri te Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune, në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(7) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e prolongon ekzekutimin e aktvendimit.

(8) Në rast të kthimit në punë dhe nëse nuk konstatohet ekzistimi i përgjegjësisë disiplinore, zbuluesi financiar ka të drejtë në kompensim retroaktiv në shumë prej 100% të pagës neto.

Neni 110

Nëse zbuluesit financiar për shkak të shkeljes disiplinore i shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, zbuluesi financiar ka të drejtë të dorëhiqet në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Neni 111

Gjatë periudhës së afatit të dorëheqjes, Drejtoria është e detyruar zbuluesit financiar t'i mundësojë mungesë nga puna për të kërkuar punë të re, për gjashtë orë gjatë javës së punës.

Neni 112

Gjatë periudhës së afatit të dorëheqjes dhe mungesës nga puna për shkak të kërkimit të punësimit të ri, zbuluesit financiar i përcaktohet dhe i paguhet kompensimi në lartësinë e pagës që zbuluesi financiar e ka realizuar në muajin para sjelljes së aktvendimit për ndërprerjen e marrëveshjes së punës.

Neni 113

(1) Procedura disiplinore kundër zbuluesit financiar nuk mund të inicohet nëse ka kaluar një muaj nga dita kur zbuluesi financiar udhëheqës i drejtpërdrejtë ose më i lartë ose drejtori kanë kuptuar për shkeljen disiplinore të kryer.

(2) Procedura disiplinore ndaj zbuluesit financiar nuk mund të ngritet nëse kanë kaluar tre muaj nga dita e kryerjes së shkeljes disiplinore.

(3) Kur për shkeljen e kryer disiplinore është iniciuar procedurë penale për zbuluesin financiar, aktvendimi për shqiptimin e masës disiplinore do të merret më së voni deri në kalimin e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale të veprës përkatëse penale.

Neni 114

(1) Zbuluesi financiar është përgjegjës për dëmin të cilin në punë ose në lidhje me punën, me dashje ose nga pakujdesia e skajshme, ia ka shkaktuar Drejtorisë.

(2) Drejtori formon komision për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të zbuluesit financiar të përbërë nga zbulues financiarë të punësuar në Drejtori edhe atë kryetar nga radhët e zbuluesve financiar udhëheqës dhe dy anëtarë, njëri prej të cilëve, nëse është e mundur, të jetë zbulues financiar në të njëjtin nivel si zbuluesi financiar ndaj të cilit udhëhiqet procedura disiplinore. Kryetari dhe anëtarët kanë zëvendësit e tyre.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni përcakton përgjegjësinë materiale për ekzistimin e dëmit të shkaktuar material, lartësinë e tij dhe mënyrën e kryerjes së tij, kush e ka shkaktuar dëmin dhe kush do ta kompensojë atë.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni për gjendjen e vërtetuar faktike dorëzon raport në bazë të të cilit drejtori merr vendim për kompensimin e dëmit.

Neni 115

Propozim për fillimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë materiale kundër zbuluesit financiar parashtron zbuluesi financiar udhëheqës i drejtpërdrejtë, zbuluesi financiar udhëheqës më i lartë ose zbuluesi financiar udhëheqës në të njëjtin nivel.

Neni 116

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë material nuk mund të inicohet nëse kanë kaluar 60 ditë nga dita kur zbuluesi financiar udhëheqës i drejtpërdrejtë ose zbuluesi financiar udhëheqës më i lartë e ka kuptuar këtë.

Neni 117

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të inicohet, nëse nga dita kur është shkaktuar dëmi material ka kaluar një vit.

Neni 118

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale nuk mund të zhvillohet më shumë se 60 ditë, llogaritur nga dita e miratimit së aktvendimit për themelimin e komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të zbuluesit financiar.

Neni 119

(1) Kundër aktvendimit për kompensimin e dëmit, zbuluesi financiar ka të drejtë ankese deri te Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune përmes Drejtorisë, në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

(2) Ankesa e pezullon ekzekutimin e aktvendimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar ose nëse ka skaduar afati brenda të cilit është dashur të vendosë Komisioni shtetëror i shkallës së dytë për vendimmarrje në procedurë administrative dhe në procedurë për marrëdhënie pune.

Neni 120

Procedura për përcaktimin e përgjegjësisë materiale të zbuluesit financiar rregullohet me vendim të cilin e sjell drejtori.

Neni 121

Nëse zbuluesi financiar në afat prej tre muajsh pas plotfuqishmërisë së aktvendimit për kompensim të dëmit nuk e kompenson dëmin, Drejtoria ngrit procedurë në gjykatën kompetente.

Neni 122

Drejtori mund ta lirojë zbuluesin financiar tërësisht ose pjesërisht nga kompensimi i dëmit, nëse ai nuk është bërë me dashje ose nëse pagesa e dëmit rrezikon ekzistencën e zbuluesit financiar dhe familjes së tij.

Neni 123

(1) Për punën profesionale afatgjatë, avancimet organizative, suksesin në realizimin e detyrave të punës, përmirësimin e reputacionit të shërbimit, zbuluesve financiarë u ndahen mirënjohje.

(2) Zbuluesit financiarë mund të marrin edhe shpërblim të njëfishtë në para për arritjen e rezultateve të jashtëzakonshme dhe mbi mesatare në punë.

Neni 124

(1) Mirënjohjet dhe shpërblimet nga neni 123 të këtij ligji, sipas rregullave, ndahen në ditën e Drejtorisë.

(2) Për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve në para vendos ministri i financave me propozim të drejtorit.

(3) Dita e Drejtorisë është më 1 mars.

Analiza dhe përpunimi i të dhënave, informatave dhe dokumenteve

Neni 125

Drejtoria është kompetente të mbledhë dhe të analizojë, duke u bazuar në llojet e mëposhtme të të dhënave, informatave dhe dokumenteve:

1. në rast të dyshimit për pastrim parash dhe financim të terrorizmit të dorëzuara nga subjektet në bazë të nenit 65 të këtij ligji;

2. të dorëzuara nga subjektet në bazë të neneve 63 dhe 64 të këtij ligji;

3. në iniciativën e organeve kompetente në pajtim me nenin 130 të këtij ligji;

4. të dorëzuar nga Drejtoria doganore në bazë të nenit 141 të këtij ligji;
5. të dorëzuara në bazë të nenit 156 të këtij ligji dhe
6. të pranuar nga njësitë e inteligjencës financiare të shteteve të tjera.

Neni 126

Të dhënat, informatat dhe dokumentet të cilat i mbledh Drejtoria në pajtim me këtë ligj i analizon në kuadër të:

- a) analizës operative në lidhje me personat, transaksionet, aktivitetet dhe pasurinë lidhur me të dhënat, informatat dhe dokumentet që disponon Drejtoria në pajtim me këtë ligj, dhe
- b) analizës strategjike në lidhje me përcaktimin e trendeve dhe tipologjive për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

Neni 127

(1) Të dhënat, informatat dhe dokumentet që i mbledh, analizon, përpunon dhe dorëzon Drejtoria në pajtim me këtë ligj janë të klasifikuara e për të cilat është përcaktuar shkalla përkatëse e klasifikimit në pajtim me dispozitat për të dhënat e klasifikuara.

(2) Të dhënat, informatat dhe dokumentet që i mbledh, analizon, përpunon dhe dorëzon Drejtoria, shfrytëzohen në pajtim me këtë ligj.

Kërkimi i të dhënave, informatave dhe dokumenteve nga ana e Drejtorisë

Neni 128

(1) Për zbatimin e kompetencave të veta, Drejtoria mund të kërkojë të dhëna, informata dhe dokumente nga organet shtetërore, subjektet ose persona të tjerë juridik ose fizik në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Organet shtetërore, subjektet ose personat e tjerë juridik ose fizik janë të detyruar që në afat prej dhjetë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia dorëzojnë Drejtorisë të dhënat e kërkuara përmes kanalit të mbrojtur elektronik. Nëse kjo metodë e dorëzimit pamundësohet për arsye teknike, të dhënat e kërkuara dorëzohen në formë të shkruar ose nëpërmjet Platformës nacionale të interoperabilitetit.

(3) Nëse Drejtoria kërkon urgjentisht të dhëna, organet shtetërore, subjektet ose personat e tjerë juridik ose fizik janë të detyruar që më së voni në afat prej katër orësh të dhënat e kërkuara t'i dorëzojnë përmes kanalit të mbrojtur elektronik ose përmes Platformës nacionale të interoperabilitetit. Nëse kjo mënyrë e dorëzimit pamundësohet për arsye teknike, të dhënat e kërkuara dorëzohen në formë të shkruar.

Qasja elektronike në të dhënat, informatat dhe dokumentet nga ana e Drejtorisë

Neni 129

(1) Për realizimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, Drejtorisë i sigurohet qasja elektronike dhe e drejta e përdorimit të të dhënave nga bazat e të dhënave, pa kompensim edhe atë nga:

1) Ministria e punëve të brendshme të dhëna për: emrin personal; emrin e prindërve; mbiemrin e vajzërisë (ose mbiemrin para lidhjes martesore); datën e lindjes; NVAQ; nënshtetësinë; gjininë; vendin dhe shtetin e lindjes; komunën; adresën e vendbanimit (vendi, komuna, rruga, numri dhe shteti); numrin e letërnjoftimit; organin që ka lëshuar letërnjoftimin; kombësinë; nënshtetësinë e mëparshme, gjegjësisht shtetësinë që ka fituar; numrin e pasaportës; nëse është raportuar largimi jashtë vendit; nëse është raportuar për dokument udhëtimi të zhdukur, të humbur dhe të pasaktë; për të huajtë (NVAQ, letërnjoftimi); hyrja dhe dalja nga shteti; anëtarë të amvisërisë familjare; evidenca penale; posedimi të armëve koleccionuese; pronësi të mjeteve motorike dhe mjeteve lundruese etj.

2) Ministria e drejtësisë të dhëna për rastet e korrupsionit dhe pastrimit të parave, nga sistemi i menaxhimit elektronik të lëndëve lidhur me ndihmën juridike ndërkombëtare.

3) Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor të dhëna për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) të siguruar në pajtim me dispozitat për sigurimin pensional dhe invalidor dhe statusin, për vitet e stazhit të punës, pensionist (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe statusin e pensionistit.

4) Fondi i sigurimit shëndetësor të dhëna për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) të siguruar në pajtim me dispozitat për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;

5) Drejtoria e të ardhurave publike të dhëna për: personin juridik (NVAQ dhe NVT) ose personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) nga regjistri tatimor; të dhënat nga fletëparaqitjet tatimore; TVSH-në e paguar, mbledhur dhe rimbursuar, kontrole tatimore të kryera, tatimpaguesit që kryejnë pagesa me para të gatshme dhe kontabilistë të çertifikuar (person juridik (NVAS dhe NVT) ose person fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ)) të personave juridikë.

6) Agjencia e punësimit të dhënat për: personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) të përfshira në formularin (historik) M1/M2, listën e personave fizikë (emri, mbiemri dhe NVAQ) të punësuar në një person të caktuar juridik (NVAS dhe NVT) etj.

7) Agjencia për kadastrën e pasurive të patundshme të dhënat për: personin fizik (emër, mbiemër dhe NVAQ) dhe person juridik (NUAS dhe NUT) për pronësinë, listën pronësore, për historijatin e pronësisë së pronës, për njësinë hapësinore, të dhënat e çmimeve dhe qirave etj.

8) Depozituesi qendror i letrave me vlerë të dhëna për: personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personin juridik (NUAS dhe NUT) për pronësinë e letrave me vlerë, për barazimin e transaksioneve tregtare, për transferimin jotregtar të letrave me vlerë, letrave me vlerë të huazuara etj.

9) Të dhënat nga regjistri i vetëm i llogarive të transaksioneve - Shtëpia e kliringut „KIBS” SHA Shkup për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personin juridik (NVAS dhe NVT) posedues të llogarive aktive transaksionale në denarë.

10) Të dhënat nga byroja kreditore për ekspozimin kreditor të personit fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personit juridik (NVAS dhe NVT) nga portali MOJ.MKB.MK.

11) Regjistri qendror për të dhënat lidhur me personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe për personin juridik (NVAS dhe NVT) që figurojnë në:

- regjistrin tregtar dhe regjistrin e personave të tjerë juridikë,
- regjistrin e llogarive vjetore,
- regjistrin e pengut,
- regjistrin e lizingut,
- regjistrin e investimeve në pasuri të patundshme,
- regjistrin e të drejtave të pasurive të patundshme,
- regjistrin e investimeve direkte të rezidentëve jashtë vendit,
- regjistrin e investimeve direkte të jorezidentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- regjistrin e personave fizik dhe juridik të cilëve u është shqiptuar masa e sanksionimit ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshëm për realizim të veprimtarisë së caktuar,
- regjistrin e gjobave dytësore për vepra penale të kryera nga personat juridik,
- regjistrin për sigurimin lidhur me bartjen e pronësisë së sendeve dhe bartja e të drejtave (regjistri fiduciar),
- regjistrin për shitjen e sendeve të tundshme me ruajtjen e së drejtës mbi pronësinë,
- regjistrin e pronarëve të vërtetë dhe
- regjistrin unik të llogarive.

12) Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut të dhënat për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personin juridik (NVAS dhe NVT) nga evidencat e mëposhtme:

- për deklaratat doganore të personit fizik,
- për deklaratat doganore të personit juridik,

- për import të kryer dhe për eksport të kryer,
- të obligacioneve të akcizës,
- për dokumentin unik doganor,
- për hyrjen dhe daljen e parave dhe letrave me vlerë të huaja,
- për ngritjen e kallëzimeve penale dhe procedurave kundërvajtëse.

13) Drejtoria e Policisë Financiare të dhënat për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personin juridik (NVAS dhe NVT) për kallëzimet e ngritura penale.

14) Gjykatat për të dhënat lidhur me personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personin juridik (NVAS dhe NVT) nga:

- evidencë për procedurat penale të ngritura kundër personit të caktuar,
- aktgjykimet e mara,
- evidencë ndëshkuese,
- evidencë për shqiptim të masës ndalim të kryerjes së veprimtarisë ndaj personit të caktuar,
- evidencë për marrjen ose kufizimin e aftësisë afariste të personave,
- evidencë për bashkëpunimin e realizuar ndërkombëtar.

15) Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale të dhëna për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) shfrytëzues i ndihmës sociale.

16) Enti shtetëror i auditimit të dhëna për personin juridik (NVAS dhe NVT) për auditimet e realizuara dhe të dhëna tjera nga sistemi elektronik për menaxhim me auditimet.

17) Bursa për letra me vlerë e Maqedonisë të dhëna për personin juridik (NVAS dhe NVT) të përfshira në MB NET, për transaksionet e lidhura, përfshirë edhe bllok transaksionet etj.

18) Prokuroria publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut të dhëna për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personin juridik (NVAS dhe NVT) për kallëzimet penale të pranuar, akuzat e ngritura, masat e shqiptuara lidhur me sigurimin e pronës gjatë procedurës, bashkëpunimin e realizuar ndërmjet prokurorive në nivel ndërkombëtar etj.

19) Ministria e ekonomisë të dhëna për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) dhe personin juridik (NVAS dhe NVT) që kanë lidhur marrëveshje për koncesione.

20) Enti Shtetëror i Statistikës të dhënat statistikore sipas fushave, statistikave të përgjithshme dhe rajonale, statistikave të popullsisë dhe ato sociale, të hyrat, konsumi dhe çmimet, ekonomia dhe financat, industria, ndërtimtaria dhe energjia, tregtia e jashtme, transporti, turizmi, tregtia dhe shërbimet e tjera dhe statistikave tjera shumëdimensionale.

21) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Administratës të dhënat për personin fizik (emri, mbiemri dhe NVAQ) nga Regjistri Qendror i Popullsisë.

(2) Qasja dhe mënyra e përdorimit të të dhënave nga bazat e të dhënave të organeve të lartpërmendura në paragrafin (1) të këtij neni është përcaktuar me ligjin i cili rregullon menaxhimin dhe shërbimet elektronike dhe kjo qasje rregullohet përmes memorandumeve për bashkëpunim të lidhura ndërmjet Drejtorisë dhe organit kompetent nga paragrafi (1) i këtij neni.

Dorëzimi i iniciativës te Drejtoria

Neni 130

(1) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave - Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Financave - Drejtoria Doganore, Agjencia e Zbulimit, Ministria e Mbrojtjes – Sektori – Shërbimi i Sigurisë Ushtarake dhe e Zbulimit, Agjencia e Sigurisë Kombëtare dhe Komisioni Shtetëror i Parandalimit të Korrupsionit, mund të dorëzojnë iniciativë te Drejtoria, nëse ka arsye për dyshim lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

(2) Iniciativa për kryerjen e analizës në formë të shkruar nga paragrafi (1) i këtij neni dhe e dorëzuar në mënyrë të sigurt duhet të përmbaj:

1. të dhëna për personin me të cilin ka të bëjë iniciativa edhe atë për:

- personin fizik emri, mbiemri, data e lindjes, numri i dokumentit të identifikimit, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, NVAQ dhe

- personin juridik, emërtimi, selia, NVAS, NVT dhe të dhëna të tjera.

2. shkaqet për dyshimin lidhur me pastrimin e parave dhe / ose financimin e terrorizmit, si dhe të dhënat mbi llojin dhe mënyrën e veprës së kryer penale të mëparshme, e të cilat janë përcaktuar gjatë ushtrimit të kompetencave.

(3) Kur iniciativa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është e arsyetuar dhe nuk i përmban të dhënat nga paragrafi (2) i këtij neni, Drejtoria duhet t'ia kthejë të njëjtën për plotësim organit që e ka parashtruar atë.

(4) Nëse brenda 10 ditësh, iniciativa nga paragrafi (1) i këtij neni nuk plotësohet në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, Drejtoria me shkrim e njofton organin që e ka parashtruar të njëjtën se nuk mund të veprojë për iniciativën ashtu të dorëzuar.

(5) Kur Drejtoria vepron sipas iniciativës nga paragrafi (1) i këtij neni dhe konstaton se ekzistojnë baza të dyshimit për kryerjen e veprës penale pastrim i parave dhe/ose financim i terrorizmit ose vepër tjetër penale, Drejtoria vepron në pajtim me nenin 131 të këtij ligji.

(6) Drejtoria e informon organin nga paragrafi (1) të këtij neni për epilogun e shqyrtimit të iniciativës.

(7) Për qëllime të luftës kundër pastrimit të parave, veprave penale të ngjashme dhe financimit të terrorizmit, Drejtoria mund të shkëmbejë të dhënat e disponueshme në bazat e saj të dhënave me organet nga paragrafi (1) i këtij neni me kërkesën e tyre të arsyetuar me shkrim ose me vetiniciativë.

Dorëzimi i të dhënave te organet kompetente

Neni 131

(1) Çdoherë kur ekzistojnë baza për dyshime për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit, Drejtoria përgatit dhe dorëzon raport në Prokurorinë publike themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

(2) Nëse arsyet e dyshimit për kryerjen e veprës penale të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit bazohen në iniciativën e mëparshme të organeve kompetente nga neni 130 të këtij ligji, Drejtoria përgatit dhe i dorëzon një raport Prokurorisë publike themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe organit kompetent i cili e ka parashtruar iniciativën nga neni 130 të këtij ligji.

(3) Raporti nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni përmban të dhëna, informata dhe dokumente për personin dhe aktivitetet që dyshohet se kanë lidhje me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

(4) Kur ekzistojnë baza për dyshim lidhur me kryerjen e një vepre tjetër penale krahas pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Drejtoria përgatit njoftim dhe të njëjtin ua dërgon organeve kompetente shtetërore.

(5) Organet kompetente nga paragrafët (1) dhe (2) për raportin nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dhe njoftimin nga paragrafi (4) i këtij neni të pranuar nga Drejtoria, obligohen në mënyrë elektronike dhe në afatet e caktuara, së paku në gjashtë muaj ta informojnë Drejtorinë për rezultatin dhe epilogun e tyre.

Urdhër për ndjekje të marrëdhënies afariste

Neni 132

(1) Kur ekziston dyshimi për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit, Drejtoria mund t'i dërgojë subjektit urdhër me shkrim për ndjekjen e marrëdhënies afariste me klientin.

(2) Për transaksionet që kryhen ose duhet të kryhen në kuadër të marrëdhënieve afariste, subjekti e informon Drejtorinë në pajtim me udhëzimet e dhëna në vetë urdhërin.

(3) Përmes urdhërit nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria përcakton afatet në të cilat subjekti është i detyruar të dorëzojë të dhënat për transaksionet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Nëse subjekti për shkak të rrethanave objektive nuk mund ta njoftojë Drejtori në afatet nga paragrafi (3) i këtij neni, është i detyruar që menjëherë pas tejkalimit të rrethanave ta njoftojë Drejtorinë dhe të arsyetoj shkakun se pse nuk e ka dorëzuar njoftimin në afatin e caktuar.

(5) Ndjekja e marrëdhënies afariste nga paragrafi (1) i këtij neni mund të zgjasë më së shumti tre muaj, ndërsa në raste të arsyeshme kohëzgjatja e masës mund të vazhdohet për një muaj, me kusht që ndjekja e marrëdhënies afariste mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, për qëllime të parandalimit të financimit të terrorizmit, kohëzgjatja e masës mund të vazhdohet për aq kohë sa është e nevojshme, varësisht nga qëllimi për të cilin zbatohet masa.

Masat e përkohshme

Neni 133

(1) Kur ekziston dyshimi për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit, Drejtoria mund t'i dorëzoj subjektit urdhër me shkrim për pezullim të përkohshëm dhe/ose ndalim për realizimin e transaksioneve ose ngrirje të përkohshme të pronës.

(2) Pezullimi dhe/ose ndalimi për realizimin e transaksioneve ose ngrirja e përkohshme e pronës zgjat deri në sjelljen e aktvendimit gjyqësor lidhur me propozimin dhe jo më gjatë se 72 orë nga dorëzimi i urdhërit me shkrim për pezullim të përkohshëm dhe/ose ndalim të realizimit të transaksioneve.

(3) Nëse afati nga paragrafi (2) i këtij neni përfshin ditë të diela, festa ose ditë të tjera jopune, pezullimi i përkohshëm dhe/ose ndalimi i realizimit të transaksioneve ose ngrirja e përkohshme e pronës zgjat maksimum deri në 120 orë nga lëshimi i urdhërit.

(4) Kur për shkak të natyrës ose mënyrës së realizimit të transaksioneve të dyshimta, gjegjësisht rrethanave që ndjekin transaksionin e dyshimtë, nuk është e mundur që subjektit t'i lëshohet urdhër me shkrim, si dhe në raste tjera urgjente, Drejtoria mund të lëshojë subjektit urdhër verbal për pezullim të përkohshëm dhe/ose ndalim të realizimit të transaksioneve ose ngrirjes së përkohshme të pronës.

(5) Urdhërin verbal nga paragrafi (4) të këtij neni Drejtoria duhet ta konfirmojë me urdhër me shkrim jo më vonë se dita e parë e ardhshme e punës pas lëshimit të urdhërit verbal.

(6) Personi i autorizuar është i detyruar që për urdhërin verbal të pranuar nga paragrafi (5) i këtij neni të përpilojë procesverbal të cilin e ruan në evidencat e tij në pajtim me nenin 62 të këtij ligji.

Neni 134

(1) Drejtoria, pas dorëzimit të urdhërit nga neni 133 të këtij ligji, prokurorit publik kompetent i dorëzon kërkesë për ngritjen e propozimit për caktimin e masave të përkohshme.

(2) Kërkesa për ngritjen e propozimit për caktimin e masave të përkohshme nga ky ligj, përmban të dhëna për faktet dhe rrethanat që arsyetojnë nevojën e zbatimit të masës së përkohshme, të dhëna për personin fizik (numrin unik amë ose numër tjetër identifikimi të personit, emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë dhe nënshtetësinë) ose të dhëna për personin juridik për të cilin kërkohet zbatimi i masës së përkohshme, numrin e transaksionit/ve të llogarisë/ve dhe shumën e parave ose llojin e pronës dhe të dhëna për pronën.

(3) Me kërkesën nga paragrafi (2) i këtij neni, Drejtoria mund të dorëzojë edhe raport në pajtim me nenin 131 të këtij ligji.

Neni 135

(1) Prokurori publik kompetent e shqyrton kërkesën për ngritjen e propozimit për caktimin e masave të përkohshme nga ky ligj dhe nëse konstaton se është e bazuar, menjëherë dorëzon propozim për caktimin e masës së përkohshme deri te gjykatësi i gjykatës themelore kompetente në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin e Procedurës Penale.

(2) Nëse prokurori publik kompetent konstaton se kërkesa për ngritjen e propozimit për caktimin e masave të përkohshme nga ky ligj është e pabazë, është i detyruar që menjëherë ta njoftojë Drejtorinë se kërkesa është refuzuar. Pas marrjes së njoftimit nga prokurori publik, Drejtoria menjëherë i dorëzon njoftim me shkrim subjektit për refuzimin e kërkesës.

Neni 136

(1) Gjykatësi i gjykatës themelore kompetente është i detyruar që menjëherë të sjellë aktvendim për zbatimin e masës së përkohshme ose për refuzimin e propozimit të prokurorit publik në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për procedurë penale.

(2) Nëse me aktvendimin janë zbatuar masa të përkohshme, gjykatësi është i detyruar që aktvendimin t'ia dorëzojë prokurorit publik, subjektit dhe klientit.

(3) Nëse sillet aktvendim për refuzimin e propozimit të prokurorit publik, gjykatësi është i detyruar që aktvendimin t'ia dorëzojë prokurorit publik.

(4) Prokurori publik kompetent është i detyruar që menjëherë ta informojë Drejtorinë për aktvendimin e gjykatësit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Kundër aktvendimit të gjykatësit nga paragrafi (1) i këtij neni, prokurori publik kompetent dhe klienti kanë të drejtë ankese deri tek këshilli penal i gjykatës themelore kompetente në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, i cili nuk prolongon ekzekutimin e aktvendimit.

Të dhënat statistikore

Neni 137

(1) Për qëllime të përgatitjes së vlerësimit kombëtar të rrezikut, vlerësimit të efikasitetit të sistemit për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për qëllime të analizave strategjike, Drejtoria i mbledh dhe mban evidencë për të dhënat statistikore të mëposhtme:

- numrin, madhësinë, llojin, rëndësinë dhe ndikimin ekonomik të grupeve të caktuara të subjekteve, duke përfshirë numrin e subjekteve dhe numrin e të punësuarve në to;

- numrin e raporteve të pranuar për transaksione të dyshimta në pajtim me nenin 65 të këtij ligji;

- numrin ose përqindjen e raporteve të pranuar për transaksione të dyshimta në pajtim me nenin 65 të këtij ligji, të cilat kanë rezultuar në hetime të mëtejshme, duke përfshirë edhe raportin vjetor për rëndësinë dhe përdorshmërinë e të dhënave nga raportet e subjekteve;

- numrin e raporteve të pranuar në pajtim me nenet 63 dhe 64 të këtij ligji;

- numrin e iniciativave dhe kërkesave të pranuar nga organet kompetente në pajtim me nenin 130 të këtij ligji;

- numrin e informatave dhe të dhënave të pranuar nga organet mbikëqyrëse në pajtim me nenin 155 të këtij ligji;

- numrin e raporteve dhe njoftimeve të dorëzuara tek organet kompetente;

- numrin e raporteve dhe njoftimeve të dorëzuara nga Drejtoria, për të cilat kanë vepruar organet kompetente;

- numrin e informatave spontane të pranuar dhe të dorëzuara nga/te njësitë e inteligjencës financiare të vendeve tjera;

- numrin e kërkesave të dorëzuara, të pranuar, të refuzuara dhe të përgjigjura nga njësitë e inteligjencës financiare të vendeve të tjera dhe të dhëna të tjera;

- numrin e mbikëqyrjeve të kryera, procedurave të zbatuara për barazim, urdhërpagesave kundërvajtëse të lëshuara dhe procedurave të iniciuara për kundërvajtje;
- numrin e urdhërave të dorëzuar për ndjekjen e marrëdhënies afariste;
- numrin e rasteve dhe vlerën e pronës së përfshirë nga masat e përkohshme në pajtim me këtë ligj dhe
- shpërndarjen e burimeve njerëzore, përkatësisht numrin e të punësuarve në Drejtori, veçmas për zbatimin e çdo kompetence të saj ligjore.

(2) Drejtoria publikon në faqen e saj të internetit informata mbi teknikat, metodat dhe trendet aktuale lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, shembuj të rasteve të zbuluara të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, pasqyrën vjetore të mbikëqyrjeve të kryera dhe akte të tjera që dalin nga ky ligj ose nga anëtarësimi në trupat dhe organizatat ndërkombëtare.

(3) Me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të sistemit për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, gjykatat, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore, Agjencia e Menaxhimi të Pronës së Konfiskuar dhe organet tjera kompetente, mbledhin dhe mbajnë të dhëna statistikore lidhur me:

- numrin e urdhërësive të lëshuara për zbatimin e procedurës hetimore dhe numrin e personave për të cilët janë realizuar hetime për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit,
- numrin e kallëzimeve penale dhe numrin e personave për të cilët janë ngritur kallëzimet penale për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit,
- numrin e aktakuzave dhe numrin e personave për të cilët është ngritur aktakuzë për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit,
- numrin e rasteve dhe numrin e personave të përfshirë në kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit,
- numrin e rasteve për të cilat gjatë procedurës penale është bërë rikualifikimi i veprës penale pastrim i parave dhe/ose financim i terrorizmit dhe anasjelltas,
- numrin e aktgjykimeve dhe numrin e personave për të cilët është sjell aktgjykimi lidhur me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit,
- numrin dhe llojin e veprave penale të ndërlidhura, dhe
- numrin e rasteve dhe vlerën e pasurisë së ngrirë, të marrë dhe të konfiskuar në rastet e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në shtetet tjera dhe të dhëna të tjera.

(4) Organet mbikëqyrëse nga ky ligj janë të detyruara të mbledhin dhe të ruajnë të dhëna për:

- 1) Numrin e të punësuarve të cilët janë caktuar në vendet e punës për kryerjen e mbikëqyrjes lidhur me zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga ana e subjekteve;
- 2) Numrin e mbikëqyrjeve të kryera, numrin e shkeljeve të konstatuara si dhe numrin dhe llojin e sanksioneve të shqiptuara.

(5) Organet kompetente nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, të dhënat nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni ia dorëzojnë Drejtorisë së paku një herë në vit, por më së voni deri më 31 janar në vitin rrjedhës për vitin paraparak ose me kërkesë të Drejtorisë.

(6) Drejtoria, një herë në vit, në faqen e saj të internetit publikon raport të konsoliduar për të dhënat statistikore të evidentuara në pajtim me këtë nen.

Sistemi elektronik për ndjekjen e rasteve

Neni 138

(1) Njësia e inteligjencës financiare për qëllime të këtij ligji menaxhon dhe mirëmban sistem elektronik për ndjekjen e rasteve, të cilat burojnë nga kompetencat e Drejtorisë.

(2) Organet kompetente që veprojnë në pajtim me nenin 131 të këtij ligji, detyrimisht fusin të dhëna dhe informata në sistemin elektronik nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Formën, përmbajtjen, mënyrën dhe afatet për futjen dhe përditësimin e të dhënave në sistem dhe mënyrën e ndjekjes së rasteve nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë.

(4) Të dhënat, informatat dhe dokumentet e siguruar në pajtim me këtë nen, ruhen dhjetë vjet nga dita e fundit e futjes së tyre në sistem dhe pas skadimit të kësaj periudhe të njëjtat fshihen.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Neni 139

Me qëllim të rregullimit më të hollësishëm të bashkëpunimit ndërinstitucional, Drejtoria mund të nënshkruajë Memorandume ose Protokolle bashkëpunimi me organet kompetente shtetërore për të përmbushur qëllimet e parapara me këtë ligj.

Këshilli për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit

Neni 140

(1) Për avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në pajtim me qëllimet e këtij ligji, për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e vlerësimit kombëtar të rrezikut dhe për avancimin e sistemit për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrit të financave formon Këshill për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit (në tekstin e mëtejme: Këshilli).

(2) Me punën e Këshillit nga paragrafi (1) i këtij neni udhëheq drejtori i Drejtorisë, kurse anëtarë të tij janë persona udhëheqës dhe përgjegjës nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe të Korrupsionit, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni i Letrave me Vlerë, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Agjencinë e Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, Agjencia e Postave, si dhe përfaqësues të Dhomës së Avokatëve, Dhomës së Noterëve, Instituti i Auditorëve të Autorizuar dhe Instituti i Kontabilistëve dhe i Kontabilistëve të Autorizuar.

(3) Anëtarët e Këshillit kanë zëvendësanëtarë, të cilët përcaktohen nga radhët e të punësuarve në organet dhe institucionet nga paragrafi (2) i këtij neni, të cilët kanë njohuri përkatëse në fushën e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.

(4) Këshilli për qëllime të punës së tij themelon trupa punues të përhershëm ose të përkohshëm, të cilët përbëhen nga personat e punësuar ose përfaqësuesit e organeve dhe institucioneve nga paragrafi (2) i këtij neni, udhëheqësit dhe personat përgjegjës të të cilëve janë anëtarë të këshillit.

(5) Anëtarët e Këshillit, varësisht nga burimet njerëzore me të cilat disponojnë organet dhe institucionet nga paragrafi (2) i këtij neni, nominojnë një person ose më shumë persona, të punësuar ose anëtarë aktivë në organet dhe institucionet nga paragrafi (2) i këtij neni për pjesëmarrje në trupat punues dhe të cilët kanë njohuri përkatëse profesionale për punën e trupit punues.

(6) Në përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, e me propozim të kryetarit apo anëtarëve të Këshillit, në punën e trupave punuese mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të organizatave dhe shoqatave profesionale të subjekteve, si dhe ekspertë të jashtëm.

(7) Këshilli nga paragrafi (1) i këtij neni sjell Rregullore pune për mënyrën e funksionimit të tij.

(8) Punët profesionale dhe administrative lidhur me Këshillin i kryen Drejtoria.

Drejtoria doganore

Neni 141

(1) Drejtoria doganore detyrimisht evidenton çdo futje dhe nxjerrje të parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa përtej linjës doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse shumata e tejkalon maksimumin e lejuar me ligj ose me ndonjë dispozitë tjetër.

(2) Gjatë evidentimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria doganore detyrimisht mbledh të dhëna lidhur me:

- identitetin e personit i cili për vete ose për dikë tjetër kryen futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa, të dhënat për emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, numrin e dokumentit të udhëtimit dhe nënshtetësinë,

- identitetin e pronarit të parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa,

- identitetin e pronarit të vërtetë,

- shumën dhe valutën e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa që futen ose nxirren nëpërmjet linjës doganore,

- deklaratën për origjinën e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa, e nënshkruar nga personi i cili e kryen futjen ose nxjerrjen e tyre,

- qëllimin për futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa, dhe

- vendin dhe kohën e kalimit të linjës doganore.

(3) Drejtoria doganore detyrimisht përmes rrugës së mbrojtur elektronike ose në rastet kur kjo nuk është e mundur, në formë të shkruar paraqet në Drejtori futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa mbi 10 000 euro në kundërvlerë në denarë, më së voni në afat prej tri ditësh pune, nga evidentimi.

(4) Drejtoria doganore detyrimisht në formë të shkruar paraqet në Drejtori futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa pa dallim të shumës, çdo herë kur ekziston bazë për dyshim të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit më së voni në afat prej 24 orësh nga mësimi për dyshimin lidhur me futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa.

(5) Drejtoria doganore është e detyruar t'i ruajë të gjitha të dhënat lidhur me futjen ose nxjerrjen e parave dhe mjeteve bartëse fizike për pagesa, nëpërmjet linjës doganore dhjetë vite nga dita e bartjes së realizuar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Neni 142

(1) Drejtoria realizon bashkëpunim ndërkombëtar me njësi të inteligjencës financiare të shteteve tjera nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave, informatave dhe dokumenteve relevante, spontanisht ose me kërkesë, për qëllime të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Shkëmbimi ndërkombëtar i të dhënave, informatave dhe dokumenteve relevante, nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet në bazë të:

- kërkesës për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumenteve të cilën e dorëzon Drejtoria te njësia për inteligjencë financiare e shtetit tjetër,

- kërkesës për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumenteve të cilën Drejtoria e ka pranuar nga njësia për inteligjencë financiare e shtetit tjetër,

- dërgimit të të dhënave, informatave dhe dokumenteve të Drejtorisë te njësia për inteligjencë financiarë e shtetit tjetër ose

- dërgimi i të dhënave, informatave dhe dokumenteve të njësisë për inteligjencë financiare e shtetit tjetër deri tek Drejtoria.

(3) Drejtoria realizon bashkëpunim ndërkombëtar me njësitë e inteligjencës financiare të shteteve tjera pa marrë parasysh formën e tyre organizative, llojin e veprave ndëshkuese të ndërlidhura madje edhe kur veprat ndëshkuese të ndërlidhura nuk janë përshkruar si të tilla në momentin e shkëmbimit të të dhënave, informatave dhe dokumenteve.

(4) Drejtoria mund të lidhë marrëveshje për bashkëpunim me njësitë e inteligjencës financiare të shteteve tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit për qëllime të parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit. Nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëpunim nuk është parakusht që Drejtoria të realizojë bashkëpunim ndërkombëtar me njësitë e inteligjencës financiare të shteteve tjera.

Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave të cilën e dorëzon Drejtoria te njësitë e inteligjencës financiare të shteteve tjera

Neni 143

(1) Drejtoria për zbatimin e kompetencave të saja në pajtim me dispozitat e këtij ligji mund të dorëzojë kërkesë për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumenteve te njësia për inteligjencë financiare e shtetit tjetër.

(2) Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave, informatave dhe dokumenteve nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të arsyetohet me fakte të njohura përkatëse që tregojnë se kemi të bëjmë me pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit, shkaqet si dhe qëllimin për të cilin do të shfrytëzohen të dhënat dhe informatat e kërkuara.

(3) Të dhënat, informatat dhe dokumentet e siguruara sipas paragrafit (1) të këtij neni, Drejtoria është e detyruar t'i përdorë për zbatimin e kompetencave të veta në pajtim me dispozitat e këtij ligji, në pajtim me kufizimet dhe kushtet e përcaktuara nga njësia për inteligjencë financiare e shtetit e cila i ka siguruar.

(4) Të dhënat, informatat dhe dokumentet e siguruara sipas paragrafit (1) të këtij neni, Drejtoria mund t'i shkëmbejë me organet kompetente, pasi të sigurojë pëlqim paraprak nga njësia për inteligjencë financiare e shtetit tjetër, e cila i ka siguruar ato si dhe në pajtim me kufizimet dhe kushtet e tyre.

(5) Të dhënat, informatat dhe dokumentet e siguruara sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të klasifikuara dhe të shënuara së paku me shkallë të njëjtë të klasifikimit të përcaktuar nga njësia për inteligjencë financiare e shtetit tjetër, e cila i ka siguruar.

Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave , informatave dhe dokumenteve, të cilën Drejtoria e ka pranuar nga njësia e inteligjencës financiare e shtetit tjetër

Neni 144

(1) Në bazë të kërkesës për shkëmbim të të dhënave, informatave dhe dokumenteve të njësisë së inteligjencës financiare të shtetit tjetër të dorëzuar në formë të shkruar, Drejtoria mund të dorëzojë të dhëna, informata dhe dokumente që disponon në bazat e saj të të dhënave dhe/ose që i siguron në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Kërkesa për shkëmbim të të dhënave, informatave dhe dokumenteve nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të arsyetohet me faktet përkatëse të njohura që tregojnë se kemi të bëjmë me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit dhe qëllimin për të cilin do të përdoren të dhënat dhe informatat e kërkuara.

(3) Drejtoria mund të refuzojë kërkesën për shkëmbim të të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse është në kundërshtim me këtë ligj ose mund të pengojë hetimin e organit tjetër kompetent shtetëror ose procedurën penale, kundër personit për të cilin kërkohen të dhëna ose të cilat në një mënyrë tjetër, janë në kundërshtim me parimet fundamentale të ligjvënies kombëtare. Drejtoria është e detyruar t'i arsyetojë shkaqet e refuzimit të kërkesës.

(4) Të dhënat, informatat dhe dokumentet e siguruara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni janë të klasifikuara dhe shënohen me të paktën të njëjtin nivel të klasifikimit të përcaktuar nga njësia e inteligjencës financiare e shtetit që i ka dorëzuar të njëjtat.

(5) Me kërkesën e njësisë së inteligjencës financiare të shtetit tjetër nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria dorëzon pëlqim për përcjelljen e të dhënave, informatave dhe dokumenteve të siguruara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni tek organet kompetente të shtetit pavarësisht nga lloji i veprave penale të ndërlidhura.

(6) Drejtoria mund të refuzojë dhënien e pëlqimit për përcjelljen e të dhënave, informatave dhe dokumenteve me arsyetimin në formë të shkruar deri tek njësia e inteligjencës financiare nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse kërkesa për pëlqim është në kundërshtim me këtë ligj ose pengon kryerjen e hetimit në procedurë penale ose në mënyrë tjetër është në kundërshtim me parimet fundamentale të ligjvënies kombëtare.

Dorëzimi i të dhënave, informatave dhe dokumenteve të Drejtorisë të njësia e inteligjencës financiare e shtetit tjetër

Neni 145

(1) Drejtoria mund t'i dorëzojë të dhënat, informatat dhe dokumentet që i ka siguruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj, kur ekziston dyshim për pastrim të parave ose financim të terrorizmit dhe kur nuk ka kërkesë nga njësia e inteligjencës financiare e shtetit tjetër.

(2) Për të dhënat, informatat dhe dokumentet të cilat Drejtoria i dorëzon në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Masat e përkohshme dhe urdhëri për ndjekjen e marrëdhënies afariste në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 146

(1) Dispozitat e neneve 132, 133, 134, 135 dhe 136 të këtij ligji, do të zbatohen kur njësia për inteligjencë financiare e shtetit tjetër do të kërkojë ndjekjen e marrëdhënies afariste, pezullim i përkohshëm dhe ose ndalimi i realizimit të transaksioneve ose ngrirjen e përkohshme të pronës.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të arsyetohet dhe t'i referohet transaksionit, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit dhe nëse transaksioni në pajtim me ligjin mund të jetë lëndë e raportit vendor për transaksion të dyshimtë.

(3) Drejtoria mund ta refuzojë kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni nëse është në kundërshtim me këtë ligj ose do të pengojë udhëheqjen e hetimit nga organi tjetër kompetent shtetëror ose procedurën penale kundër personit për të cilin kërkohen të dhëna ose që në mënyrë tjetër janë në kundërshtim me parimet fundamentale të ligjvënies kombëtare. Drejtoria është e detyruar të arsyetojë shkaqet e refuzimit të kërkesës.

(4) Drejtoria mund të dorëzojë kërkesë të njësia e inteligjencës financiare e shtetit tjetër për ndjekjen e marrëdhënies afariste, për pezullim të përkohshëm dhe/ose ndalim të realizimit të transaksioneve ose ngrirje të përkohshme të pronës, kur kemi të bëjmë me dyshime lidhur me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

Informatat kthyesë

Neni 147

(1) Drejtoria me kërkesë të njësisë së inteligjencës financiare të shtetit tjetër, siguron informata kthyesë për përdorimin e të dhënave, informatave dhe dokumenteve të dorëzuara.

(2) Drejtoria mund të kërkojë nga njësia e inteligjencës financiare të shtetit tjetër informata kthyesë për përdorimin e të dhënave, informatave dhe dokumenteve të dorëzuara.

Mënyrat e sigurta për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 148

Shkëmbimi i të dhënave, informatave dhe dokumenteve ndërmjet Drejtorisë dhe njësive të inteligjencës financiare të shteteve të tjera në pajtim me këtë ligj do të realizohet përmes sistemeve të sigurta të komunikimit elektronik ndërkombëtar.

Neni 149

(1) Drejtoria mund të shkëmbejë në mënyrë indirekte të dhëna, informata dhe dokumente me organet kompetente për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të shteteve të tjera, por një shkëmbim i tillë duhet të kryhet nëpërmjet njësisë së inteligjencës financiare të shtetit nëpërmjet sistemeve të sigurta të komunikimit elektronik ndërkombëtar.

(2) Gjatë shkëmbimit të të dhënave, informatave dhe dokumenteve në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji që rregullojnë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ruajtja e të dhënave, informatave dhe dokumenteve nga ana e Drejtorisë

Neni 150

Drejtoria është e detyruar t'i ruajë të dhënat, informatat dhe dokumentet e siguruara në pajtim me këtë ligj, dhjetë vjet nga pranimi i tyre dhe pas skadimit të kësaj periudhe detyrohet t'i asgjësojë të njëjtat.

KAPITULLI VI.

MBIKËQYRJA

Neni 151

(1) Mbikëqyrjen lidhur me zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj e kryejnë organet e mbikëqyrjes në kuptim të këtij ligji edhe atë:

1) Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj bankave, kursimoreve, këmbimoreve dhe ofruesve të shërbimeve të remitencave (transfer të shpejtë të parave) si dhe ndaj institucioneve tjera financiare që ofrojnë shërbime pagesore në pajtim me ligjin;

2) Agjencia për mbikëqyrje të sigurimeve ndaj personave juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë punë lidhur me sigurime, përfaqësim edhe / ose ndërmjetësim në sigurime të jetës me komponentë kursyese edhe/ose investuese dhe sigurime tjera të lidhura me komponentë kursyese edhe / ose investuese si: shoqëri të sigurimeve, shoqëri brokere të sigurimeve dhe shoqëri për përfaqësim dhe përfaqësues në sigurime;

3) Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj shtëpive brokere, bankave që posedojnë leje për punë me letra me vlerë, personat që ofrojnë shërbime në cilësi të këshilltarëve investues, shoqëri për këshillime investuese, shoqëri që administrojnë fonde investuese të hapura, të mbyllura dhe private si dhe fonde investuese të hapura, të mbyllura dhe private;

4) Agjencia e Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të sigurimit pensional ndaj shoqërive që administrojnë me fonde vullnetare pensionale;

5) Drejtoria e të Ardhurave Publike ndaj organizuesve të lojërave të fatit, personave juridik dhe fizik që ofrojnë këto shërbime: ndërmjetësim në qarkullimin me patundshmëritë, këshillime në fushën e tatimeve dhe personave juridik që kryejnë veprimtari lidhur me marrjen nën hipotekë të mjeteve të tundshme dhe të patundshme;

6) Agjencia e Postës ndaj SHA “Postat e Maqedonisë së Veriut”;

7) Komisioni i Noterëve në kuadër të Dhomës së Noterëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj noterëve, dhe

8) Komisioni i Avokatëve në kuadër të Dhomës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj avokatëve dhe shoqërive të avokatëve.

(2) Drejtoria kryen mbikëqyrje lidhur me zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj ndaj subjekteve që nuk janë përfshirë me paragrafin (1) të këtij neni si dhe ndaj personave juridik veprimtaria e të cilëve është shitblerja e veturave të reja si dhe ndaj përmbaruesve.

(3) Drejtoria mundet në mënyrë vetanake apo në bashkëpunim me organet e nenit (1) pikat 1), 2), 3) dhe 4) të këtij neni të kryejë mbikëqyrje të jashtëzakonshme dhe kontrolluese ndaj subjekteve lidhur me zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Drejtoria mundet në mënyrë vetanake apo në bashkëpunim me organet e nenit (1) pikat 5), 6), 7) dhe 8) të këtij neni të kryejë mbikëqyrje ndaj subjekteve lidhur me zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj.

(5) Drejtoria pas njoftimit të marrë nga administratori i regjistrit zbaton mbikëqyrje në pajtim me këtë ligj ndaj subjekteve juridike nga paragrafi (2) i nenit 35 të këtij ligji.

(6) Drejtoria kryen mbikëqyrje ndaj personave juridik nga neni 28, paragrafi (1) të këtij ligji nëse të njëjtët posedojnë, ruajnë dhe kanë paraqitur të dhëna të plota, të sakta dhe adekuate lidhur me pronarin e vërtetë.

(7) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërmarrin aktivitete me qëllim të harmonizimit të qasjes metodologjike gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(8) Drejtoria e të ardhurave publike në bazë të kompetencave të saja kryen mbikëqyrje ndaj personave juridik dhe fizik për sa i përket zbatimit të ndalesës për pagesat në para të gatshme nga neni 58 të këtij ligji.

Mbikëqyrja në pajtim me vlerësimin e rrezikut

Neni 152

(1) Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes ndaj subjekteve, organet e mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji janë të detyruar të zbatojnë qasje të bazuar në vlerësimin e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.

(2) Gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programës vjetore apo të planit vjetor për mbikëqyrje, organet e mbikëqyrjes nga neni 151 të këtij ligji janë të detyruar që së paku t'i kushtojnë vëmendje:

- të dhënave për rreziqet e identifikuar lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit konform konstatimeve nga raporti i vlerësimit kombëtar të rrezikut nga ky ligj;

- të dhënave për rreziqet specifike kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me klientë, produkte, shërbime dhe kanale të shpërndarjes;

- të dhënave për rrezikun e kategorive të caktuara të subjekteve, subjekte të caktuara dhe të dhëna tjera me qasje të lirë për subjektet dhe

- ngjarjeve apo ndryshimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me udhëheqjen e subjektit dhe çdo ndryshim të aktiviteteve të tij afariste.

Kompetencat e veçanta të organeve mbikëqyrëse

Neni 153

(1) Organi i mbikëqyrjes nga ky ligj, poqëse në bazë të një ligji tjetër jep licenca për subjektet sipas nenit 5 të këtij ligji, gjegjësisht autorizime për subjektet që të vërtetohet harmonizmi me kushtet e përcaktuara për lëshim të lejeve për punë, gjegjësisht çertifikata apo funksione të anëtarit të organit udhëheqës konform dispozitave, mundet çdoherë të sigurojë me detyrë zyrtare të dhëna për personat që u janë shqiptuar dënime ose që nuk u janë shqiptuar dënime e lidhur me të cilët kontrollohet përmbushja e kushteve për personat që kanë reputacion apo për bashkëpunëtorët e tyre nëse me ligj tjetër nuk është ndryshe e rregulluar.

(2) Bashkëpunëtor sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse me tjetër ligj nuk është ndryshe e rregulluar është personi fizik i cili së bashku me personin fizik i cili është themelues, bashkëpronar apo pronar i vërtetë i subjektit, aksionar me pjesmarrje të kualifikuar në subjekt konform ligjeve tjera me të cilat rregullohet pjesmarrja e kualifikuar apo së bashku me personin fizik që është propozuar për anëtar në udhëheqësinë e lartë të subjektit, direkt apo indirekt me / përmes marrëveshjes, ushtron kontrollë mbi shoqëri vendore apo të jashtme.

(3) Për personin i cili nuk posedon reputacion sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse me tjetër ligj nuk është ndryshe e rregulluar do të llogaritet personi i cili është i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor me dënim me burgim të pakushtë me kohëzgjatje mbi gjashtë muaj, përderisa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit dhe/ose ka bashkëpunëtor i cili është i dënuar me dënim burgu të pakushtë me kohëzgjatje mbi gjashtë muaj me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor, përderisa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit.

(4) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni mund të përdoren vetëm për qëllime për të cilat janë siguruar dhe nuk mund të publikohen si dhe të kenë qasje në to personat e tretë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e mbikëqyrjes

Neni 154

(1) Organi që është kompetent për të kryer mbikëqyrje nga ky ligj, nëse me tjetër ligj nuk është ndryshe e rregulluar, mundet me iniciativë vetanake apo në bazë të kërkesës së arsyetuar në formë të shkruar nga një organ i një shteti të huaj kompetent për të kryer mbikëqyrje, të shkëmbejë të dhëna, informata dhe dokumente lidhur me:

1) legjislativën në fushën në të cilën vepron subjekti ndaj të cilit kryhet mbikëqyrje si dhe legjislativë tjetër relevante për mbikëqyrje;

2) sektorin në të cilin vepron subjekti mbi të cilin mbikëqyrje kryen organi mbikëqyrës;

3) kryerjen e mbikëqyrjes gjegjësisht supervizionit ndaj subjektit dhe

4) transaksionet apo personat për të cilët ekziston bazë për dyshim se janë të përfshirë në pastrim parash dhe financim të terrorizmit apo ndonjë vepër tjetër penale e ndërlidhur nga ku është bërë përfitim nga një vepër e dënueshme që mund të shfrytëzohen për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(2) Mënyrën e dorëzimit të të dhënave, informatave dhe dokumenteve, nëse me tjetër ligj nuk është ndryshe e rregulluar, organet nga paragrafi (1) i këtij neni mund ta rregullojnë përmes nënshkrimit të memorandumeve apo marrëveshjeve për bashkëpunim në fushën e mbikëqyrjes, por që të sigurohet integriteti i këtyre të dhënave dhe mbrojtja e tyre nga ndonjë qasje e pa autorizuar.

(3) Organet e mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse me tjetër ligj nuk është ndryshe e rregulluar, konform parimeve të reciprocitetit dhe besueshmërisë, munden mes veti të kërkojnë ndihmë për kryerje të mbikëqyrjes në kuadër të autorizimeve të tyre mbi subjektin i cili është pjesë e grupacionit dhe i cili ushtron aktivitetin e tij afarist në shtetin i cili kërkon ndihmë.

(4) Organet e mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni shfrytëzojnë të dhëna, informata dhe dokumente vetëm në këto raste:

1) gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre në pajtim me këtë ligj;

2) në rast të ankesës apo mjeteve tjera juridike që janë parashtruar ndaj aktit të organit që është kompetent për kryerje të mbikëqyrjes, duke përfshirë edhe procedurë gjyqësore.

(5) Organi i mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të zbulojë dhe të shkëmbejë të dhëna, informata dhe dokumente me persona të tretë e që janë siguruar në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes në pajtim me dispozitat e këtij neni pa miratim të prerë të organit kompetent për mbikëqyrje që i ka siguruar ato informata, të dhëna apo dokumente, as që mund të shfrytëzohen për qëllime tjera përveç qëllimit për të cilin organi ka dhënë pëlqim.

(6) Obligim për ruajtjen dhe besueshmërinë e të dhënave në pajtim me dispozitat e këtij ligji apo me ligj tjetër me të cilin rregullohen autorizimet dhe funksionet e organit kompetent për mbikëqyrje nga paragrafi (1) i këtij neni, kanë të gjithë personat që punojnë apo kanë punuar në organin e mbikëqyrjes.

Bashkëpunimi në fushën e mbikëqyrjes

Neni 155

(1) Drejtoria me organet e mbikëqyrjes nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruar që së bashku të koordinojnë aktivitetet gjatë kryerjes së mbikëqyrjes ndaj subjekteve të këtij ligji.

(2) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar të përgatisin program vjetor apo plan për kryerje të mbikëqyrjeve lidhur me zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj dhe të bëjnë harmonizimin e tyre.

(3) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni mund të përcaktojnë mënyrën e zbatimit adekuat të masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për subjektet për të cilët janë përgjegjës të mbikëqyrjes.

(4) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni bashkëpunojnë gjatë ushtrimit të punëve dhe autorizimeve të tyre lidhur me kryerjen e mbikëqyrjes me qëllim që masat dhe mbikëqyrja të jenë sa më efikase në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(5) Drejtoria mund të parashtojë propozim deri te organet nga paragrafi (1) i këtij neni që të kryejnë mbikëqyrje ndaj një subjekti të caktuar në bazë të njohurive që burojnë nga të dhënat dhe informatat me të cilat disponon, si dhe në bazë të analizave të kryera strategjike dhe operative.

(6) Drejtoria dhe organet nga paragrafi (1) i këtij neni ndërmarrin aktivitete me qëllim të harmonizimit të qasjes metodologjike gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(7) Drejtoria dhe organet e mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni për nevojat e kryerjes së mbikëqyrjes ndaj subjekteve të përcaktuara me nenin 151 paragrafi (1) të këtij ligji, mund të kërkojnë dhe të shkëmbejnë informata financiare dhe administrative por dhe informata të marra nga mbikëqyrjet e kryera si dhe të dhëna tjera për subjektin e caktuar për mbikëqyrje si dhe për nevojat përgatitjes së kryerjes së mbikëqyrjes, duke përfshirë edhe të dhëna lidhur me tipologjitë dhe trendet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Dorëzimi i informatave dhe të dhënave te Drejtoria nga ana e organeve mbikëqyrëse

Neni 156

(1) Organet nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji dorëzojnë raport te Drejtoria në këto raste:

1) nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, konstatojnë dyshime për pastrim të parave dhe/ose financim të terrorizmit;

2) gjatë kryerjes së detyrave, aktiviteteve apo transaksioneve të kryera në pajtim me kompetencat e përcaktuara në ligje tjera, konstatojnë dyshime për pastrim të parave dhe/ose financim të terrorizmit;

(2) Në rastet nga paragrafi (1) pika 2) e këtij ligji, organet nga neni 151 paragrafi (1) mund të refuzojnë ose të prolongojnë transaksionin dhe për këtë duhet të njoftojnë Drejtorinë.

(3) Raportin nga paragrafi (1) i këtij neni, organet nga neni 151 paragrafi (1) të këtij ligji e dorëzojnë përmes rrugës së mbrojtur elektronike. Nëse kjo mënyrë e dorëzimit nuk është e mundshme për shkaqe teknike, organet nga neni 151, paragrafi (1), raportin e dorëzojnë në formë të shkruar.

(4) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të përmbajë:

1) informata dhe të dhëna për personin fizik apo juridik për të cilin ekzistojnë dyshime në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni edhe atë:

- për personin fizik emri, mbiemri, data e lindjes, numri i dokumentit të vlefshëm për identifikim, vendbanimi, gjegjësisht vendqëndrimi, NVAQ dhe
- për personin juridik: emërtimi, selia, NVAS, NVT dhe të dhëna tjera.

2) arsyet për dyshim të pastrimit të parave dhe/ose financim të terrorizmit të shoqëruara me informata, të dhëna që vërtetohen me dokumentacionin përkatës.

(5) Me qëllim të ushtrimit të kompetencave që burojnë nga ky ligj, Drejtoria mundet të kërkojë të dhëna dhe informata plotësuese e që janë të rëndësishme lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga organet e mbikëqyrjes nga neni 151 paragrafi (1) të këtij ligji lidhur me rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(6) Dorëzimi i këtyre të dhënave tek Drejtoria nuk paraqet zbulim të të dhënave të besueshme apo zbulim të të dhënave dhe informatave të klasifikuara.

(7) Kur Drejtoria shqyrton raportin nga paragrafi (1) të këtij neni dhe konstaton që ka bazë për dyshime për një vepër penale të kryer lidhur me pastrimin e parave dhe/ose financimit të terrorizmit apo ndonjë vepër tjetër penale, Drejtoria vepron në pajtim me nenin 131 të këtij ligji.

(8) Drejtoria i njofton organet e mbikëqyrjes nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji për epilogun e shqyrtimit të raportit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 157

(1) Lidhur me autorizimet e personave që kryejnë mbikëqyrje nga organet e mbikëqyrjes nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga neni 169 të këtij ligji e që kanë të bëjnë me autorizimet e zbuluesve financiar që kryejnë mbikëqyrje, nëse me ligjin me të cilin janë themeluar dhe me të cilin rregullohet mënyra e punës së tyre, nuk është ndryshe e rregulluar.

(2) Personat që kryejnë mbikëqyrje nga organet e nenit 151, paragrafi (1) të këtij ligji detyrimisht duhet të jenë persona që:

- 1) posedojnë integritet të lartë;
- 2) posedojnë njohuri dhe përvojë përkatëse në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe
- 3) përmbushin kushtet në pajtim me dispozitat që rregullojnë fushën e parandalimit të konfliktit të interesit.

Neni 158

Personat që janë të punësuar dhe personat që kanë punuar në organet mbikëqyrëse nga ky ligj, si dhe auditorët ose ekspertët që veprojnë ose kanë vepruar në emër të organit mbikëqyrës janë të detyruar të ruajnë të dhënat dhe informatat në të cilat kanë ose kanë pasur qasje për qëllime të mbikëqyrjes si sekret profesional sipas ligjit.

Kompetencat e Drejtorisë në procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes

Neni 159

(1) Mbikëqyrja që kryhet në mënyrë të pavarur nga Drejtoria mund të jetë mbikëqyrje në terren, mbikëqyrje e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese si dhe monitorim i vazhdueshëm i subjekteve.

(2) Mbikëqyrja në terren nga paragrafi (1) i këtij neni mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese.

(3) Mbikëqyrja e rregullt nga paragrafi (1) i këtij neni është mbikëqyrje e paralajmëruar në pajtim me programin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes, ndërsa mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet pa paralajmërim paraprak.

(4) Mbikëqyrja në terren e kryer nga Drejtoria mund të zgjasë më së shumti 45 ditë pune, me mundësi vazhdimi, por jo më shumë se 60 ditë pune.

Neni 160

(1) Mbikëqyrjen nga neni 159 të këtij ligji e kryejnë zbuluesit financiar të punësuar në Drejtori të cilët i plotësojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin e të punësuarve në Sektorin Publik dhe kushtet e përcaktuara me aktin për sistematizim të vendeve të punës në Drejtori.

(2) Zbuluesit financiar nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht duhet të jenë persona të cilët:

1) kanë integritet të lartë;

2) kanë njohuri dhe përvojë të duhur në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe

3) plotësojnë kushtet në pajtim me dispozitat që rregullojnë fushën e parandalimit të konfliktit të interesave.

(3) Në bazë të mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni, Drejtoria mund:

- të inicojë procedurë për zbatimin e masave korrigjuese;

- të propozojë procedurën e barazimit me lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje dhe

- të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(4) Drejtori i Drejtorisë sjell programë vjetore për kryerjen e mbikëqyrjes më së voni deri më 31 janar të vitit vijues.

(5) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërit për kryerjen e mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë.

Monitorimi i vazhdueshëm i subjekteve nga ana e Drejtorisë

Neni 161

(1) Monitorimi i vazhdueshëm i subjekteve përbëhet nga analiza e të dhënave, informatave dhe dokumenteve që disponon Drejtoria si dhe analiza e të dhënave, informatave dhe dokumenteve të pranuar në bazë të kërkesave të parashtruara deri te subjektet ndaj të cilëve Drejtoria kryen mbikëqyrje në pajtim me këtë ligj.

(2) Subjektet nga ky ligj janë të detyruar t'i dorëzojnë Drejtorisë të dhënat, informatat dhe dokumentet e kërkuara nga paragrafi (1) i këtij neni në afatin e përcaktuar nga Drejtoria nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(3) Subjektet janë të detyruara që të dhënat, informatat dhe dokumentet e kërkuara nga paragrafi (2) i këtij neni t'ia dorëzojnë Drejtorisë në mënyrë të mbrojtur elektronike. Nëse kjo mënyrë e dorëzimit pamundësohet për arsye teknike, subjektet duhet të dorëzojnë të dhënat, informatat dhe dokumentet e kërkuara në formë të shkruar ose në çdo mënyrë tjetër të përshkruar në kërkesë.

(4) Të dhënat, informatat dhe dokumentet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, si dhe të dhënat, informatat dhe dokumentet që disponon Drejtoria në bazë të dispozitave të këtij ligji, do të përdoren për qëllime të mbikëqyrjes në pajtim me vlerësimin e rrezikut nga neni 152 të këtij ligji.

(5) Drejtori i Drejtorisë përcakton metodologji për kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm ndaj subjekteve.

Mbikëqyrja në terren

Neni 162

(1) Mbikëqyrja në terren bëhet në bazë të programës vjetore për kryerjen e mbikëqyrjes në pajtim me këtë ligj.

(2) Drejtori i Drejtorisë lëshon urdhër me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes në bazë të programit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (2) i këtij neni, drejtori lëshon edhe urdhër me shkrim për kryerjen e mbikëqyrjes në terren për subjektet që nuk janë paraparë me programën vjetore për kryerjen e mbikëqyrjes.

(4) Mbikëqyrja në terren fillon me dorëzimin e urdhërit për mbikëqyrje deri te subjekti, gjegjësisht tek personi përgjegjës në subjekt ose përfaqësuesi i subjektit.

Neni 163

Nëse për arsye objektive lidhur me dukuri natyrore pamundësohet kryerja në mënyrë efektive dhe efikase e mbikëqyrjes në mënyrën dhe afatet e përcaktuara në këtë ligj, zbuluesi financiar me konkluzion e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes deri në momentin e mënjanimin të shkaqeve për të cilat procedura është ndërprerë me forcë.

Mënjanimi i parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara

Neni 164

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes që kryen Drejtoria, zbuluesi financiar, për të mënjeluar parregullsitë apo shkeljet e konstatuara, ka të drejtë dhe obligim që ndaj subjektit:

- 1) të inicojë procedurë për zbatimin e masave korigjuese;
- 2) të propozojë procedurë për barazim përmes lëshimit të urdhërpagesës për kundërvajtje ose
- 3) të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ose të inicojë procedurë tjetër përkatëse.

(2) Lidhur me masat nga paragrafi (1) i këtij neni të cilat do të zbatohen, zbuluesit financiar udhëhiqen nga:

- 1) lloji dhe serioziteti i paligjshmërisë dhe/ose parregullsisë;
- 2) ndikimi ose ndikimi i mundshëm i masës së shqiptuar ndaj subjektit;
- 3) nëse lëshimi i veprimeve të detyrueshme ligjore, përkatësisht parregullsia ka qenë i qëllimshëm dhe/ose përsëritet;
- 4) rrethanat nën të cilat është bërë shkelja si dhe gatishmëria e subjektit për të mënjeluar paligjshmëritë dhe parregullsitë e konstatuara dhe
- 5) rrethanat tjera nën të cilat është bërë shkelja, përkatësisht parregullsia.

Masat korigjuese

Neni 165

(1) Zbuluesit financiarë të cilët kryejnë mbikëqyrje në pajtim me dispozitat e këtij ligji do të fillojnë procedurë për masa korigjuese në rast të parregullsive të konstatuara në punën e subjektit që nuk kanë veçori dhe elemente të shkeljeve të përshkruara në këtë ligj, por që

paraqesin zbatim joadekuat ose jo të plotë të masave dhe veprimeve kundër pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit që mund të ndikojnë në ekspozimin e subjektit ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) të këtij neni, zbuluesit financiar të cilët kryejnë mbikëqyrje mund t'i dorëzojnë subjektit procesverbal me rekomandime për mënjanimin e mangësive të konstatuara me afate për veprim.

(3) Në afat prej dhjetë ditësh nga skadimi i afateve nga paragrafi (2) i këtij neni, subjekti është i detyruar që Drejtorisë t'i dorëzojë raport për aktivitetet e ndërmarra dhe dëshmi të dokumentuara se ka vepruar në pajtim me masat nga paragrafi (2) i këtij neni.

Procedura e shqiptimit të masave korigjuese

Neni 166

(1) Procedura e shqiptimit të masave korigjuese fillon me rekomandimin/et për mënjanimin e mangësive dhe parregullsive të konstatuara me afate veprimi të cilat janë pjesë përbërëse e procesverbalit nga momenti i nënshkrimit apo pranimit të procesverbalit nga subjekti ndaj të cilit kryhet mbikëqyrja.

(2) Drejtoria mban evidencë për procedurat e zbatuara lidhur me masat e shqiptuara korigjuese.

(3) Formën dhe përmbajtjen e evidencës për procedurat e zbatuara lidhur me masat e shqiptuara korigjuese, i përcakton ministri i Financave me propozim të drejtorit të Drejtorisë.

Mbikëqyrja kontrolluese

Neni 167

(1) Mbikëqyrja kontrolluese kryhet sipas detyrës zyrtare me qëllim që zbuluesit financiarë të cilët kryejnë mbikëqyrje të konstatojnë nëse subjekti ndaj të cilit kryhet mbikëqyrje, pas skadimit të afatit të caktuar, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes paraprake të rregullt apo të jashtëzakonshme:

- 1) ka vepruar sipas masave të shqiptuara korigjuese;
- 2) ka vepruar pjesërisht sipas masave të shqiptuara korigjuese ose
- 3) nuk ka vepruar sipas masave të shqiptuara korigjuese.

(2) Nëse subjekti ka vepruar sipas masave korigjuese të shqiptuara në pajtim me këtë ligj, zbuluesit financiar të cilët kryejnë mbikëqyrje të njëjtën do ta konstatojnë në procesverbalin nga mbikëqyrja e kryer kontrolluese.

(3) Mosveprimi ose veprimi i pjesshëm ndaj masave korigjuese të shqiptuara nga ky ligj konstatohet në procesverbal nga mbikëqyrja kontrolluese dhe është bazë për inicimin e procedurës për barazim dhe lëshim të urdhërpagesës për kundërvajtje, gjegjësisht parashtrimin e kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Neni 168

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga ana e Drejtorisë, zbuluesi financiar ka për obligim:

- 1) të veprojë sipas urdhërit për mbikëqyrje;
- 2) të ndërmarrë aktivitete përgatitore për kryerjen e mbikëqyrjes;
- 3) të informojë personin përgjegjës dhe të autorizuar të subjektit për fillimin e mbikëqyrjes, bazën ligjore, qëllimin dhe atë që do të përfshijë mbikëqyrja, përveç rasteve të mbikëqyrjes së jashtëzakonshme dhe kontrolluese;
- 4) të legjitimohet para subjektit, përkatësisht para personit të autorizuar të subjektit;
- 5) të ruaj sekretin e të dhënave;
- 6) të veprojë sipas ligjit, me kohë dhe në pajtim me Kodeksin e etikës së zbuluesve financiar që kryejnë mbikëqyrje;

- 7) të përpilojë procesverbal për mbikëqyrjen e kryer;
 - 8) të propozojë procedurë për barazim dhe të lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje;
 - 9) të inicojë procedurë për shqiptimin e masave korigjuese;
 - 10) të parashtrij kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje;
 - 11) të mbledhë, përpunojë dhe ruajë të dhënat personale në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe
 - 12) të sjell konkluzion për ndërprerjen e mbikëqyrjes në pajtim me nenin 163 të këtij ligji.
- (2) Krahas obligimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, zbuluesi financiar për mbikëqyrjen e kryer është i obliguar që dokumentacionin e përgatitur ta sistemoj në dosje në këtë mënyrë:
- 1) dokumentet e mbledhura gjatë përgatitjes së mbikëqyrjes;
 - 2) kërkesë nga njësitë në Drejtori, organ apo institucion tjetër nëse mbikëqyrja është kryer me kërkesë të tyre;
 - 3) urdhër për mbikëqyrje;
 - 4) procesverbal për mbikëqyrjen e kryer;
 - 5) procesverbal nga mbikëqyrja e kryer kontrolluese;
 - 6) konkluzioni në pajtim me nenin 163 të këtij ligji;
 - 7) procesverbal nga barazimi i zbatuar;
 - 8) urdhërpagesë për kundërvajtje;
 - 9) kërkesa për iniciimin e procedurës për kundërvajtje dhe
 - 10) aktvendimet e plotfuqishme dhe ekzekutuese nga procedura gjyqësore.

Neni 169

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes që zbaton Drejtorja, zbuluesi financiar është i autorizuar:
- 1) të kontrollojë dhe të mbledhë akte individuale dh të përgjithshme, fajlle, dokumente, dëshmi dhe informata të mjaftueshme sipas lëndës së mbikëqyrjes, si dhe të kërkojë përgatitjen e kopjeve dhe dokumenteve të nevojshme;
 - 2) të kërkoj nga subjekti që t'i sigurohen kushte për punë në lokalet afariste të subjektit dhe një person i cili do të jetë i pranishëm gjatë mbikëqyrjes, për të siguruar me kohë dokumentet dhe informatat lidhur me lëndën e mbikëqyrjes;
 - 3) të hyjë dhe të kryej kontroll në objektet afariste të subjektit dhe njësitë e tij;
 - 4) të kërkoj asistencë nga organi kompetent i administratës shtetërore për largimin e personit që pengon kryerjen e mbikëqyrjes nën kushte dhe procedurë të përcaktuar me ligj;
 - 5) të kontrolloj dokumentet e identifikimit të personave me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre në pajtim me ligjin;
 - 6) të kërkoj shpjegim verbal ose me shkrim nga subjekti ose punonjësit e tij për çështje nga fushëveprimi i mbikëqyrjes;
 - 7) të kërkojë mendim profesional nga ekspertët për nevojat e mbikëqyrjes;
 - 8) të bëj evidentimin e dokumenteve që hasen në objektin afarist;
 - 9) të ketë qasje në sistemin e menaxhimit të bazës së të dhënave të cilin e përdor subjekti për kryerjen e kontrollës në vendngjarje me ndihmën e teknologjisë informatike dhe
 - 10) të sigurojë dokumente të tjera të nevojshme, të dhëna dhe informata lidhur me mbikëqyrjen.
- (2) Kopjen me origjinalin e fajlleve, dokumenteve, dëshmime dhe informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, subjekti e vërteton me nënshkrimin e personit të autorizuar.
- (3) Zbuluesi financiar është i autorizuar të inicojë procedurë për zbatimin e masave korigjuese, procedurë për lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje dhe procedurë kundërvajtëse në pajtim me ligj.

Neni 170

- (1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes që zbaton Drejtorja, zbuluesi financiar, për mënjanimin e shkeljeve të konstatuara, ka të drejtë dhe obligim që ndaj subjektit:

- 1) të inicojë procedurë për shqiptimin e masave korigjuese;
- 2) të lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje ose
- 3) t'i parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

Neni 171

(1) Dhomat e Avokatëve dhe Dhomat e Noterëve në kuadër të kompetencave të tyre formojnë komisione për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji për punën e anëtarëve të tyre.

(2) Anëtarët e komisioneve nga paragrafi (1) i këtij neni emërohen me mandat prej katër vjetësh, përveç nëse me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Për emërimin dhe përbërjen e komisioneve nga paragrafi (1) i këtij neni e informojnë Drejtorinë në afat prej shtatë ditësh.

Neni 172

(1) Organet mbikëqyrëse nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruar të njoftojnë Drejtorinë lidhur me:

- konstatimet nga mbikëqyrja e kryer mbi zbatimin e masave dhe veprimeve të përcaktuara me këtë ligj,

- masat e shqiptuara korigjuese ose masa të tjera,

- urdhërpagesat për kundërvajtje të lëshuara dhe të arkëtuara,

- kërkesat e parashtruara për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes për shkeljen e kryer nga subjektet ndaj të cilëve kryhet mbikëqyrja dhe për epilogun e këtyre procedurave,

- personin që ka kryer shkeljen ligjore, si në vijim: emërtimi dhe selia e personit juridik, emri dhe mbiemri i personit përgjegjës në personin juridik, emri dhe mbiemri i personit fizik, personit që ushtron autorizim publik dhe personi zyrtar i autorizuar,

- shkeljen: përshkrimi i veprimit që cilësohet si shkelje dhe

- sanksioni kundërvajtës i shqiptuar.

(2) Organet mbikëqyrëse nga neni 151 paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruara që së paku një herë në vit ta informojnë Drejtorinë për të dhënat lidhur me mbikëqyrjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Drejtoria për mbikëqyrjen e kryer mbi subjektet dhe për konstatimet nga mbikëqyrja e kryer një herë në vit e informon organin përkatës mbikëqyrës nga ky ligj.

Procedura për paraqitjen e shkeljes së kryer

Neni 173

(1) Subjekti është i detyruar që përmes kanalit të pavarur dhe anonim të raportimit të vendos procedurë për raportimin e shkeljes së kryer, e cila do t'u mundësojë punonjësve të paraqesin shkeljen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Procedura për paraqitjen e shkeljes së kryer nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të përmbajë rregulla të qarta për pranimin dhe përpunimin e denoncimeve lidhur me shkeljen e kryer, në proporcion me natyrën dhe madhësinë e subjektit.

(3) Subjekti nuk guxon të zbuloj identitetin e personit që e ka raportuar shkeljen e kryer pa siguruar pëlqimin paraprak të tij, përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllimet e zbatimit të procedurës parahetimore ose penale.

Neni 174

(1) Organet mbikëqyrëse nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruar që të vendosin procedura efikase për raportimin e shkeljes së kryer, që do t'u mundësojë të punësuarve në subjektet që të raportojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, të cilat do të sigurojnë:

- metodë të thjeshtë dhe lehtësisht të qasshme të paraqitjes së njoftimeve për shkeljen e kryer;

- rregullat e brendshme për pranimin dhe përpunimin e njoftimeve për shkelje të kryer dhe
- mbrojtje të të dhënave personale të personit i cili ka paraqitur njoftim për shkelje të kryer në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(2) Organet e mbikëqyrjes nga neni 151 paragrafi (1) të këtij ligji nuk guxojnë të zbulojnë identitetin e personit i cili ka paraqitur njoftim për shkelje të kryer pa siguruar pëlqimin e tij paraprak.

Publikimi i informatave lidhur me mbikëqyrjen

Neni 175

(1) Me qëllim të parandalimit dhe zbrapjes nga realizimi i aktiviteteve që konsiderohen si shkelje në pajtim me këtë ligj, organet mbikëqyrëse nga neni 151 paragrafi (1) të këtij ligji publikisht shpallin informatat për sanksionet e shqiptuara kundërvajtëse në bazë të aktvendimit të plotfuqishëm të gjykatës, përveç nëse publikimi i informatës mund të pengojë zbatimin e procedurës parahetimore ose penale.

(2) Informatat nga paragrafi (1) i këtij neni përmbajnë të dhëna lidhur me:

- personin i cili ka kryer shkelje, si në vijim: emërtimi dhe selia e personit juridik, emri dhe mbiemri i personit përgjegjës në personin juridik, emri dhe mbiemri i personit fizik, personit që ushtron autorizim publik dhe personi zyrtar i autorizuar;

- shkeljen: përshkrimi i veprimit që cilësohet si shkelje dhe

- sanksioni kundërvajtës i shqiptuar.

(3) Informatat nga paragrafi (2) i këtij neni publikohen në faqen e internetit të organeve mbikëqyrëse nga nga neni 151, paragrafi (1) të këtij ligji dhe do të jenë të disponueshme në afat prej tri vitesh nga dita e publikimit.

KAPITULLI VII.

MBLEDHJA, PËRPUNIMI, ANALIZA, VLERËSIMI, NOTIMI, SHFRYTËZIMI, BARTJA, RUAJTJA DHE SHLYERJA E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 176

(1) Drejtoria mbledh, përpunon, analizon, vlerëson, noton, përdor, bart, ruan dhe shlyen të dhënat, përpunon të dhëna personale, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me këtë ligj dhe ligj të veçantë dhe mban evidenca për të dhënat personale dhe të dhëna tjera për sigurimin e të cilave është e autorizuar me këtë ligj, për të parandaluar pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

(2) Drejtoria i përpunon të dhënat personale kur ekziston dyshim për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit në pajtim me ligjin.

(3) Të dhënat për personin juridik sigurohen kur ekziston dyshim për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit.

Neni 177

Të dhënat personale, në kuptim të këtij ligji, janë emri personal, të dhënat për lindjen (ditën, muajin dhe vitin), vendbanimin ose vendqëndrimin, numrin e vetëm të amzës, adresën e vendbanimit dhe shtetësinë, si dhe të dhëna tjera përmes të cilave direkt ose indirekt mund të identifikohet një person i caktuar.

Neni 178

Drejtoria mbledh të dhëna personale dhe të dhëna tjera të nevojshme nga subjektet, organet kompetente shtetërore, institucionet publike, entet, organizatat ndërkombëtare dhe nga personat tjerë juridik dhe fizik vetëm për qëllimet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 179

(1) Drejtoria mban evidencë për:

- 1) personat për të cilët është dorëzuar raport për aktivitet të dyshimtë;
- 2) personat për të cilët është dorëzuar raport për transaksione me para të gatshme në vlerë prej 15.000 euro në kundërvlerë në denarë ose më shumë, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione dukshëm të ndërlidhura;
- 3) personat për të cilët është dorëzuar raport nga noteri për dokument të përpiluar noterial dhe nënshkrim të noterizuar të marrëveshjes;
- 4) personat për të cilët është dorëzuar raport nga përmbaruesi për shitjen e bërë me tender publik verbal dhe për marrëveshjen e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- 5) personat për të cilët është dorëzuar raport për pagesë të kredisë;
- 6) personat për të cilët është dorëzuar raport për hua të dhëna dhe/ose të marra;
- 7) personat për të cilët është dorëzuar raport për transaksion të realizuar me transfertë të shpejtë të parave;
- 8) personat për të cilët është dorëzuar raport për lidhjen e policës së sigurimit të jetës;
- 9) personat për të cilët është dorëzuar raport për shitblerjen e automjeteve;
- 10) personat për të cilët është dorëzuar raport për blerjen ose pagesën e çipave ose kredive në lojtore (kazino);
- 11) personat për të cilët është dorëzuar raport për pagesën e fitimit ose pagesën e depozitës dhe/ose në të gjitha rastet tek organizatorë tjerë të lojërave të fatit;
- 12) personat për të cilët është dorëzuar raport për transaksion lidhur me asetet virtuale;
- 13) personat për të cilët është dorëzuar raport për dyshim për pastrim parash dhe financim të terrorizmit tek organet kompetente;
- 14) personat për të cilët është dorëzuar njoftim për dyshim për veprë tjetër penale deri te organet kompetente;
- 15) personat për të cilët është lëshuar urdhër për ndjekje të marrëdhënies afariste;
- 16) personat për të cilët është lëshuar urdhër për zbatimin e masave të përkohshme;
- 17) personat për të cilët është dorëzuar iniciativë dhe kërkesë nga organet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- 18) personat për të cilët janë shkëmbyer të dhëna me njësi të inteligjencës financiare të shteteve të tjera;
- 19) personat të cilët kanë bartur para ose mjete fizikisht të transferueshme për pagesë përtej linjës doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 20) personat për të cilët janë lëshuar urdhërpagesa për kundërvajtje, dhe
- 21) personat për të cilët janë shkëmbyer të dhëna ndërmjet organeve mbikëqyrëse.

(2) Evidencat nga paragrafi (1) i këtij neni përmbajnë të dhënat personale (numrin unik amë ose numër tjetër identifikues, emrin dhe mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë dhe nënshitetësinë) në pajtim me këtë ligj lidhur me të dhënat personale për personin e caktuar dhe për personin e tretë.

Neni 180

Evidenca nga neni 179 të këtij ligji mund të strukturohet dhe të udhëhiqet si:

- 1) evidenca për raportin e dorëzuar për aktivitet të dyshimtë;

2) evidenca për raportin e dorëzuar për transaksione me para të gatshme në vlerë prej 15.000 euro në kundërvlerë në denarë ose më shumë, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione dukshëm të ndërlidhura;

3) evidenca për raportin e dorëzuar nga noteri për dokumentin e përpiluar noterial dhe nënshkrimin e noterizuar të marrëveshjes;

4) evidencat për raportin e dorëzuar nga përmbaruesi për marrëveshjen e lidhur të drejtpërdrejtë;

5) evidenca për raportin e dorëzuar për kredi të paguar;

6) evidenca për raportin e dorëzuar për hua të dhënë dhe/ose të marrë;

7) evidenca për raportin e dorëzuar për transaksionin e realizuar përmes transferit të shpejtë të parave;

8) evidenca për raportin e dorëzuar për lidhjen e policës së sigurimit të jetës;

9) evidenca për raportin e dorëzuar për shitblerjen e automjeteve;

10) evidenca për raportin e dorëzuar për blerjen ose pagesën e çipave ose kredive në lojtore (kazino);

11) evidenca për raportin e dorëzuar për pagesën e fitimit dhe pagesën e depozitës dhe/ose në të dyja rastet tek organizatorët tjerë të lojërave të fatit;

12) evidenca për raportin e dorëzuar për dyshimin për pastrim parash dhe financim të terrorizmit deri tek organet kompetente;

13) evidenca për raportin e dorëzuar të transaksionit lidhur me asetet virtuale;

14) evidenca për njoftimin e dorëzuar për dyshimin për vepër tjetër penale deri te organet kompetente;

15) evidenca për urdhërin e lëshuar për ndjekjen e marrëdhënies afariste;

16) evidenca për urdhërin e lëshuar për zbatimin e masave të përkohshme;

17) evidenca për iniciativën dhe kërkesën e dorëzuar nga organet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

18) evidenca për shkëmbimin e të dhënave me njësitë e inteligjencës financiare të shteteve tjera;

19) evidenca për raportet e dorëzuara për para të bartura ose mjete fizikisht të transferueshme për pagesë përmes linjës doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

20) evidenca për mbikëqyrjen e kryer ndaj subjekteve nga neni 5 të këtij ligji;

21) evidenca për mbikëqyrjen e kryer ndaj subjekteve juridike nga neni 28 të këtij ligji;

22) evidenca për urdhërpagesat e lëshuara për kundërvajtje;

23) evidenca për masat e zbatuara korrigjuese, dhe

24) evidenca për të dhënat e shkëmbyera ndërmjet organeve mbikëqyrëse.

Neni 181

(1) Të dhënat për të cilat Drejtoria mban evidenca në pajtim me nenet 179 dhe 180 të këtij ligji, përdoren për ushtrimin e kompetencave të Drejtorisë në pajtim me këtë ligj, për qëllime statistikore dhe analitike, si dhe për qëllime të zbatimit të vlerësimit kombëtar të rrezikut dhe për vlerësimin e efikasitetit të sistemit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

(2) Të dhënat personale mund t'u dorëzohen subjekteve, organeve kompetente shtetërore, institucioneve publike, enteve, njësive të inteligjencës financiare të shteteve tjera dhe personave tjerë juridik dhe fizik në pajtim me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

Neni 182

Të dhënat personale mund të përdoren në pajtim me qëllimet e përcaktuara me këtë ligj dhe në pajtim me dispozitat që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 183

Të dhënat personale, të regjistruara në evidencat nga nenet 179 dhe 180 të këtij ligji, fshihen menjëherë në rastet kur konstatohet se janë të pasakta ose nuk ekzistojnë më shkakët, përkatësisht kushtet për të cilat të dhënat personale janë futur në evidencë.

Neni 184

Të dhënat e përfshira në evidencat nga nenet 179 dhe 180 të këtij ligji, nga futja e tyre deri në fshirjen e tyre, mund të shkëmbehen nën kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

Neni 185

Të dhënat nga evidencat nga nenet 179 dhe 180 të këtij ligji ruhen në afat prej dhjetë viteve nga dita e pranimi të tyre.

KAPITULLI VIII.

DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE

Neni 186

(1) Gjobë në vlerë prej 80.000 deri në 120.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit juridik (tregtar i madh), nëse:

- nuk zbaton procedur të analizës ndaj klientit në pajtim me nenin 13 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të përforcuar në momentin e vendosjes së marrëdhënies korrespondente në pajtim me nenin 40 të këtij ligji;
- nuk refuzon vendosjen e marrëdhënies afariste ose realizimin e transaksionit ose nuk e ndërpret marrëdhënien afariste me klientin në pajtim me nenin 46, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji;
- vendos ose vazhdon marrëdhënien afariste me shell banka (banka guackë) dhe të fillojë ose të vazhdojë marrëdhënien afariste korrespondente me një bankë për të cilën e di se lejon hapjen dhe menaxhimin e llogarive të bankave guackë në kundërshtim me nenin 59, paragrafi (1) të këtij ligji;
- nëse kryen aktivitete financiare të shell bank (bankë guackë) në kundërshtim me nenin 59 paragrafi (2) të këtij ligji;
- hap dhe menaxhon llogari, libreza kursimi dhe kasaforta në formë anonime, formë të koduar ose me emra fiktiv, gjegjësisht kryen shërbime të tjera të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi mundësojnë fshehjen e identitetit të klientit, gjegjësisht anonimitet në pajtim me nenin 60, paragrafi (1) të këtij ligji;
- ofron shërbime në lidhje me asetet virtuale të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi mundësojnë fshehjen e identitetit të klientit si dhe realizon transaksione me asete të tilla virtuale në pajtim me nenin 60, paragrafi (2) të këtij ligji;
- përdor burime ose mjete përmes sistemit informativ që mundësojnë ose lehtësojnë fshehjen e identitetit të klientit ose që pamundësojnë ose vështirësojnë ndjekjen e transaksioneve në lidhje me asetet virtuale në pajtim me nenin 60, paragrafi (3) të këtij ligji;
- pranon pagesat e bëra duke përdorur një kartë pagese anonime me parapagim (kartë pripeid) në pajtim me nenin 61 të këtij ligji;
- nuk i dorëzon Drejtorisë të dhënat, informatat dhe dokumentet në pajtim me nenin 65, paragrafi (1) të këtij ligji;
- banka nuk ka vënë në përdorim ose nuk ka përmirësuar softuerin për përpunimin e automatizuar të të dhënave në pajtim me nenin 70 të këtij ligji;
- thirret në sekretin afarist në kundërshtim me nenin 74 të këtij ligji;

- nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara, dorëzon të dhëna jo të plota ose të pasakta ose nuk i dorëzon ato brenda afatit në pajtim me nenin 128 të këtij ligji;

- nuk vepron në pajtim me urdhërin për ndjekjen e marrëdhënies afariste nga neni 132 të këtij ligji;

- nuk e pezullon transaksionin në bazë të urdhërit të lëshuar në pajtim me nenin 133 të këtij ligji.

(2) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (tregtar i mesëm) do të gjibitet në vlerë prej 60.000 deri në 80.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(3) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (tregtar i vogël) do të gjibitet në vlerë prej 40.000 deri në 60.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(4) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (mikro tregtar) do të gjibitet në vlerë prej 20.000 deri në 40.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(5) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personave juridikë nga paragrafi (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës, ndalim i përkohshëm i ushtrimit të një veprimtarie të caktuar, në pajtim me ligjin. Drejtoria mund të dorëzoj propozim të arsyetuar për marrjen e përkohshme apo të përhershme të licencës, përkatësisht lejes së punës të personit juridik deri tek organet përgjegjëse për lëshimin e tyre në pajtim me ligjin.

(6) Gjobë në vlerë prej 12.000 deri në 18.000 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Gjobë në vlerë prej 9.000 deri në 12.000 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Gjobë në vlerë prej 6.000 deri në 9.000 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (3) i këtij neni.

(9) Gjobë në vlerë prej 3.000 deri në 6.000 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (4) të këtij neni.

(10) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni, përveç gjobës, mund t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligjin.

(11) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, të kryera me dashje, në mënyrë të organizuar, të cilat përsëriten, me të cilat është shkaktuar dëm i theksuar ose ka përfituar dobi të konsiderueshme pronësore, personit juridik i shqiptohet gjobë në shumë prej 10% nga të ardhurat e personit juridik të realizuara në vitin paraprak fiskal dhe sanksion kundërvajtës, ndalim i përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar në pajtim me ligjin.

Neni 187

(1) Gjobë në vlerë prej 30.000 deri 40.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit juridik (tregtar i madh), nëse:

- nuk e informon Drejtorinë në pajtim me nenin 8 të këtij ligji;

- nuk kryen vlerësimin e rrezikut në pajtim me nenin 11 të këtij ligji;

- nuk e përgatit dhe nuk e zbaton programin në pajtim me nenin 12, paragrafi (1) të këtij ligji;

- nuk sjell program, nuk e përcjell dhe vlerëson rregullisht përshtatshmërinë, përputhshmërinë dhe efikasitetin e saj në pajtim me nenin 12, paragrafi (3) të këtij ligji;

- vepron në kundërshtim me përjashtimet për analizë të klientit në lidhje me paratë elektronike nga neni 14 të këtij ligji;

- nuk zbaton masat për analizën e klientit nga neni 15 të këtij ligji;

- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e klientit, personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit ose pronarit të vërtetë, në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;
- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;
- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;
- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 19 të këtij ligji;
- nuk vepron në pajtim me nenin 32 të këtij ligji;
- nuk e ndjek marrëdhënien afariste në pajtim me nenin 37 të këtij ligji;
- nuk kryen analizë të përforcuar të klientit në pajtim me nenin 39 të këtij ligji;
- nuk kryen analizë të përforcuar të klientit i cili nuk është fizikisht i pranishëm në pajtim me nenin 41 të këtij ligji;
- nuk kryen analizë të përforcuar të klientit - bartës i funksionit publik në pajtim me nenin 42 të këtij ligji;
- nuk kryen analizë të përforcuar kur marrëdhënia afariste ose transaksioni përfshin një vend me rrezik të lartë në pajtim me nenin 43 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të përforcuar lidhur me marrëdhëniet afariste dhe transaksionet me organizatat jofitimprurëse, në pajtim me nenin 44 të këtij ligji;
- nuk kryen analizë të përforcuar të transaksioneve të ndërlikuara dhe të pazakonta në pajtim me nenin 45 të këtij ligji;
- nuk siguron zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me nenin 48 të këtij ligji;
- detyrimet për analizën e klientit ua beson palëve të treta në kundërshtim me nenin 49 të këtij ligji;
- nuk vepron në pajtim me nenin 50 të këtij ligji;
- nuk vepron në pajtim me nenin 51 të këtij ligji;
- nuk e vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 52 paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk vepron në pajtim me nenin 52, paragrafi (2) të këtij ligji;
- nuk e vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 53 të këtij ligji;
- nuk e vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 54 të këtij ligji;
- nuk e vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 56 të këtij ligji;
- nuk e vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 57 të këtij ligji;
- pranon para të gatshme në kundërshtim me nenin 58 të këtij ligji;
- kryejnë regjistrim të letrave me vlerë, pronës tjetër apo çështjeve juridike, ose për raportimin ose transferimin e parave, letrave me vlerë ose pronës tjetër, në kundërshtim me nenin 58 paragrafi (2) të këtij ligji;
- nuk ruan të dhëna, informata ose dokumente në pajtim me nenin 62 të këtij ligji;
- nuk i dorëzon Drejtorisë të dhënat, informatat dhe dokumentet e mbledhura në rast të transaksionit me para të gatshme në vlerë prej 15.000 euro në kundërvlerë në denarë apo më shumë, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për një transaksion të vetëm apo për disa transaksione të ndërlidhura në pajtim me nenin 63 të këtij ligji;
- nuk i dorëzon të dhëna Drejtorisë në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;
- nuk e njofton Drejtorinë dhe nuk e pezullon transaksionin në pajtim me nenin 65 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;
- nuk dorëzojnë në Drejtori të dhëna, informata dhe dokumente në formë të raportit në pajtim me nenin 65 paragrafi (4) të këtij ligji;
- nuk i dorëzon raportet te Drejtoria në pajtim me nenin 67 të këtij ligji;
- nuk emërojnë person të autorizuar dhe zëvendës të tij në pajtim me nenin 68, paragrafi (1) të këtij ligji;

- nuk formon njësi të veçantë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me nenin 68, paragrafi (3) të këtij ligji;
- nuk formon njësi të veçantë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me nenin 68, paragrafi (4) të këtij ligji;
- nuk siguron përmbushjen e kushteve në pajtim me nenin 68, paragrafi (10) të këtij ligji;
- nuk emëron një person kujdestar të autorizuar dhe zëvendësin e tij/të saj në pajtim me nenin 68, paragrafi (11) të këtij ligji;
- nuk kryen kontroll të brendshëm në pajtim me nenin 69 të këtij ligji;
- përdor të dhënat e siguruar me këtë ligj në kundërshtim me nenin 71 të këtij ligji;
- e njofton klientin ose palën e tretë në kundërshtim me nenin 72 paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk merr masat e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave në pajtim me nenin 72, paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (tregtar i mesëm) do të gjibitet me gjobë në vlerë prej 20.000 deri në 30.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(3) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (tregtar i vogël) do të gjibitet me gjobë në vlerë prej 10.000 deri në 20.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(4) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (mikro tregtar) do të gjibitet me gjobë në vlerë prej 5.000 deri në 10.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(5) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personave juridik nga paragrafi (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës, ndalim i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarisë së caktuar, në pajtim me ligjin.

(6) Gjobë në vlerë prej 4.500 deri në 6.000 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Gjobë në vlerë prej 3.000 deri në 4.500 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Gjobë në vlerë prej 1.500 deri në 3.000 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (3) i këtij neni.

(9) Gjobë në vlerë prej 750 deri në 1.500 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (4) i këtij neni.

(10) Personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç gjobës, mund t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligjin.

Neni 188

(1) Gjobë në vlerë prej 5.000 deri në 10.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit juridik (tregtar i madh), nëse:

- nuk e informon Drejtorinë në pajtim me nenin 6 paragrafi (6) të këtij ligji;
- nuk e informon Drejtorinë në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji;
- nuk kryen analizë të thjeshtësuar të klientit në pajtim me nenin 38 të këtij ligji;
- nuk i shënon të dhënat sipas rendit kronologjik në regjistrin e numeruar të ofruesi i shërbimeve që kanë të bëjnë me asetet virtuale në pajtim me nenin 52 paragrafi (3) të këtij ligji;
- nuk i shënon të dhënat sipas rendit kronologjik në regjistrin e numeruar të punët lidhur me këmbimin sipas nenit 53 të këtij ligji;
- nuk i shënon të dhënat sipas rendit kronologjik në regjistrin e numeruar tek shtëpitë brokere dhe bankave me leje për punë me letra me vlerë, sipas nenit 55 të këtij ligji;

- nuk i shënon të dhënat sipas rendit kronologjik në regjistrin e numeruar tek personat që tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetësues në tregtinë me vepra të artit në pajtim me nenin 56 të këtij ligji;

- nuk shënon të dhënat sipas rendit kronologjik në regjistrin e numeruar tek personat që tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetësues në tregtinë me vepra të artit kur aktiviteti zhvillohet në zona të lira, në pajtim me nenin 57 të këtij ligji;

- nuk e njoftojnë organin kompetent për mbikëqyrje nga ky ligj se kanë dorëzuar raport te Drejtoria në pajtim me nenin 65, paragrafi (7) të këtij ligji;

- punëson në njësi persona të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga neni 68, paragrafët (7), (8) dhe (13) të këtij ligji;

- nuk siguron trajnim të rregullt profesional në pajtim me nenin 68, paragrafi (14) të këtij ligji;

- nuk dorëzon të dhëna te Drejtoria në pajtim me nenin 68, paragrafi (15) të këtij ligji dhe

- nuk ka vepruar ose ka vepruar pjesërisht pas masave të shqiptuara korigjuese në pajtim me nenin 167 të këtij ligji.

(2) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (tregtar i mesëm) do të gjyket me gjobë në vlerë prej 4.000 deri në 8.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(3) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (tregtar i vogël) do të gjyket me gjobë në vlerë prej 3.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(4) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik (mikro tregtar) do të gjyket me gjobë në vlerë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(5) Gjobë në vlerë prej 750 deri në 1.500 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjobë në vlerë prej 600 deri në 1.200 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (2) i këtij neni.

(7) Gjobë në vlerë prej 300 deri në 450 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (3) i këtij neni.

(8) Gjobë në vlerë prej 150 deri në 300 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 189

(1) Gjobë në vlerë prej 30.000 deri në 40.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit që ushtron autorizime publike ose personit fizik, nëse:

- nuk zbaton procedurë të analizës së klientit në pajtim me nenin 13 të këtij ligji;

- nuk refuzon vendosjen e marrëdhënies afariste ose realizimin e transaksionit ose nuk ndërpret marrëdhënien afariste me klientin në pajtim me nenin 46, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji;

- kryen shërbime të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mundësojnë fshehjen e identitetit të klientit, përkatësisht anonimitet në pajtim me nenin 60, paragrafi (1) të këtij ligji;

- pranon pagesat e bëra me kartë pagese anonime me parapagim (kartë pripeid) në pajtim me nenin 61 të këtij ligji;

- nuk i dorëzon Drejtorisë të dhënat, informatat dhe dokumentet në pajtim me nenin 65, paragrafi (1) të këtij ligji;

- thirret në sekretin afarist në kundërshtim me nenin 74 të këtij ligji;

- nuk dorëzon të dhënat e kërkuara, dorëzon të dhëna jo të plota ose të pasakta ose nuk i dorëzon ato brenda afatit në pajtim me nenin 128 të këtij ligji;

- nuk vepron në pajtim me urdhërin për ndjekjen e marrëdhënies afariste nga neni 132 të këtij ligji;

- nuk e pezullon transaksionin në bazë të urdhërit të lëshuar në pajtim me nenin 133 të këtij ligji.

(2) Përveç gjobës, personit që ushtron autorizim publik ose personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, mund t'i shqiptohet edhe sanksioni kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligjin.

Neni 190

(1) Gjobë në vlerë prej 12.000 deri në 15.000 euro në kundërvlerë në denarë, do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit që ushtron autorizime publike ose personit fizik, nëse:

- me kërkesë të Drejtorisë, nuk dorëzon shpjegim në formë të shkruar në pajtim me nenin 7, paragrafi (2) të këtij ligji;

- nuk zbaton vlerësim të rrezikut në pajtim me nenin 11 të këtij ligji;

- nuk përgatit dhe zbaton programë në pajtim me nenin 12, paragrafi (1) të këtij ligji;

- nuk sjell programë, nuk përcjell dhe vlerëson rregullisht përshtatshmërinë, përputhshmërinë dhe efikasitetin e saj në pajtim me nenin 12, paragrafi (3) të këtij ligji;

- nuk zbaton masat për analizën e klientit nga neni 15 të këtij ligji;

- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e klientit, personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit ose pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;

- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e klientit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;

- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e personit që vepron në emër dhe për llogari të klientit, në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;

- nuk identifikon dhe vërteton identitetin e pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 19 të këtij ligji;

- nuk vepron në pajtim me nenin 32 të këtij ligji;

- nuk e ndjek marrëdhënien afariste në pajtim me nenin 37 të këtij ligji;

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit në pajtim me nenin 39 të këtij ligji;

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit i cili nuk është fizikisht i pranishëm në pajtim me nenin 41 të këtij ligji;

- nuk zbaton analizë të përforcuar të klientit - bartës i funksionit publik në pajtim me nenin 42 të këtij ligji;

- nuk zbaton analizë të përforcuar kur marrëdhënia afariste ose transaksioni përfshin vend me rrezik të lartë në pajtim me nenin 43 të këtij ligji;

- nuk zbaton analizë të përforcuar lidhur me marrëdhëniet afariste dhe transaksionet me organizatat jofitimprurëse, në pajtim me nenin 44 të këtij ligji;

- nuk zbaton analizë të përforcuar të transaksioneve të ndërlikuara dhe të pazakonta në pajtim me nenin 45 të këtij ligji;

- nuk siguron zbatimin e masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me nenin 48 të këtij ligji;

- detyrimet për analizën e klientit ua beson palëve të treta në kundërshtim me nenin 49 të këtij ligji;

- pranon para të gatshme në kundërshtim me nenin 58 të këtij ligji;

- nuk ruan të dhëna, informata ose dokumente në pajtim me nenin 62 të këtij ligji;

- nuk dorëzon të dhëna në Drejtori në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;

- nuk e njofton Drejtorinë dhe nuk e pezullon transaksionin në pajtim me nenin 65 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;

- nuk dorëzojnë deri te Drejtoria të dhëna, informata dhe dokumente në formë të raportit në pajtim me nenin 65 paragrafi (4) të këtij ligji;

- nuk i dorëzon raportet Drejtorisë në pajtim me nenin 67 të këtij ligji;

- nuk emërojnë person të autorizuar dhe zëvendësin e tij në pajtim me nenin 68, paragrafi (1) të këtij ligji;

- nuk formon njësi të veçantë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me nenin 68 paragrafi (3) të këtij ligji;

- nuk formon njësi të veçantë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me nenin 68 paragrafi (4) të këtij ligji;

- nuk siguron përmbushjen e kushteve në pajtim me nenin 68 paragrafi (10) të këtij ligji;

- nuk kryen kontroll të brendshëm në pajtim me nenin 69 të këtij ligji;

- i përdor të dhënat e siguruar me këtë ligj në kundërshtim me nenin 71 të këtij ligji;

- e njofton klientin ose palën e tretë në kundërshtim me nenin 72 paragrafi (1) të këtij ligji;

- nuk ndërmerr masat e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave në pajtim me nenin 72 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Përveç gjobës, personit që ushtron autorizim publik ose personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, mund t'i shqiptohet edhe sanksioni kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligjin.

Neni 191

Gjobë në vlerë prej 2.000 deri në 2.500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit që ushtron autorizim publik ose personit fizik, nëse:

- nuk e njofton Drejtorinë në pajtim me nenin 6, paragrafi (6) të këtij ligji;

- nuk zbaton analizë të thjeshtësuar të klientit në pajtim me nenin 38 të këtij ligji;

- punëson në njësi persona të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga neni 68 paragrafët (7), (8) dhe (13) të këtij ligji;

- nuk siguron trajnim të rregullt profesional në pajtim me nenin 68, paragrafi (14) të këtij ligji;

- nuk dorëzon të dhëna deri te Drejtoria në pajtim me nenin 68, paragrafi (15) të këtij ligji dhe

- nuk ka vepruar ose ka vepruar pjesërisht sipas masave korrigjuese të shqiptuara në pajtim me nenin 167 të këtij ligji.

Neni 192

(1) Gjobë në vlerë prej 10.000 deri në 15.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit juridik (tregtar i madh) nga neni 28, paragrafi (1) të këtij ligji, nëse:

- nuk posedon dhe nuk ruan të dhëna përkatëse, të sakta dhe të përditësuara për pronarin e vërtetë në pajtim me nenin 28, paragrafi (2), dhe

- nuk i shënon në regjistër të dhënat për pronarin/ët e vërtetë, si dhe të dhënat për ndryshimet e pronarit/ëve të vërtetë, në pajtim me nenin 31 të këtij ligji.

(2) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar i mesëm) do t'i shqiptohet gjobë në vlerë prej 8.000 deri në 12.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(3) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar i vogël) do t'i shqiptohet gjobë në vlerë prej 6.000 deri në 8.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(4) Për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik (mikro tregtar) do t'i shqiptohet gjobë në vlerë prej 5.000 deri në 6.000 euro në kundërvlerë në denarë.

(5) Gjobë në vlerë prej 1.500 deri në 2.250 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në subjektin juridik nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjobë në vlerë prej 1.200 deri në 1.800 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në subjektin juridik nga paragrafi (2) i këtij neni.

(7) Gjobë në vlerë prej 900 deri në 1.200 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në subjektin juridik nga paragrafi (3) i këtij neni.

(8) Gjobë në vlerë prej 750 deri në 900 euro në kundërvlerë në denarë për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet për shkelje ligjore edhe personit përgjegjës në personin juridik nga paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 193

Me gjobë në vlerë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për shkelje ligjore administratorit të falimentimit ose administratorit të likuidimit nëse nuk ndërmerr masa dhe veprime në rast se subjekti është në procedurë falimentimi dhe likuidimi në pajtim me neni 10 të këtij ligji.

Neni 194

Gjobë në vlerë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për shkelje ligjore personit zyrtar të autorizuar, nëse:

- nuk dorëzojnë të dhënat e kërkuara në pajtim me nenin 128 të këtij ligji;
- nuk e informojnë Drejtorinë për rezultatin dhe epilogun e raporteve apo njoftimeve të dorëzuara në pajtim me nenin 131 paragrafi (5) të këtij ligji;
- nuk dorëzojnë te Drejtoria të dhëna statistikore në pajtim me nenin 137, paragrafi (5) të këtij ligji;
- nuk evidentojnë çdo futje dhe nxjerrje të parave ose mjeteve fizikisht të transferueshme për pagesa përmes linjës doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me nenin 141, paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk i mbledh të dhënat në pajtim me nenin 141, paragrafi (2) të këtij ligji;
- nuk raporton në Drejtori për futjen ose nxjerrjen e parave ose mjeteve fizikisht të transferueshme për pagesa mbi 10.000 euro në kundërvlerë në denarë, në pajtim me nenin 141 paragrafi (3) të këtij ligji;
- nuk e raporton në Drejtori dyshimin për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit në pajtim me nenin 141, paragrafi (4) të këtij ligji;
- nuk i ruan të gjitha të dhënat për futjen dhe nxjerrjen e parave ose mjeteve fizikisht të transferueshme për pagesa, përmes linjës doganore së paku dhjetë vjet nga dita e transferimit të realizuar, në pajtim me nenin 141 paragrafi (5) të këtij ligji;
- nuk përgatitin programe apo plane vjetore për mbikëqyrjen e zbatimit të masave dhe veprimeve në pajtim me nenin 155 paragrafi (2) të këtij ligji;
- nuk e njoftojnë Drejtorinë kur konstatojnë dyshime për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit si dhe shkelje të dispozitave të këtij ligji në pajtim me nenin 156 të këtij ligji;
- nuk formojnë komisione për zbatimin e mbikëqyrjes në pajtim me nenin 171, paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk e njoftojnë Drejtorinë në pajtim me nenin 171, paragrafi (3) të këtij ligji, dhe
- nuk e njoftojnë Drejtorinë për kërkesën e parashtruar për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në pajtim me nenin 172 të këtij ligji.

Procedura e lëshimit të urdhërpagesës për kundërvajtje

Neni 195

(1) Për shkeljet nga ky ligj, organet mbikëqyrëse nga neni 151 të këtij ligji, gjatë konstatimit të shkeljes, detyrohen që personit i cili ka kryer shkeljen t'i propozojnë procedurë për barazim përmes lëshimit të urdhërpagesës për kundërvajtje, para se të parashtrajnë kërkesën për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(2) Nëse organet mbikëqyrëse nga neni 151 të këtij ligji, konstatojnë shkelje në pajtim me këtë ligj, përpilojnë procesverbal në të cilin shënojnë elementet e rëndësishme të shkeljes nga e cila rrjedh kualifikimi juridik i së njëjtës, emrin personal, adresën dhe numrin unik të identifikimit të qytetarit, nëse është i huaj edhe numrin e pasaportës dhe shtetin, ndërsa për personin juridik, emërtimin, selinë dhe numrin tatimor, kohën, vendin dhe mënyra e kryerjes së shkeljes, përshkrimin e shkeljes, kualifikimin juridik të shkeljes dhe personat e hasur në vendngjarje, si dhe të japë propozim për barazim përmes lëshimit të urdhërpagesës për kundërvajtje. Procesverbali nënshkruhet nga organi mbikëqyrës, personi zyrtar i autorizuar dhe personi që ka bërë shkelje.

(3) Në procedurën e barazimit, gjoha në urdhërpagesën për kundërvajtje shqiptohet në shumë fikse e përcaktuar me ligj, e nëse gjoha është paraparë në diapazon (kufi minimal dhe maksimal), do të shqiptohet shuma minimale e paraparë për shkeljen e caktuar.

(4) Urdhërpagesën për kundërvajtje të lëshuar në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, personi që ka bërë shkeljen ligjore është i detyruar ta paguajë në afat prej tetë ditësh nga pranimi i urdhërpagesës, në llogarinë e shënuar në urdhërpagesë.

(5) Personi që ka bërë shkeljen ligjore, nëse paguan gjobën në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, do ta paguajë gjysmën e gjobës së shqiptuar, për të cilën udhëzohet me udhëzim juridik.

(6) Në procedurën e cila përfundon, me pagesën e urdhërpagesës për kundërvajtje, nuk paguhen shpenzime të procedurës.

(7) Personi që ka bërë shkeljen ligjore, me largimin e tij për shkak të qëndrimit jashtë vendit ka mundur t'i shmanget pagesës së gjobës, është i detyruar që menjëherë ta paguajë gjobën e shqiptuar me urdhërpagesë për kundërvajtje.

(8) Nëse personi që ka bërë shkeljen ligjore, nuk e paguan urdhërpagesën për kundërvajtje në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, organet mbikëqyrëse nga neni 151 të këtij ligji do të parashtrajnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente.

(9) Organet mbikëqyrëse nga neni 151 të këtij ligji janë të detyruara të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për epilogun e procedurave të ngritura.

(10) Në evidencën nga paragrafi (9) i këtij neni, mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i personit i cili ka bërë shkeljen ligjore, vendbanimi, gjegjësisht vendqëndrimi, selia, lloji i shkeljes ligjore, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje dhe epilogu i procedurës.

(11) Të dhënat personale nga paragrafi (10) i këtij neni ruhen dhjetë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(12) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje.

Neni 196

Procedura për kundërvajtje për shkeljen e kryer sipas këtij ligji nuk mund të ngrihet apo udhëhiqet nëse kanë kaluar më shumë se katër vjet nga dita e kryerjes së shkeljes ligjore.

Neni 197

Për shkeljet e parapara me këtë ligj vendos gjykata kompetente në procedurë të përcaktuar me ligj.

KAPITULLI IX.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 198

(1) Aktet nënligjore që janë sjellur në pajtim me Ligjin e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 120/18, dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 275/19 dhe 317/20) vazhdojnë të zbatohen deri në ditën e sjelljes së akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të sillen në afat prej 15 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 199

(1) Subjektet nga neni 5, paragrafi (1) pikat 8), 9) dhe 10) të këtij ligji janë të detyruar që në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji të harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e këtij ligji.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, ofruesit e shërbimeve në lidhje me asetet virtuale të cilët para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë filluar të kryejnë aktivitete të përcaktuara me këtë ligj, janë të detyruar të përmbushin obligimin për njoftim nga neni 8 të këtij ligji në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor nga neni 8, paragrafi (6) të këtij ligji.

Neni 200

(1) Drejtoria për inteligjencë financiare nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji do të vazhdojë të funksionojë si Drejtori e Inteligjencës Financiare në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Drejtori i Drejtorisë i emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojë të ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 201

Drejtorja e Inteligjencës Financiare do të vë në funksion sistemin elektronik për ndjekjen e lëndëve nga neni 138 të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 202

1) Këshilli për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i formuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojë të kryejë funksionin e tij në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

2) Komisionet mbikëqyrëse nga neni 171 të këtij ligji të formuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionin e tyre në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 203

Procedurat kundërvajtëse të ngritura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe të Financimit të Terrorizmit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 120/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 275/19 dhe 317/20).

Neni 204

(1) Nga 1 janari 2024, ndalesa për pagesa me para të gatshme të mallrave dhe shërbimeve nga neni 58 të këtij ligji, do të përfshijë pagesat me para të gatshme në vlerë prej 2.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë në formë të një ose më shumë transaksioneve dukshëm të ndërlidhura, të cilat nuk realizohen përmes bankës, kursimorese ose përmes llogarisë në një institucion tjetër që ofron shërbime pagesore.

(2) Nga 1 janari 2025, ndalesa për pagesa me para të gatshme të mallrave dhe shërbimeve nga neni 58 të këtij ligji, do të përfshijë pagesat me para të gatshme në vlerë prej 1.000 euro ose më shumë në kundërvlerë në denarë në formë të një ose më shumë transaksioneve dukshëm të ndërlidhura, të cilat nuk realizohen përmes bankës, kursimores ose përmes llogarisë në një institucion tjetër që ofron shërbime pagesore.

Neni 205

Subjektet juridike, aksionet e të cilave listohen në treg të organizuar të letrave me vlerë nga neni 28 të këtij ligji, janë të detyruar që të fusin të dhënat për pronarin e vërtetë nga ky ligj në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 206

(1) Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me subjektet nga neni 5, paragrafi (1), pika 8), 9) dhe 10) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

(2) Dispozitat nga neni 31, paragrafi (2) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2025.

Neni 207

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shpallet i pavlefshëm Ligji i Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe i Financimit të Terrorizmit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 120/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 275/19 dhe 317/20).

Neni 208

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.